# 2025 RAPORTI VJETOR

Autoriteti i Mediave Audiovizive



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

# AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE







# MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE



**ARMELA KRASNIQI**
**Kryetare e AMA-s**

**I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,**
**Të nderuar anëtarë të Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik**
**Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,**

Çdo ditë të vitit 2025, në Autoritetin e Medias Audiovizive, ka mbërritur një ankesë, dërguar nga një qytetar i Republikës së Shqipërisë. Nga 432 ankesa të administruara nga Këshilli i Ankesave, 84.3% e tyre janë bërë nga njerëz të zakonshëm, të cilët i janë drejtuar Autoritetit për problematika të ndryshme që variojnë nga cenimin e figurës/dinjitetit, tek cenimin e privatësisë dhe të dhënave personale e deri tek e drejta e përgjigjes. E theksova që në krye të herës këtë, për të dalluar rritjen e ndjeshmërisë së opinionit publik për përmbajtjet që media audio dhe audiovizive transmeton, por mbi të gjitha si një tregues shumë i rëndësishëm për ne: Besueshmëria që publiku ka tek AMA, tek zbatueshmëria ligjore, tek drejtësia dhe ligjshmëria e vendimeve që kemi dhënë këtë vit, por edhe të tjerë para tij.

Të nderuar,

Viti 2025 ka qenë një vit angazhimesh në procese të ndryshme pune, me qëllim efektivitetin e mëtejshëm të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMA-s në tregun audio dhe audioviziv shqiptar. Në kuadër të detyrimeve periodike për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Europian në fushën e medias audiovizive dhe digjitale, strukturat përkatëse të AMA-s kanë dhënë kontributin e tyre teknik, përmes analizave ligjore dhe krijimit të tabelave të përputhmërisë për ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar, sipas të cilave parashikohet një kuadër i ri ligjor për transparencën e pronësisë së medias. Sa i takon garantimit të pluralizmit mediatik dhe pavarësisë editoriale, autoriteti ka ofruar ekspertizë të specializuar në kuadër të Platformës së Dialogut, si mekanizëm konsultimi dhe bashkëpunimi me aktorët e sektorit të medias, për vendosjen e një regjimi të posaçëm për kontrollin e përqendrimit të medias.
Gjithashtu në përmbushje të detyrimeve ligjore, por edhe të kërkesave që rrjedhin nga procesi i integrimit, AMA ka vijuar punën si një autoritet rregullator kolegjial dhe i pavarur në fushën e shërbimeve të transmetimit audio dhe audioviziv në Shqipëri, shërbimeve të tyre mbështetëse dhe Platformave të Shpërndarjes së Videove. Kjo si zbatim i ligjit organik të AMA-s, me dispozitat që përcaktojnë statusin e Autoritetit, pavarësinë financiare dhe politike, me një Bord të propozuar nga shoqëria civile, ndër profesionistët e dalluar të medias ose të drejtës në vend, dhe të votuar nga Parlamenti dhe me procese pune të përcaktuara nga dinamika të ngjashme apo të njëjta me shumicën e vendeve të tjera europiane. Në këtë kuadër dhe në zbatim të kësaj ligjshmërie, përmendim rreth 110 vendime të marra gjatë vitit 2025, ose në total gjatë 5 viteve të fundit - rreth 550 vendime të marra nga



INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Bordi i AMA-s, mbi 60% e të cilave qenë me dakortësi unanime, të shprehura përmes procesit të votimit. Çka tregon se ky Bord i është bindur vetëm ligjit. Në tërësinë e këtyre vendimeve përfshihen 27 vendime për konstatim pavlefshmërie licence/autorizimi; 48 vendime për rinovimin e licencave; 76 vendime për rinovimin e autorizimit; 6 vendime për heqjen e licencave; 7 vendime për heqjen e autorizimit; 2 vendime për dhënien e licencave; 43 vendime për dhënien e autorizimit; 17 vendime për akte nënligjore të ndryshme; 9 vendime për çelje gare për frekuenca të lira Audio/Audiovizive. Autoriteti i Mediave Audiovizive ka kryer monitorimin e 7 fushatave zgjedhore (2 fushata zgjedhore për zgjedhje të përgjithshme parlamentare; 1 për zgjedhje të përgjithshme vendore; 4 për zgjedhje të pjesshme vendore); janë marrë vendime për 38 gjoba për përmbajtje dhe 44 gjoba për pirateri televizive, të cilat në total llogariten në mbi 80 milion lekë.
Në morinë e këtyre vendimeve, asnjë prej tyre nuk është pretenduar qoftë nga shoqëria civile, qoftë nga vetë industria apo nga partitë politike si i marrë me ndikim politik.
Gjithashtu mekanizmi i financimit të AMA-s si një institucion i vetëfinancuar (nenet 24–27 të ligjit) është strukturuar për të siguruar qëndrueshmëri financiare dhe autonomi institucionale. Aktiviteti i Autoritetit udhëhiqet nga parimet e transparencës dhe llogaridhënies, duke siguruar njëkohësisht që burimet të përdoren në mënyrë efikase për të përmbushur detyrat e tij statutore.

Kemi punuar si një institucion i pavarur dhe i besueshëm në çdo vendim të marrë, ligjshmëria e të cilëve është përforcuar edhe nga vendimet e gjykatës, e cila ka shqyruar ankesat për gjoba të vëna, për pirateri apo përmbajtjeve në shkelje të ligjit; për procedura ligjore apo për monitorim dhe inspektim dhe në mbrojtje të subjekteve të ligjshëm. Gjatë vitit raportues janë shënuar 15 procese gjyqësore të fituara në Gjykatën e Shkallës së Parë, një proces i humbur dhe 13 të tjerë ende në proces.

Një prej detyrave të rëndësishme të Autoritetit, në funksion të shërbimit ndaj publikut përmes ofertës programore është edhe shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara. Shqyrtimet janë kryer mbi bazën e planifikimit, duke pasur parasysh problematikat më të shpeshta që hasen në programet e transmetuara, por dhe nga ndjeshmëritë e krijuara në publik për përmbajtje të caktuara. Fokusi kryesor për shqyrtimet tematike të realizuara gjatëvitit 2025 ka qenë mbi aspekte të rëndesishme si mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme; gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit në çdo formë që paraqitet; shkeljet etike në përgjithësi; reklamat dhe komunikimet tregtare; përdorimi i gjuhës shqipe standarde të shkruar dhe të folur; tërësia programore të platformës së RTSH - së, në zbatim të kërkesave të Kontratës së Shërbimit, etj. Monitorimi është adresuar në përmbajtjet e transmetuara në OSHMA-të me licencë kombëtare apo ato lokale/rajonale; në OSHMA-të që kanë format programacioni gjeneralist apo tematik.

Nga 329 raste shqyrtimesh që janë analizuar gjatë vitit 2025, janë identifikuar 106 raste që nuk kanë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.
Nga 106 rastet e shkeljeve të identifikuara, pas analizimit të detajuar dhe profesional, referuar dhe kuadrit legjislativ janë marrë masat administrative, sipas përcaktimeve ligjore.

Angazhim i rëndësishëm i Autoritetit ka qenë edhe gjatë monitorimit të proceseve zgjedhore, respektivisht: Zgjedhjet e përgjithshme të 11 Majit 2025 dhe zgjedhjet e pjesshme të 9 nëntorit 2025 të zhvilluara në 5 bashki të vendit.

Lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit, Autoriteti, gjatë vitit 2025 ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh të subjekteve kabllore/IPTV/OTT në terren. Ky vit, solli të reja në


INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL

mënyrën e kryerjes së kontrolleve për shkeljen e të drejtave të transmetimit, ku specialistë pranë kësaj drejtorie kanë kryer dhe monitorimin e rrjeteve online pranë zyrave të institucionit, duke identifikuar një sërë rastesh të përdorimit të serverave të ndyshëm që përdoreshin për shpërndarjen dhe shitjene produkteve audiovizive në mënyrë pirate. Në këtë kuadër AMA mori masa për mbylljen e më shumë se 10 serverave që operonin brenda territorit të vendit tonë, të cilët transmetonin kontent audioviziv pa të drejta si dhe bëri të mundur sanksionimin e 2 subjekteve ISP që operonin në kundërshtim me ligjin 97/2013, të ndryshuar duke i gjobitur ato me nga 5.000.000 lekë secilin. Sqarojmë se, fenomeni i piraterisë televizive që kryhet nëpërmjet internetit, është një fenomen sa shqetësues aq dhe i komplikuar për t'u identifikuar, për arsye se në shumicën e rasteve produkti audioviziv që transmetohet abuzivisht, vjen nga servera të vendeve të ndryshme të botës. Sa i përket serverave që operojnë jashtë vendit tonë, u konstatuan 4 të tillë.

Ndër aktivitetet e organizuara nga AMA, gjatë vitit 2025, si një ndër impenjimet kryesore përmendim mbajtjen, në muajin maj, të takimit të 12-të vjetor të Forumit të Autoriteteve Rregullatore të Transmetimeve në Detin e Zi (Black Sea Broadcasting Regulatory Authorities Forum – BRAF). Ky aktivitet mblodhi përfaqësues të niveleve drejtuese të autoriteteve rregullatore të mediave audiovizive nga vendet anëtare të këtij forumi, përfshirë Turqinë, Azerbajxhanin, Greqinë, Serbinë, Armeninë, Bullgarinë, Moldavinë dhe Gjeorgjinë, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme dialogu për çështje me interes të përbashkët për rregullimin e mediave në rajonin e Detit të Zi. Tema qendrore e takimit ishte "Gjuha e Urrejtjes dhe e Drejta për Informim në Mediat Audiovizive dhe Platformat Online", një temë që pasqyron sfidat aktuale me të cilat përballen autoritetet rregullatore në një mjedis mediatik gjithnjë e më të ndërlidhur dhe të ndikuar nga zhvillimet digjitale. Diskutimet u përqendruan në mënyrën se si autoritetet rregullatore mund të adresojnë përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjeve diskriminuese, duke garantuar njëkohësisht respektimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtës së publikut për informim të saktë dhe të besueshëm.

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vijuar dhe thelluar angazhimin e tij strategjik në fushën e edukimit mediatik, duke e konsideruar këtë dimension si një nga instrumentet kryesore parandaluese për mbrojtjen e interesit publik, forcimin e të menduarit kritik dhe rritjen e rezistencës së publikut, veçanërisht të të rinjve dhe fëmijëve, ndaj rreziqeve të mjedisit audioviziv dhe digjital. Në këtë kuadër, AMA ka vijuar aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese me nxënës të shkollave të mesme në qytetine Durrësit, ku u trajtuan çështje që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve në mjedisin mediatik dhe digjital. Paralelisht me aktivitetet në shkolla, AMA ka zhvilluar gjatë vitit 2025 një sërë fushatash të strukturuara të edukimit mediatik për publikun e gjerë. Një ndër nismat më të rëndësishme ka qenë bashkëpunimi me Zyrën e OSBE-së në Tiranë dhe janë publikuar periodikisht materialeve informuese dhe ndërgjegjësuese në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale, përmes infografikave, posterëve digjitalë dhe artikujve tematikë. Këto përmbajtje kanë trajtuar në mënyrë të vazhdueshme tema si mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet e botës virtuale, privatësia dhe të dhënat personale, përdorimi i inteligjencës artificiale në media, dallimi midis lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, rreziqet e piraterisë audiovizive dhe ndikimet e lojërave online tek adoleshentët. Qasja e ndjekur synon ndërtimin e një kulture të qëndrueshme informimi dhe vetëdijeje mediatike në publik.

Në raportin që parqitet mbi veprimtarinë 1-vjeçare të AMA-s jepen në mënyrë të detajuar të gjitha aspektet e angazhimit institucional, sipas njësive përbërëse, por dhe sipas realiteteve dhe sfidave që përballet tregu audio/audioviziv në vendin tonë. Kjo pasqyrë konkrete e dinamikës së punës në AMA shikohet në çdo rast në raport me kërkesat dhe nevojat konkrete të publikut, si dhe në përputhshmëri me standardet që respekton një vend që aspiron anëtarësimin, me të drejta të plota, në BE.



INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

PËRMBAJTJA

MESAZHI I KRYETARIT

HYRJE

1. STRATEGJIA E AUTORITETIT ..... 16

2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2024 ..... 20

2.1 Nismat e Edukimit Mediatik ..... 25

2.1.1 Aktivitete edukimi mediatik në institucionet e arsimit parauniversitar ..... 25

2.1.2 Fushata Edukimi Mediatik ..... 25

2.1.3 Fushata e konceptuar nga AMA e përqendruar në interesin më të lartë të fëmijës ..... 26

3. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT ..... 28

4. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT ..... 32

5. QEVERISJA E AUTORITETIT ..... 36

5.1 Vendimarrja mbi licencat/autorizimet ..... 36

5.2 Ecuria e proceseve gjyqësore ..... 38

6. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM ..... 40

6.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të transmetuara ..... 40

6.2 Monitorimet e përmbajtjeve ..... 57

7. KËSHILLI I ANKESAVE ..... 63

7.1 Administrimi i ankesave të qytetarëve apo grupeve të ndryshme të interesit në adresë të Ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizive ..... 63

7.1.1 Subjektet ankuese ..... 63

7.1.2 Objekti i ankesave ..... 64

7.1.3 Administrimi i ankesave ..... 66

7.1.4 Masa administrative ..... 67

7.1.5 Tërheqje Vëmendjeje ..... 67

8 AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE ..... 74

8.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit ..... 74

8.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve ..... 74

8.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit ..... 75

9 TRANSMETIMET NUMERIKE ..... 78

9.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital Dy (DD2) ..... 78

9.2 Administrimi dhe Planifikimi i spektrit të frekuencave ..... 80

9.2.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive ........ 82
9.2.2 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio ........ 83
9.2.3 Koordinimi i frekuencave të brezit audio dhe audioviziv ........ 84
9.3 Monitorimi i spektrit të frekuencave ........ 85
9.4 Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizivë ........ 90
9.5 Sektori TIK ........ 91
9.5.1 Funksionimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës teknologjike ........ 92
9.5.2 Mbështetja teknologjike e proceseve të monitorimit audioviziv ........ 92
9.5.3 Siguria e informacionit dhe mbrojtja kibernetike ........ 92
9.5.4 Mbështetja teknike e proceseve rregullatore dhe të licencimit ........ 92
10 AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KONTROLLI I LARTË I SHTETIT ........ 94
11 AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL ........ 95
11.1 Organizimi i brendshëm i institucionit ........ 95
11.2 Programi i transparencës ........ 96
11.3 Aktivitete të Autoritetit ........ 99
11.4 AMA në bashkëpunim me partnerët ........ 117
11.5 Marrëveshjet e Bashkëpunimit ........ 120
11.6 Bashkëpunime me OSHMA-të për propozime për Aktet Nënligjore ........ 120
11.7 Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s ........ 121
11.8 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore ........ 125
12 TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE ........ 127
12.1 Menaxhimi i burimeve financiare ........ 127
12.2 Realizimi i burimeve të financimit në vitin 2025 ........ 127
12.3 Detyrimet financiare të OSHMA-ve ........ 130
12.4 Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2025 ........ 132
12.4.1 Shpenzimet dhe investimet në vitin 2025 ........ 132
12.4.2 Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara ........ 133
12.4.3 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara ........ 133
12.5 Pasqyrat financiare ........ 134
Pasqyra e aktiveve dhe pasiveve për vitet 2024 - 2025 ........ 134
**ANEKS 1 ........ 142**

# HYJRE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në përmbushje të detyrave dhe funksioneve që rrjedhin nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe nga Strategjia e AMA-s, miratuar me vendimin nr. 18, datë 26.02.2024 të Bordit, ka vijuar punën me procese që kanë përkuar me anagazhime në vijimësi, por edhe me procese të reja që rrjedhin nga Plani i Veprimit 2024-2026. Për shkak të zhvillimeve të tregut mediatik, të diktuara nga teknologjia, të ndryshimeve a përmirësimeve të mëtejshme të kuadrit ligjor dhe ambicjes për rregullimin e mëtejshëm të tregut audio dhe audioviziv dhe formësimin e tij sipas standardeve europiane, objektivat kryesor të AMA-s janë përqendruar në këto drejtime:

- Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare;
- Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive;
- Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme, motivuar nga interesi publik;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit;
- Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit;

Në përmbushje të këtyre objektivave, si dhe në zbatim të Planit të Veprimit, parashikuar në Strategjinë 2024-2026, gjatë vitit raportues, puna e AMA-s, përveç angazhimeve në vijimësi, është përqendruar edhe në disa drejtime të tjera, shumë të rëndësishme, si:
në luftën kundër piraterisë televizive, në funksion të licencës audiovizive të OSHMA-ve;

- në bashkëpunimet e ndryshme me partnerë dhe faktorë në treg për publikime studimesh dhe raportesh që ndihmojnë në mbrojtjen e gazetarëve dhe luftën ndaj Dezinformimit dhe Gjuhës së Urrejtjes;
- në promovimin e transmetimit të përgjegjshëm dhe fuqizimit të audiencave, nëpërmjet realizimit, për herë të parë, të studimit kombëtar sasior mbi perceptimin e publikut për standardet etike të ofertës audiovizive dhe digjitale;
- në punën drejt funksionalizimit real të Rrjetit të Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-ve, me synim konsolidimin e plotë të tij të këtyre strukturave.

Përveç këtyre, gjatë vitit 2025 puna dhe veprimtaria e Autoritetit është përqendruar në shumë procese të tjera të rëndësishme dhe në vijimësi, ndër të cilat veçojmë si më parësore:

Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Europian.
Në kuadër të detyrimeve periodike për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Europian në fushën e medias audiovizive dhe digjitale, strukturat përkatëse të AMA-s kanë ndërmarrë një rol proaktiv në identifikimin e mangësive të kuadrit ekzistues ligjor dhe në kontributin teknik përmes analizave ligjore dhe krijimit të tabelave të përputhmërisë në kuadër të ndryshimeve përkatëse në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar.
Në qendër të kësaj nisme ligjore, të ndërmarrë nga një deputet i Kuvendit të Shqipërisë, është prezantimi i një kuadri të ri për transparencën e pronësisë së medias, i cili detyron ofruesit e shërbimeve mediatike të deklarojnë informacion të detajuar mbi identitetin e tyre ligjor, strukturat e pronësisë, pronarët përfitues, pjesëmarrjen e shtetit dhe të ardhurat nga reklamat shtetërore dhe nga autoritetet publike të vendeve të treta. AMA ngarkohet me krijimin dhe mirëmbajtjen e një regjistri kombëtar të pronësisë së medias dhe me garantimin që këto të dhëna të jenë publikisht të aksesueshme, të sakta dhe të përditësuara rregullisht, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit. Këto masa transpozojnë drejtpërdrejt nenin 6 të Aktit Europian të Lirisë së Medias, EMFA dhe nenin 5 të AVMSD, të cilat kërkojnë që shtetet anëtare të sigurojnë transparencën e pronësisë së medias dhe të marrëdhënieve financiare me autoritetet publike, duke respektuar njëkohësisht parimet e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Europian në fushën e


INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL

medias dhe në funksion të adresimit të piketave të ndërmjetme të identifikuara nga Komisioni Europian në lidhje me garantimin e pluralizmit mediatik dhe pavarësisë editoriale, Drejtoria e Legjislacionit dhe Integrimit Europian ka ofruar ekspertizë të specializuar në kuadër të Platformës së Dialogut, si mekanizëm konsultimi dhe bashkëpunimi me aktorët e sektorit të medias, për vendosjen e një regjimi të posaçëm për kontrollin e përqendrimit të medias. Ky regjim synon vendosjen e një mekanizmi të dedikuar rregullator për vlerësimin e përqendrimeve në sektorin mediatik, duke i atribuar Autoritetit të Mediave Audiovizive kompetencë ekskluzive për të vlerësuar bashkimet, blerjet dhe ndryshimet e tjera strukturore në sektorin mediatik nga këndvështrimi i pluralizmit mediatik dhe autonomisë editoriale. Regjimi funksionon në mënyrë të pavarur nga zbatimi i ligjit të konkurrencës, por në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Konkurrencës.

Ndër të tjera parashikohen detyrime njoftimi për transaksionet e përqendrimit mediatik, kërkesa për pezullimin e transaksioneve deri në përfundimin e vlerësimit (standstill), garanci procedurale, të drejta pjesëmarrjeje për palë të treta, kritere të posaçme vlerësimi si dhe mekanizma ankimi. Përqendrimet mediatike që reduktojnë ndjeshëm pluralizmin e medias ose autonominë editoriale ndalohen, ndërsa lejohet miratimi me kusht në rastet kur provohen masa mbrojtëse të përshtatshme në interes publik.

Këto dispozita reflektojnë dhe transpozojnë elemente të përkufizimeve 70, 71 dhe 73 si dhe nenin 22 të Aktit Europian për Lirinë e Medias (EMFA), duke vendosur një standard në përputhje me praktikat rregullatore europiane për vlerësimin e përqendrimeve mediatike nga perspektiva e pluralizmit mediatik, të dallueshëm nga analiza ekonomike e konkurrencës. Në këtë kuadër, mekanizmi i propozuar synon gjithashtu vendosjen e një metodologjie të strukturuar për vlerësimin e ndikimit të përqendrimeve mbi pluralizmin mediatik dhe autonominë editoriale, në përputhje me qasjen e vlerësimit të rrezikut (risk-assessment) të parashikuar nga kuadri rregullator europian.

Gjithashtu në përmbushje të detyrimeve ligjore, por edhe të kërkesave që rrjedhin nga procesi i integrimit, AMA ka vijuar punën si një autoritet rregullator kolegjial dhe i pavarur në fushën e shërbimeve të transmetimit audio dhe audioviziv në Shqipëri, shërbimeve të tyre mbështetëse dhe Platformave të Shpërndarjes së Videove. Kjo si zbatim i ligjit organik të AMA-s, me dispozitat që përcaktojnë statusin e Autoritetit, pavarësinë financiare dhe politike, me një Bord të propozuar nga shoqëria civile, ndër profesionistët e dalluar të medias ose të drejtës në vend, dhe të votuar nga Parlamenti dhe me procese pune të përcaktuara nga dinamika të ngjashme apo të njëjta me shumicën e vendeve të tjera europiane.

Në këtë kuadër dhe në zbatim të kësaj ligjshmërie, përmendim rreth 110 vendime të marra gjatë vitit 2025, ose në total gjatë 5 viteve të fundit - rreth 550 vendime të marra nga Bordi i AMA-s, mbi 60% e të cilave qenë me dakortësi unanime, të shprehura përmes procesit të votimit. Çka tregon se ky Bord i është bindur vetëm ligjit. Në tërësinë e këtyre vendimeve përfshihen 27 vendime për konstatim pavlefshmërie licence/ autorizimi; 48 vendime për rinovimin e licencave; 76 vendime për rinovimin e autorizimit; 6 vendime për heqjen e licencave; 7 vendime për heqjen e autorizimit; 2 vendime për dhënien e licencave; 43 vendime për dhënien e autorizimit; 17 vendime për akte nënligjore të ndryshme; 9 vendime për çelje gare për frekuenca të lira Audio/Audiovizive. Autoriteti i Mediave Audiovizive ka kryer monitorimin e 7 fushatave zgjedhore (2 fushata zgjedhore për zgjedhje të përgjithshme parlamentare; 1 për zgjedhje të përgjithshme vendore; 4 për zgjedhje të pjesshme vendore); janë marrë vendime për 38 gjoba për përmbajtje dhe 44 gjoba për pirateri televizive, të cilat në total llogariten në mbi 80 milion lekë.
Në morinë e këtyre vendimeve, asnjë prej tyre nuk është pretenduar qoftë nga shoqëria civile, qoftë nga vetë industria apo nga partitë politike si i marrë me ndikim politik.
Gjithashtu mekanizmi i financimit të AMA-s si një institucion i vetëfinancuar (nenet 24–27 të ligjit) është strukturuar për të siguruar qëndrueshmëri financiare dhe autonomi institucionale. Aktiviteti i Autoritetit udhëhiqet nga parimet e transparencës dhe llogaridhënies, duke siguruar njëkohësisht që burimet të përdoren në mënyrë efikase për të përmbushur detyrat e tij statutore.
Një tjetër tregues konkret që përforcon besueshmërinë institucionale dhe funksionimin efektiv të pavarësisë së Autoritetit në praktikë, janë edhe rezultatet e arritura në ligjshmërinë e vendimeve të AMA-s. Gjatë vitit raportues janë shënuar 15 procese gjyqësore të fituara në Gjykatën e Shkallës së Parë, një proces i humbur dhe 13 të tjerë ende në proces. Ky është një tjetër tregues i punës së ekipeve të AMA-s për gjoba të drejta ndaj piraterisë dhe përmbajtjeve në shkelje të ligjit; për procedura të rregullta ligjore; për monitorim dhe inspektim të saktë dhe mbrojtje të subjekteve të ligjshëm.

Në përputhje me detyrimin e vet ligjor, parashikuar në ligjin nr. 97/2013 dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij, Këshilli i Ankesave (KA) ka vijuar të shqyrtojë ankesat e mbërritura në institucion në adresë të OSHMA-ve. Gjithsej, gjatë periudhës raportuese, KA ka shqyrtuar 432 ankesa, të dërguara respektivisht: 84.3% nga individë; 8.56% nga institucione; 4.4% ankesa të paraqitura nga organizata të shoqërisë civile; 2.8% nga subjekte tregtare. Kjo shpërndarje dëshmon një dominim të qartë të individëve si subjekt ankues (një ankesë çdo ditë të vitit) duke reflektuar një nivel të lartë angazhimi qytetar në përdorimin e mekanizmave të ankimit dhe besueshmëri tek Autoriteti i Mediave Audiovizive. Ndërkaq gjatë vitit 2025, ankesat e administruara nga Këshilli i Ankesave përqindja më e madhe e kanë pasur me objekt cenimin e figurës/dinjitetit me 26.1%; cenimin e privatësisë dhe të dhënave personale me 15.4%; ankesa jashtë objektit të veprimtarisë së AMA-s, të përcaktuar nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me 10.5%; për përdorim të skenave të dhunës me 8.8%; me objekt interesin më të lartë të fëmijës me 8.6%; me objekt të drejtën për të harruar me 6%; për cenimin e dinjitetit të viktimës me 5.09%; për shkelje të standardeve të tjera, (etike, profesionale, teknike, gjuhësore) me 4%; për mungesë të etikës së komunikimit me 3.6% dhe me objekt të drejtën e përgjigjes me 2.6%. Kjo shpërndarje reflekton një zhvendosje të fokusit të ankesave, nga temat dominuese të mbrojtjes së të miturve drejt çështjeve të privatësisë, dinjitetit dhe përmbajtjeve me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat individuale.

Sa i takon administrimit të ankesave, Këshilli i Ankesave ka kërkuar paraqitje pretendimesh të subjekteve të përfshira, në 10,8% të rasteve (40 raste). Në 8,1% të rasteve (31 raste), administrimi i ankesave ka përfunduar me Tërheqje Vëmendjeje, si masë korrigjuese në funksion të respektimit të standardeve ligjore dhe etike të transmetimeve audiovizive. Në një pjesë më të kufizuar të rasteve, konkretisht në 1.4% (6 raste), Këshilli i Ankesave ka ndërmarrë thirrje sensibilizuese ose sjellje në vëmendje, me karakter orientues dhe parandalues. Ndërkohë, në 6,8% të rasteve(25 raste), vendimmarrja e Këshillit të Ankesave ka shkuar në favor të lirisë editoriale, duke konstatuar mbizotërimin e lirisë së shprehjes në raport me pretendimet e paraqitura. Së fundi, sanksionet financiare janë vendosur vetëm në 0,8% të rasteve (3 raste), çka dëshmon se këto masa janë përdorur konform funksionit rregullator të Autoritetit, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe me qëllim adresimin e shkeljeve të rënda.

Një prej detyrave të rëndësishme të Autoritetit, në funksion të shërbimit ndaj publikut përmes ofertës programore është edhe shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara. Shqyrtimet janë kryer mbi bazën e planifikimit, duke pasur parasysh problematikat më të shpeshta që hasen në programet e transmetuara, por dhe nga ndjeshmëritë e krijuara në publik për përmbajtje të caktuara. Fokusi kryesor për shqyrtimet tematike të realizuara gjatëvitit 2025 ka qenë mbi aspekte të rëndesishme si mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme; gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit në çdo formë që paraqitet; shkeljet etike në përgjithësi; reklamat dhe komunikimet tregtare; përdorimi i gjuhës shqipe standarde të shkruar dhe të folur; tërësia programore të platformës së RTSH - së, në zbatim të kërkesave të Kontratës së Shërbimit, etj..

Monitorimi është adresuar në përmbajtjet e transmetuara në OSHMA-të me licencë kombëtare apo ato lokale/rajonale; në OSHMA-të që kanë format programacioni gjeneralist apo tematik.
Nga 329 raste shqyrtimesh që janë analizuar gjatë vitit 2025, janë identifikuar 106 raste që nuk kanë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi. Nga 106 rastet e shkeljeve të identifikuara, pas analizimit të detajuar dhe profesional, referuar dhe kuadrit legjislativ, për 94 raste AMA ka dërguar njoftim zyrtar tek OSHMA-të për "Tërheqje vëmendjeje", kurse për 12 raste ka dërguar njoftimin "Sanksion me gjobë".

Rastet e shqyrtuara dhe të analizuara kanë qenë jo vetëm në programet debatuese, por dhe gjatë edicioneve informative në formën e deklarimeve me gjuhë urrejtjeje. Tipologjia e shkeljeve të kësaj kategorie në pjesën më të madhe ka qenë me ka qenë me përdorim gjuhe urrejtjeje (në 21 raste); shkelje etike (në 11 raste) dhe në formën e diskriminimit janë identifikuar 9 raste (2 racizëm, 2 mizogjini, 2 krahiniste, 2 mbi bazën e besimit fetar, si dhe 1 rast si diskriminim social).
Rëndësi të veçantë i është kushtuar edhe mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme (23 raste të gjetura në shkelje), problematikave me reklamat dhe komunikimet tregtare (22 raste); përdorimi i saktë i gjuhës shqipe të shkruar e të folur etj. Angazhim i rëndësishëm i Autoritetit ka qenë edhe gjatë monitorimit të proceseve zgjedhore, respektivisht: Zgjedhjet e përgjithshme të 11 Majit 2025 dhe zgjedhjet e pjeshme të 9

nëntorit 2025 të zhvilluara në 5 bashki të vendit. Në monitorimin e zgjedhjeve të përgjithshme të 11 Majit u monitoruan 29 OSHMA të përhershme, gjatë gjithë fushatës (25 TV dhe 4 radio kombëtare) dhe 28 OSHMA të përkohshme, me zgjedhje javore (OSHMA lokale). Puna filloi me filloi me 13 janar 2025 bashkepunimin me KQZ mbi pasqyrimin e aktiviteteve të ndaluara publike; me marrjen e masave paraprake, takime dhe informime me ekspertë vendas dhë të huaj, kosultime të vazhdueshme me OSHMA-të dhe më tej me procesin e monitorimit gjatë fushtës. Në fokus të monitorimeve të fushatës janë edicionet e lajmeve, debatet dhe forumet, mbulimet live, reklamat politike, prezantimi i sondazheve zgjedhore, sipas Kodit Elektoral. AMA çdo ditë i ka dërguar KQZ-së 36 skeda të gjetjeve për 29 OSHMA e monitorimit të përhershëm dhe 7 OSHMA-ve të monitorimit të përkohshëm. Gjithashtu i janë dërguar KQZ-së edhe raportet javore të miratuara nga Bordi i AMA-s. Raportet ditore dhe ato javore janë publikuar menjëherë nga KQZ në webiste-n e vet, si dhe ky institucion ja ka përcjellë OSHMA-ve dhe me email. Nga ky proces ka pasur ankesa nga 2 OSHMA-të, cilat ngrinin si shqetësim faktin se nuk kishin marrë asnjë reklamë politike nga subjektet zgjedhore, si dhe nga institucionet. Ankesat ju përcollën KQZ-së.

Procesi është përsëritur për zgjedhjet e pjesshhme të 9 nëntorit dhe grupi prej 34 monitoruesish ka zhvilluar edhe një trajnim mbi kërkesat e Kodit Zgjedhor, si dhe të Metodologjisë së Monitorimit, duke u ndaluar në mënyrë të veçantë tek risitë e procesit të 9 nëntorit, ku si garues do të ishin dhe kandidatë të pavarur.

Lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit, Autoriteti, gjatë vitit 2025 ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh të subjekteve kabllore/IPTV/OTT në terren. Viti 2025, solli të reja në mënyrën e kryerjes së kontrolleve për shkeljen e të drejtave të transmetimit, ku specialistë pranë kësaj drejtorie kanë kryer dhe monitorimin e rrjeteve online pranë zyrave të institucionit, duke identifikuar një sërë rastesh të përdorimit të serverave të ndyshëm që përdoreshin për shpërndarjen dhe shitjen e produkteve audiovizive në mënyrë pirate. Pas identifikimit të këtyre shkeljeve, AMA, i ka raportuar ato pranë institucionit ligjzbatuese për marrjen e masave për bllokimin e këtyre serverave. Gjithashtu, një fokus të veçantë ka pasur inspektimi dhe monitorimi i subjekteve audiovizive të autorizuara nga AMA për përsëritjen e kontentit audioviziv në lidhje me buketën programore që i ofrojnë qytetarëve, me cilësinë e transmetimeve si dhe me monitorimin e tyre për respektimin e kushteve të autorizimit. Inspektimi në këto subjekte kyhet kryesisht për monitorimin e kontentit që ato transmetojnë, duke kontrolluar nësë ky kontent është në përputhje me kontratat që ata depozitojnë në AMA çdo fillim viti.

Inspektimet janë kryer në bazë të ankesave të depozituara nga subjektet mbajtës të së drejtës, por dhe kryesisht nga AMA. Të gjitha ankesat/kërkesat e operatorëve për ndërhyrje mbi mosrespektimin e të drejtës së transmetimit nga subjektet kabllore/IPTV/OTT, autoriteti i ka realizuar duke iu dhënë përgjigje të gjithë subjekteve ankuese, si dhe duke marrë masat përkatëse në rast shkeljesh.
Vlen të theksohet se, pjesa dërrmuese e ankesave për shkeljen e të drejtave të transmetimit, gjatë vitit 2025, lidhet me fenomenin e piraterisë televizive që kryhet nga subjekte të paautorizuara nga AMA për ofrimin e shërbimit audioviziv. Konkretisht, bëhet fjalë për subjekte ISP (Internet Service Provider), të cilët nëpërmjet internetit kryejnë pirateri televizive pa autorizim nga AMA. Po ashtu një fenomen tjetër shqetësues që po shihet së fundmi është dhe shpërndarja e linqeve të ndryshme nëpërmjet grupeve që operojnë në rrjetet Telegram dhe Facebook.
Në këtë kuadër AMA mori masa për mbylljen e më shumë se 10 serverave që operonin brenda territorit të vendit tonë, të cilët transmetonin kontent audioviziv pa të drejta si dhe bëri të mundur sanksionimin e 2 subjekteve ISP që operonin në kundërshtim me ligjin 97/2013, të ndryshuar duke i gjobitur ato me nga 5.000.000 lekë secilin. Sqarojmë se, fenomeni i piraterisë televizive që kryhet nëpërmjet internetit, është një fenomen sa shqetësues aq dhe i komplikuar për t'u identifikuar, për arsye se në shumicën e rasteve produkti audioviziv që transmetohet abuzivisht, vjen nga servera të vendeve të ndryshme të botës. Sa i përket serverave që operojnë jashtë vendit tonë, u konstatuan 4 të tillë. Për këto servera u bashkëpunua me providera në vendet ku ato ushtronin aktivitetin dhe u bë e mundur bllokimi i tyre. I suksesshëm ka rezultuar edhe bashkëpunimi me platformat e shpërndarjes së videove për bllokimin e piraterisë. Gjatë periudhës Janar-Mars 2025 (deri kur TikTok u bllokua përkohësisht në Shqipëri), AMA bllokoi 579 linke që transmetonin produkt audioviziv pa të drejta transmetimi.
Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes në AMA, gjatë vitit 2025, përmes grupeve të veta të inspektimit, ushtroi 281 kontrolle të aktivitetit të OSHMA-ve.

Inspektimet u kryen nga ankesat e marra nga subjektet mbajtës të së drejtave, por dhe nga AMA kryesisht. Në përfundim të kontrolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative, janë marrë 12 vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA, që janë konstatuar në shkelje të ligjit dhe për 15 raste të tjera është vendosur masa "Tërheqje vëmendje".

Në total gjatë vitit raportues, AMA ka marrë 32 vendime me sanksione gjobë për shkelësit e ligjit dhe 141 Tërheqje Vëmendje.
Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në cilësinë e autoritetit rregullator, ka vijuar angazhimin e tij nxitës për krijimin e një sistemi transparent, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të Matjes së Shikueshmërisë audiovizive në tregun shqiptar, duke mbështetur dhe asistuar ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA). Në këtë kuadër, AMA ka ndërmarrë një sërë iniciativash konsultative me aktorët kryesorë të tregut mediatik dhe të industrisë së reklamave, me synim funksionalizimin e Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI), si mekanizëm vetërregullues dhe përfaqësues i industrisë për administrimin e procesit të Matjes së Shikueshmërisë. Si rezultat i një procesi të strukturuar dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet palëve të interesuara, është arritur konstituimi i KPI-së dhe ndërmarrja e hapave institucionalë për formalizimin e tij, përfshirë regjistrimin si subjekt juridik dhe përmbushjen e detyrimeve administrative përkatëse. Kjo fazë përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm të matjes së audiencës në Shqipëri.

Ndër aktivitetet e organizuara nga AMA, gjatë vitit 2025, si një ndër impenjimet kryesore përmendim mbajtjen në Shqipëri, në muajin maj të takimit të 12-të vjetor të Forumit të Autoriteteve Rregullatore të Transmetimeve në Detin e Zi (Black Sea Broadcasting Regulatory Authorities Forum – BRAF). Ky aktivitet mblodhi përfaqësues të niveleve drejtuese të autoriteteve rregullatore të mediave audiovizive nga vendet anëtare të këtij forumi, përfshirë Turqinë, Azerbajxhanin, Greqinë, Serbinë, Armeninë, Bullgarinë, Moldavinë dhe Gjeorgjinë, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme dialogu për çështje me interes të përbashkët për rregullimin e mediave në rajonin e Detit të Zi. Tema qendrore e takimit ishte "Gjuha e Urrejtjes dhe e Drejta për Informim në Mediat Audiovizive dhe Platformat Online", një temë që pasqyron sfidat aktuale me të cilat përballen autoritetet rregullatore në një mjedis mediatik gjithnjë e më të ndërlidhur dhe të ndikuar nga zhvillimet digjitale. Diskutimet u përqendruan në mënyrën se si autoritetet rregullatore mund të adresojnë përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjeve diskriminuese, duke garantuar njëkohësisht respektimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtës së publikut për informim të saktë dhe të besueshëm. Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vijuar dhe thelluar angazhimin e tij strategjik në fushën e edukimit mediatik, duke e konsideruar këtë dimension si një nga instrumentet kryesore parandaluese për mbrojtjen e interesit publik, forcimin e të menduarit kritik dhe rritjen e rezistencës së publikut, veçanërisht të të rinjve dhe fëmijëve, ndaj rreziqeve të mjedisit audioviziv dhe digjital.

Në këtë kuadër, AMA ka vijuar aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese me nxënës të shkollave të mesme, duke e shtrirë këtë program përtej Tiranës. Gjatë vitit raportues, janë zhvilluar takime me gjimnaze të qytetit të Durrësit, ku u trajtuan çështje që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve në mjedisin mediatik dhe digjital. Paralelisht me aktivitetet në shkolla, AMA ka zhvilluar gjatë vitit 2025 një sërë fushatash të strukturuara të edukimit mediatik për publikun e gjerë. Një ndër nismat më të rëndësishme ka qenë bashkëpunimi me Zyrën e OSBE-së në Tiranë, për prodhimin dhe vlerësimin ligjor të një pakete prej dhjetë videosh sensibilizuese, të destinuara për një fushatë kombëtare të edukimit mediatik. Përgjatë gjithë vitit AMA ka vijuar gjithashtu publikimin e materialeve informuese dhe ndërgjegjësuese në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale, përmes infografikave, posterëve digjitalë dhe artikujve tematikë. Këto përmbajtje kanë trajtuar në mënyrë të vazhdueshme tema si mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet e botës virtuale, privatësia dhe të dhënat personale, përdorimi i inteligjencës artificiale në media, dallimi midis lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, rreziqet e piraterisë audiovizive dhe ndikimet e lojërave online tek adoleshentët. Qasja e ndjekur synon ndërtimin e një kulture të qëndrueshme informimi dhe vetëdijeje mediatike në publik.

Gjatë vitit 2025 AMA ka vijuar fushatën ndërgjegjësuese dhe informuese "Fol shqip" me qëllimin e përmirësimit të gjuhës së folur dhe të shkruar në transmetimet audio/audiovizive, fushatë që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e standardeve profesionale të redaksive. Periodikisht AMA ka publikuar në website-n

zyrtar dhe në llogaritë e saj në rrjetet sociale, fjalë të huaja të përdorura nga gazetarët apo dhe formulime të pasakta, të shoqëruara këto me gjegjëset në shqip dhe format e duhura gjuhësore. Gjetjet e kësaj nisme reflektohen edhe në emisionin "Fol Shqip show" që transmetohet në Kosovë dhe Maqedoni.

Gjatë vitit 2025 Autoriteti i Mediave Audiovizive ka zhvilluar një sërë takimesh dhe konferencash jashtë vendit, me institucione të BE-së dhe autoritete rregullatore homologe në rajon, Europë dhe përtej kontinentit europian. Takimet e ndjekura nga AMA kanë qënë të një rëndësie të veçantë, si në kuadër të integrimit të BE-së dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së, ashtu edhe në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave më të mira mes autoriteteve rregullatore për çështje delikate, me të cilat përballet mjedisi mediatik.
Gjithashtu gjatë vitit raportues AMA ka nënshkruar dy Marrëveshje Bashkëpunimi, me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
Marrëveshja me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut ka për qëllim të sigurojë, parandalojë dhe ndalojë shkeljen e të drejtave të transmetimit dhe të ndihmojë në ndërgjegjësimin për respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura me të, në transmetimet audio dhe audiovizive. Nga ana tjetër, Marrëveshja e lidhur me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore synon forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve, për marrjen e masave, me qëllim rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit në sektorin e mediave audiovizive, në funksion të zbatimit të dispozitave ligjore që lidhen me kushtet e punës, mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, pagat, sigurimet dhe mirëqenien në punë.

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm edhe drejt modernizimit të proceseve të mbledhjes, administrimit dhe analizimit të të dhënave mbi tregun audioviziv, përmes zhvillimit dhe vënies në funksion të një programi elektronik të dedikuar për Regjistrin e Monitorimit dhe Analizimit të të Dhënave. Ky program është konceptuar si një platformë e integruar që synon automatizimin e procesit të raportimit vjetor nga OSHMA-të. Për këtë arsye, AMA ka organizuar një seri aktivitetesh informuese dhe trajnuese me OSHMA-të si dhe me stafin e brendshëm, për përdorimin e këtij sistemi. Në këto trajnime shpjeguese u prezantua funksioni i këtij programi, mënyra e aksesimit dhe hedhja e të dhënave. Programi elektronik është ndërtuar në mënyrë që të garantojë ruajtjen e sigurt të të dhënave, mbrojtjen e anonimatit të subjekteve raportuese dhe publikimin e informacionit vetëm në formë të përpunuar statistikore, pa identifikim individual. Të dhënat e mbledhura përmes sistemit përdoren ekskluzivisht për qëllime analitike, raportuese dhe përgatitjen e Buletinit Periodik, në funksion të transparencës institucionale dhe informimit publik.

Një aspekt i rëndësishëm i punës së AMA-s është edhe bashkëpunimi me institucione dhe organizata, të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias, duke zhvilluar projekte për përmirësimin e infrastrukturës mediatike, promovimin e standardeve të larta etike në fushën e mediave me fokus aspekte të ndryshme të tregut audio dhe audioviziv, hulumtime, studime dhe analiza të fenomeneve dhe zhvillimeve të kohës, publikime në shqip të literaturës së huaj mbi median etj. Gjatë vitit 2025 u finalizuan 7 projekte të tilla dhe u përcaktuan 9 drejtime kryesore për projekte që vazhdojnë të jenë në zbatim për tu finalizuar sipas afateve respektive e ku bëjnë pjesë edhe studimet për Dezinformimin, rritjen e standardeve në gazetari etj.

AMA vijon publikimin e Buletinit Periodik për të siguruar transparencë mbi sektorin audioviziv në Shqipëri. Gjatë vitit 2025 është përgatitur dhe publikuar Edicionit të 11-të i këtij buletini si një instrument kryesor i raportimit vjetor mbi zhvillimet ekonomike, teknologjike, pronësore, përmbajtjes dhe burimet njerëzore në sektorin audioviziv. Buletini vijon të përfaqësojë një mjet themelor transparence dhe informimi publik, duke ofruar një panoramë të detajuar të dinamikave të tregut, sfidave strukturore dhe tendencave të reja në industri.
Buletini Periodik përmban një set të gjerë të dhënash statistikore, ekonomike dhe strukturore, të cilat mblidhen dhe përpunohen nga burime të ndryshme institucionale dhe nga vetë subjektet e licencuara. Në kuadër të këtij procesi, gjatë vitit janë administruar të dhëna mbi renditjen e OSHMA-ve, bazuar në nivelin e të ardhurave totale, performancën ekonomike, bilancet financiare dhe asetet fizike në pronësi. Këto të dhëna kanë shërbyer për ndërtimin e një panorame të përgjithshme mbi strukturën ekonomike të tregut audioviziv dhe për identifikimin e tendencave të zhvillimit të sektorit.



# 1. STRATEGJIA E AUTORITETIT

Gjatë vitit 2025, Objektivat Strategjikë dhe Plani i Veprimit, të përcaktuara në Strategjinë e AMA-s 2024-2026, kanë përkuar me procese në vijimësi, por edhe të reja, të punës së ekipeve të Autoritetit. Për shkak të zhvillimeve të tregut mediatik, të diktuara nga teknologjia, të ndryshimeve a përmirësimeve të mëtejshme të kuadrit ligjor dhe ambicjes për rregullimin e mëtejshëm të tregut audio dhe audioviziv dhe formësimin e tij sipas standardeve europiane, Strategjia përfshin procese dhe veprimtari, të cilat zgjaten në kohë dhe disa prej pikave të Planit të Veprimit janë ende në zbatim.

Objektivat e vendosura nga AMA në Strategjinë 2024-2026, të miratuar me vendimin Nr.18, datë 26.02.2024 të Bordit të AMA-s, të detajuara me një Plan Veprimi, kanë qëllime specifike, ndër të cilat përmendim:

1. Nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare;
2. Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe e pluralizmit në transmetimet audiovizive;
3. Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme, motivuar nga interesi publik;
4. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe i efektivitetit të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të autoritetit;
5. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve dhe përmirësimi i sistemeve të mirëfunksionimit të brendshëm të autoritetit;

Në përmbushje të këtyre qëllimeve dhe në zbatim të Planit të Veprimit, parashikuar në Strategjinë 2024-2026, gjatë vitit raportues, puna e AMA-s, përveç angazhimeve në vijimësi, të cilat gjenden sipas rendit në raportim, është përqëndruar edhe në disa drejtime të tjera, si zbatim i Planit të Veprimit të parashikuar. Ndër këto aktivitete përmendim:

**- Angazhimi i rregullatorit për ndryshimet ligjore sa i takon rritjes së transparencës së OSHMA-ve për reklamën institucionale**

Në kuadër të angazhimit për forcimin e transparencës së OSHMA-ve dhe përafrimin e kuadrit ligjor me standardet evropiane, AMA ka dhënë kontributin e saj teknik në draftin e propozuar për ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Hartimi i këtij drafti është mbështetur në një studim të thelluar, të zhvilluar në bashkëpunim me Këshillin e Europës dhe ekspertë të fushës, duke u bazuar në praktikat më të mira të vendeve evropiane. Ndryshimet e propozuara synojnë transpozimin e plotë të Aktit Europian për Lirinë e Medias (EMFA) dhe Direktivës për Shërbimet Mediatike Audiovizive (AVMSD). Në mënyrë të veçantë drafti përfshin një dispozitë të posaçme për rregullimin e reklamave shtetërore, me qëllim garantimin e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit në shpërndarjen e tyre. Kjo dispozitë transpozon Aktin

Europian për Lirinë e Medias (EMFA), duke forcuar mekanizmat ligjorë për transparencën e reklamës shtetërore dhe duke kontribuar në rritjen e besimit publik dhe integritetit të tregut mediatik audioviziv.

**- Lufta kundër piraterisë televizive dhe funksionimit të licencës audiovizive**

Përveç angazhimit të përditshëm me inspektime dhe monitorime, në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive dhe shkeljes së të drejtave të transmetimit, gjatë vitit 2025 AMA ka vijuar angazhimin për forcimin e masave kundër këtij fenomeni, si dhe për përmirësimin e funksionimit të licencës audiovizive edhe nëpërmjet ndërhyrjeve rregullatore dhe propozimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor. Në kuadër të ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 97/2013, i ndryshuar, është shtuar një nen i posaçëm për piraterinë, i cili përcakton qartë të drejtat e transmetimit audioviziv, detyrimin për kontrata të depozituara pranë AMA-s, përgjegjësitë e subjekteve që transmetojnë pa të drejta, si dhe masat administrative dhe gjobat përkatëse. Përveç kësaj, Vendimi nr. 73/2025 për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren ekzistuese, nr. 99/2017 "Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve", solli përmirësime, shtesa dhe rregullime të mëtejshme, kryesisht në kriteret e përgjithshme për dhënien e autorizimeve. Qëllimi i këtyre iniciativave është vënia fre e fenomenit të piraterisë dhe abuzimit me të drejtën e transmetimit që gëzojnë subjektet e licencuara nga AMA, të cilët sipas ligjit duhet të transmetojnë vetëm në bazë të autorizimit/licencës që kanë marrë për ato shërbime që vetë OSHMA-të kanë kërkuar dhe AMA ka miratuar. Veprimi jashtë këtyre normave ligjore përbën shkelje dhe abuzim me tregun audioviziv, si dhe shkel konkurrencën e ndershme në treg.

**- Nxitja e hartimit të një Plani Kombëtar Strategjik Ndërinstitucional Veprimi për Sigurinë e Gazetarëve**

Gjatë vitit raportues, përveç pjesëmarrjes aktive me kontribute informative e ligjore, në mediumin shumëpalësh, institucione-shoqëri civile-akademikë, organizuar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës, dhe financuar nga BE/KE, i quajtur, "Promovimi i Lirisë së Shprehjes në Shqipëri nëpërmjet Dialogut të Hapur", AMA ka shënuar edhe rekorde të tjera që lidhen me sigurinë e gazetarëve, si një kontribut i ndërveprimit institucional mbi këtë çështje.

Në këtë kuadër përmendim Memorandumin e Bashkëpunimit me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe bashkërendimin e planeve të punës me këtë institucion, në themel të të cilave qëndron pikërisht mbrojtja ligjore dhe siguria e gazetarëve në punë.
Gjithashtu përmendim si të rëndësishëm, kontributin e dhënë nga ekipi i drejtorisë ligjore në Draft Kodin e ri Penal, i përqendruar pikërisht në mbrojtjen e gazetarëve dhe lirinë e medias. Nga vërejtja e draftit, disa nga nenet problematike për lirinë e medias janë nënvizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, duke dhënë shpjegimin për secilin prej tyre. Respektivisht përmendim:

- Nenet 235–236 – "Përdhosja e Republikës dhe simboleve të saj"
- Neni 267 – Përvetësimi, përpunimi dhe shpërndarja e paautorizuar e të dhënave
- Neni 865 – Shpifja
- Neni 863 – Fyerja
- Neni 536 – Ndikimi në pavarësinë e gjykatës

**- Mbështetje në publikim studimesh dhe raportesh për mbrojtjen e gazetarëve dhe luftën ndaj Dezinformimit dhe Gjuhës së Urrejtjes**

Në Planin Strategjik të Veprimit 2024-2026, hartuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, një nga qëllimet strategjike dhe objektivat e punës së institucionit rregullator është nxitja dhe mbështetja e standardeve profesionale në rritje të transmetimeve audiovizive nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare. Në përputhje me këtë plan, në fushën e komunikimit dhe publikimit, një nga veprimtaritë me përparësi është mbështetja në publikim studimesh dhe raportesh për mbrojtjen e gazetarëve, luftën ndaj dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes etj.

Në këtë kuadër, gjatë vitit raportues, sektori i publikimeve në Autoritetin e Mediave Audiovizive ka filluar zbatimin e tre projekteve, lidhur specifikisht me temën e Dezinformimit. Respektivisht:

**1. Dezinformimi në hapësirën digjitale shqiptare, një analizë e përditësuar e sfidave dhe zgjidhjeve**

Qëllimi i këtij projekti është një analizë e thelluar shkencore mbi sfidat dhe zgjidhjet që paraqet problematika e Dezinformimit në Shqipëri në hapësirën virtuale. Kjo ndodh në një kohë kur informacioni dhe konsumimi i përmbajtjeve mediatike në hapësirën virtuale merr një rëndësi të

jashtëzakonshme në jetën e një individi në Shqipëri, në kushtet kur pjesa më e madhe e shoqërisë shqiptare është pjesë e kësaj hapësire. Një pjesë e mediave audiovizive në Shqipëri kontribuojnë në këtë hapësirë digjitale nëpërmjet profileve të tyre në rrjetet sociale, duke u bërë kështu edhe një objekt i detyrueshëm shkencor për t'u analizuar në këtë këndvështrim..

**2. Infodemia, dezinformimi në fushën mjekësore**

Në epokën e informacionit digjital dhe rrjeteve sociale, përhapja e Dezinformatave dhe lajmeve të rreme në fushën e shëndetësisë, e njohur si Infodemi, paraqet një kërcënim serioz për shëndetin publik, besimin tek institucionet dhe vendimmarrjen individuale. Pandemia e Covid-19 nxori në pah nevojën kritike për edukim mediatik dhe për forcimin e kapaciteteve të aktorëve të medias për të përhapur informacion të verifikuar dhe bazuar në prova shkencore. Në këtë kuadër synohet të zhvillohet dhe botohet një manual edukativ për gazetarët, profesionistët e medias dhe publikun e gjerë mbi rëndësinë e trajtimit të infodemisë dhe informimit të saktë në fushën e shëndetit publik. Kjo do të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit të profesionistëve të medias dhe publikut mbi rreziqet e infodemisë. Gjithashtu projekti ka për qëllim të nxisë praktikën e gazetarisë së përgjegjshme dhe të bazuar në evidenca shkencore në raportimin shëndetësor dhe të shërbejë si mbështetje për edukimin mediatik të publikut për të përballuar dezinformatat.

**3. Dezinformimi në mediat shqiptare, faktor mosbesueshmërie në procesin e informimit**

Në mediat tradicionale dhe ato të reja, Dezinformimi është realitet shqetësues që sjell pasoja të reja ndikimesh negative mbi shoqërinë dhe kryesisht në procesin informues. Në praktikat raportuese në mediat audiovizive dhe ato të reja në Shqipëri vërehen raste të shpeshta dezinformimesh. Dezinformimi sjell pasoja mbi individë të pafajshëm, grupe të pambrojtura sociale apo edhe entitete të ndryshme shoqërore, por edhe mbi profile publike të cilët përballen me situata dhe pasoja prej rasteve dhe raportimeve dezinformuese. Raportimet dezinformuese në shumë raste kanë shkaktuar pasoja tronditëse në shëndetin mendor të publikut. Ky studim krijon mundësinë e pasjes së një pasqyre për cedimet deontologjike në praktikën e hapësirës kohore të një viti, në raportimet dhe procesin informues në skenën mediatike të vendit. Kështu krijohet premisa për një ndjekje të tillë periodike dhe krijimin e një historiku që ndikon në jetën e studimeve universitare për mediat shqiptare dhe dukuritë dezinformuese sikundër edhe për kategoritë e ndryshme të profesionistëve në spektrin multimedial të vendit.

**- Nxitja i transmetimit të përgjegjshëm dhe fuqizimi i audiencave**

Në zbatim të objektivit strategjik "Nxitje i transmetimit të përgjegjshëm/Matje opinioni dhe verifikim standardi për operatorin publik dhe operatorët e tjerë audiovizivë", angazhimi i nisur në dhjetor 2024 nga Këshilli i Ankesave për realizimin e studimit të parë kombëtar sasior mbi perceptimin e publikut për standardet etike të ofertës audiovizive dhe digjitale u përmbyll më sukses në mars 2025. Studimi, i konceptuar nga Këshilli i Ankesave dhe i zbatuar me INSTAT, u zhvillua me metodologji shkencore dhe kampion përfaqësues kombëtar. Për herë të parë u analizuan në mënyrë të strukturuar jo vetëm standardet tradicionale etike, por edhe perceptimet mbi dezinformimin, platformat online, mbrojtjen e fëmijëve, të dhënat personale dhe presionet mbi profesionin e gazetarit.

Gjithashtu në zbatim të objektivit strategjik, "Promovimi i transmetimit të përgjegjshëm/Rrjeti i Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave", gjatë vitit 2025 u hodhën hapa konkretë thelbësorë drejt funksionalizimit real të Rrjetit të Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-ve, me synim konsolidimin e plotë të tij gjatë vitit 2026. Qasja e ndjekur synon kalimin nga një praktikë formale drejt një modeli funksional dhe të standardizuar, në përputhje me nenin 51 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar. Në këtë kuadër janë planifikuar dhe zhvilluar takime e konsulta në 12 qarqe, përfshirë Tiranën, me drejtim verifikimin e efektivitetit të bordeve ekzistuese, këshillimin praktik të transmetuesve dhe trajnimin e anëtarëve të tyre lidhur me detyrimet ligjore, transparencën procedurale dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërhyrja kombinon kontrollin në terren me standardizimin e praktikave, përmes unifikimit të përbërjes së bordeve, formularëve, afateve, procedurave të vendimmarrjes dhe dokumentimit të procesverbaleve. Objektivi i matshëm është funksionalizimi i të paktën 35 OSHMA-ve me borde

aktive dhe trajnimi i mbi 150 anëtarëve, duke rritur cilësinë e trajtimit të ankesave dhe besueshmërinë e publikut ndaj mekanizmit të bashkërregullimit. Paralelisht, është konceptuar një paketë mbështetëse që përfshin hartimin e një manuali praktik për unifikimin e rregullave të punës si edhe ngritjen e një platforme digjitale të integruar për regjistrimin, ndjekjen dhe raportimin e ankesave. Këto instrumente synojnë të garantojnë gjurmueshmëri të plotë të çdo rasti, formalizim të komunikimit ndërmjet AMA-s dhe OSHMA-ve, si dhe krijimin e një arkive të unifikuar vendimmarrjesh që forcon transparencën dhe llogaridhënien institucionale.



# 2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2024

**- Në kuadër të ndryshimeve ligjore në ligjin 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në zbatim të rekomandimeve të BE-së, bazuar në praktikat e së drejtën europiane mbi reklamat institucionale, të propozojë ndryshimet përkatëse në ligj, të cilat ndër të tjera të rregullojnë procesin që AMA kryen lidhur me matjen e volumit të reklamës institucionale.**

Në nenin 3 pika 28 "Përkufizime" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, jepet vetëm përkufizimi/koncepti se çfarë janë reklamat institucionale, përkatësisht: "Reklama institucionale" janë reklamat e porositura nga një institucion shtetëror, për të promovuar veprimtarinë e institucionit, me qëllim që të nxisë, të përkrahë dhe mbrojë vlerat dhe qëndrimet që konsolidojnë demokracinë, mirëqenien, shëndetin publik dhe sigurinë kombëtare".

Në nenin 40 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, jepet përcaktimi se kur reklama konsiderohet institucionale:
1.Reklama institucionale është ofrimi i informacionit mbi shërbimet e institucioneve publike.
2. Nxitja e drejtpërdrejtë ose jo e konfuzionit, në lidhje me identifikimin e institucioneve me tiparet e partive politike, nuk lejohet.
3. Gjatë periudhës zgjedhore transmetimi i reklamave institucionale bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Në përputhje me dispozitat aktuale ligjore, Autoriteti i Mediave Audiovizive kryen monitorimin e volumit të reklamave. Në zbatim të kërkesës së Kuvendit, nga janari i vitit 2023 e në vijim, AMA gjithashtu monitoron çdo muaj edhe volumin që zë reklama institucionale në totalin e volumit të reklamave, të televizioneve kombëtare dhe të dhënat i dërgon pranë Kuvendit dhe i publikon në faqen zyrtare të institucionit, si tregues i transparencës së procesit të monitorimit të volumit të reklamave në subjektet audiovizive.

**- Në lidhje me rekomandimet e BE-së mbi reklamën institucionale më poshtë paraqesim disa rekomandime:**

Akti Europian për Lirinë e Medias (EMFA) vendos detyrime të reja ligjore mbi autoritetet publike dhe entitetet në lidhje me reklamën shtetërore. Të gjitha autoritetet publike dhe entitetet duhet:
- Të kenë të përcaktuara kriteret dhe procedurat e duhura për dhënien dhe shpërndarjen e reklamave shtetërore, në mënyrë transparente dhe të paanshme;

· Të mbledhin dhe publikojnë informacionin mbi shpenzimet e kryera për reklamimin shtetëror, duke siguruar qartësi dhe llogaridhënie ndaj publikut.

EMFA përcakton reklamën shtetërore dhe kontratat e furnizimit ose shërbimit si:
Vendosjen, promovimin, publikimin ose shpërndarjen, në çdo shërbim mediatik ose Platformë të Shpërndarjes së Videove, të një mesazhi promovues ose vetë-promovues, një njoftimi publik ose një fushate informimi, zakonisht në këmbim të pagesës ose ndonjë shpërblimi tjetër, nga, për ose në emër të një autoriteti publik ose entiteti. Ky përkufizim mbulon reklamën nga ofruesit e shërbimeve mediatike (si TV, radio, shërbime streaming, gazeta, faqet e lajmeve online ose podkaste) ose ofruesit e Platformave të Shpërndarjes së Videove (si Facebook, Instagram, YouTube, TikTok ose X) nga një gamë e gjerë autoritetesh publike dhe entitetesh. Gjithashtu, reklama e vendosur në emër të një autoriteti publik ose entiteti nga një ndërmjetës (p.sh., një agjenci reklamuese) gjithashtu përfshihet nga ky përkufizim dhe duhet të raportohet.

- Mbi praktikat e të drejtës europiane për reklamat institucionale paraqesim sa më poshtë:

**Portugalia** – Ligji nr. 95/2015, i ndryshuar nga Ligji 19/2023
Ky ligj synon të garantojë transparencën dhe të përcaktojë rregullat për hartimin dhe shpërndarjen e reklamave institucionale nga shteti në mediat lokale dhe rajonale. Ai zbatohet për institucionet publike, administratën qendrore, entitetet publike të pavarura, institucionet kulturore, si edhe subjektet që veprojnë në sektorin ekonomik publik.
Sipas nenit 3, pika (a) të këtij ligji,

**"Reklamë institucionale shtetërore"** nënkupton fushatat, veprimet informuese dhe promovuese, si edhe çdo formë tjetër komunikimi të realizuar nga subjektet e përmendura në nenin paraprak. Këto komunikime u drejtohen një audience të gjerë dhe të pacaktuar marrësish, me synimin, direkt ose indirekt, për të promovuar nisma apo për të transmetuar mesazhe që lidhen me qëllimet, kompetencat ose misionet e tyre të shërbimit publik, përmes blerjes së hapësirës reklamuese me pagesë.
Reklamat duhet të bazohen në objektiva të qarta me interes publik, të identifikojnë në mënyrë të dukshme institucionin përgjegjës dhe të kontribuojnë në promovimin e të drejtave dhe diversitetit. Sa i përket rregullave të shpërndarjes, së paku 25% e buxhetit të çdo fushate me vlerë 5.000 euro ose më shumë duhet t'u dedikohet mediave lokale dhe rajonale. Përveç kësaj, parashikohen kritere të qarta për ndarjen e buxhetit sipas llojit të medias (shtyp, radio, televizion apo media digjitale).

**Spanja** – Ligji nr. 29/2005 për Reklamën dhe Komunikimin Institucional
Ky ligj është miratuar me qëllim të parandalimit të përdorimit politik të komunikimit institucional dhe të garantimit që fushatat informuese të jenë në funksion të qytetarëve, e jo në shërbim të interesave të qeverisë.
Sipas nenit 2, pika (a) të këtij ligji,

**"Fushatë reklamuese institucionale"** nënkupton çdo veprimtari të planifikuar dhe të organizuar me synimin për të shpërndarë një mesazh apo objektiv të përbashkët, e cila u drejtohet një grupi marrësish dhe realizohet përmes reklamave mediatike të paguara ose të vëna në dispozicion. Këto fushata promovohen ose kontraktohen nga një prej subjekteve të përcaktuara në nenin 1 të ligjit.

Këto reklama lejohen vetëm kur synojnë informimin e qytetarëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, për fushatat shëndetësore, sigurinë publike dhe atë të konsumatorëve, proceset zgjedhore dhe çështje të tjera me interes të përgjithshëm. Ndalohet përdorimi i tyre për të theksuar arritje qeveritare, për të nxitur tensione politike, diskriminim apo dhunë, si edhe për të krijuar konfuzion midis institucioneve publike dhe partive politike.

Për të garantuar transparencën e reklamave dhe komunikimeve institucionale, është krijuar Komisioni

për Reklamën dhe Komunikimin Institucional, i cili mbikëqyr planifikimin dhe zbatimin e fushatave. Në këtë kuadër hartohen një plan vjetor dhe një raport vjetor, të cilat i paraqiten Parlamentit dhe publikohen për qytetarët.

Në përmbledhje, kornizat ligjore të Portugalisë dhe Spanjës synojnë të sigurojnë që reklamat institucionale të përdoren vetëm në funksion të interesit publik, duke garantuar transparencë, proporcionalitet dhe shmangie të çdo përdorimi politik. Megjithatë, pavarësisht detajimit të kritereve për përmbajtjen, shpërndarjen dhe mbikëqyrjen e fushatave, këto legjislacione nuk parashikojnë mekanizma të posaçëm për matjen e volumit të reklamave institucionale. Kjo tregon se vlerësimi i ndikimit apo i intensitetit të tyre mbetet një aspekt ende i paadresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga këto dispozita ligjore.
Në shumë shtete nuk ekziston legjislacion i veçantë mbi shpërndarjen e reklamës shtetërore tek mediat. Në Irlandë dhe Luksemburg nuk ka rregulla specifike mbi reklamimin shtetëror në media. Në Kroaci, shpërndarja e reklamës shtetërore rregullohet për entitetet që zotërohen kryesisht nga shteti. Raporti i Shtetit të së Drejtës 2020 (fq. 13) përmend se: Ligji për Mediat Elektronike përcakton se administrata shtetërore duhet të përdorë 15% të fondeve vjetore, të paracaktuara për reklamimin e shërbimeve ose aktiviteteve të tyre, për reklamim në programet audiovizive dhe radiofonike të transmetuesve televizivë ose radio lokale ose rajonale.

Ligji për Median në Kroaci parashikon si vijon: Brenda datës 30 prill të çdo viti, publikuesit janë të detyruar të dorëzojnë përpara Dhomës Kroate të Ekonomisë një raport mbi transaksionet e tyre financiare për vitin paraprak, i cili përmban të dhëna mbi të ardhurat dhe pjesën e tregut të realizuar në tregun e lexuesve dhe/ose shikuesve dhe/ose dëgjuesve, të ardhurat dhe pjesën e tregut të realizuar në tregun e reklamave, sikurse edhe të dhëna mbi reklamuesit ose agjencitë e marketingut përmes të cilave është realizuar më shumë se 10% e të ardhurave vjetore të marketingut të publikuesit.

Në Itali, ekzistojnë rregulla mbi reklamën shtetërore, pra autoritetet publike që blejnë hapësira reklamuese në mediat masive duhet të informojnë AGCOM mbi shpenzimet reklamuese të vitit financiar të kaluar përmes një mjeti elektronik të miratuar nga AGCOM, si dhe vendosen kritere për shpenzimet dhe gjoba të rënda në rast të shkeljes së tyre.

Në Francë, shpërndarja dhe alokimi i mbështetjes shtetërore për kompanitë mediatike rregullohet nga legjislacioni mbi prokurimet publike dhe nga ligji që përcakton funksionimin e Shërbimit të Informacionit të Qeverisë. Konkretisht, kjo rregullohet nga Urdhri 2018-1074 i 26 nëntorit 2018 dhe Dekreti 2000-1027 i 18 tetorit 2000.

Në Austri, organizatat mediatike kanë detyrime të qarta për raportim ndaj autoritetit kombëtar të rregullimit të mediave, KommAustria, si dhe ndaj Gjykatës së Auditit të Austrisë (Austrian Court of Audit, ACA). Çdo gjashtë muaj, ACA dorëzon në KommAustria një listë të të gjitha personave juridikë që ajo monitoron dhe që janë subjekt i auditimeve të saj, duke përfshirë emrat dhe organet ekzekutive të tyre.

Ndryshe nga Franca ose Spanja, Gjermania nuk ka një traditë të ndërhyrjes direkte në sektorin e mediave komerciale. Qasja gjermane fokusohet më shumë në rregullimin indirekt dhe mbikëqyrjen e tregut, sesa në përfshirjen aktive të shtetit në shpërndarjen e reklamimit ose mbështetjes financiare për mediat komerciale.

Në vende si Finlanda, Danimarka, Suedia, Norvegjia dhe Zvicra, nuk ekziston një rregullim specifik mbi shpërndarjen e reklamimit shtetëror, dhe nuk janë të zotërueshme të dhëna sistematike mbi këtë proces.
Për gjithë sa më sipër dhe në zbatim të rekomandimit të Kuvendit, Shqipëria duhet të miratojë një kuadër ligjor të reformuar për të nxjerrë rregulla mbi shpërndarjen e reklamave shtetërore dhe burimeve të tjera shtetërore, në përputhje me acquis-n e BE-së dhe standardet europiane dhe duke u bazuar në një dialog gjithëpërfshirës me komunitetin mediatik.

Propozimi për ndryshimin ligjor për shpërndarjen e reklamave shtetërore është parashikuar në ndryshimet që propozohen t'i bëhen ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në RSH" i ndryshuar, si më poshtë:

**1- Shpërndarja e fondeve publike për reklamat shtetërore dhe kontratat e furnizimit ose shërbimit**
AMA luan një rol thelbësor në inkurajimin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive për përgatitjen e kodeve të sjelljes, të cilat përcaktojnë standardet dhe praktikat lidhur me komunikimet e papërshtatshme me natyrë tregtare.

Monitorimi i volumit të reklamave kryhet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit, si pjesë e procesit të matjes së përgjithshme të volumit të reklamave, përfshirë edhe reklamat institucionale, si tregues i transparencës së procesit të monitorimit të volumit të reklamave në subjektet audiovizive, veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore.

Në projekt propozimet për ndryshime ligjore, ndër të tjera, AMA ka përfshirë dispozita që synonjnë të adresojnë boshllëqet ligjore dhe që forcojnë transparencën në financimet publike dhe në reklamimin institucional, duke përcaktuar rregulla për shpërndarjen e fondeve publike për reklamat shtetërore dhe kontratat e furnizimit ose shërbimit. Në këtë drejtim AMA angazhohet në mbështetjen e transparencës duke siguruar që shpërndarja e fondeve publike të ketë si qëllim garantimin e pluralizmit mediatik, veçanërisht duke përfituar një gamë të ndryshme të ofruesve të shërbimeve mediatike.

Neni 25 (EMFA) i transpozuar, shprehimisht përcakton se:
Duke marrë parasysh se reklamat shtetërore dhe shpërndarja e fondeve publike mund të shkaktojnë deformime të konkurrencës, të ofrojnë subvencione të fshehta dhe të ushtrojnë ndikim të paarsyeshëm politik mbi mediat, AMA angazhohet në mbështetjen e transparencës në këtë sektor dhe të sigurojë që shpërndarja e fondeve publike të ketë si qëllim garantimin e pluralizmit mediatik, veçanërisht duke përfituar një gamë të ndryshme të ofruesve të shërbimeve mediatike. Fondet publike ose çdo konsideratë ose avantazh tjetër i vënë në dispozicion, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga autoritetet ose subjektet publike, ofruesve të shërbimeve të medias ose ofruesve të Platformave të Shpërndarjes së Videove për reklamat shtetërore ose kontratat e furnizimit ose shërbimeve të lidhura me ofruesit e shërbimeve të medias ose ofruesit e Platformave të Shpërndarjes së Videove, do të jepen në përputhje me kriteret transparente, objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese, të publikuara paraprakisht, me anë të mjeteve elektronike dhe miqësore për përdoruesit, si dhe me anë të procedurave të hapura, proporcionale dhe jodiskriminuese.
Ministria kompetete duhet të synojë të sigurojë që shpenzimet vjetore publike për reklamat shtetërore të ndahen në një gamë të gjerë ofruesish të shërbimeve të medias të pranishëm në treg, duke marrë parasysh karakteristikat kombëtare dhe lokale të tregjeve përkatëse mediatike.

**2- Më qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të rolit mbikqyrës dhe rregullator të autoritetit, të punojë për rritjen e kapaciteteve për monitorimin cilësor dhe sasior të transmetimeve audiovizive duke shtuar shqyrtimet që lidhen me diskriminimin, gjuhën e urrejtjes, format e ndryshme të çrregullimit në informacion, proceset zgjedhore etj.**
Rritja e kapaciteteve të stafit të AMA-s është një angazhim i vazhdueshëm. Në kuadër të këtij angazhimi, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bashkëpunim me Rregullatorin Italian, AGCOM, zhvilloi gjatë muajit shkurt të këtij viti, respektivisht në datat 20 dhe 21 shkurt 2025, një trajnim të stafit, për rritjen e kapaciteteve, mbi paraqitjen në kushtet e transmetimeve digjitale dhe formateve të reja të informimit audioviziv.
Gjatë seancave të këtij trajnimi, ku mori pjesë aktivisht edhe ekipi i Drejtorisë së Monitorimit dhe Analizës, u trajtuan aspekte profesionale duke pasur si referencë praktikat më të mira që aplikonte AGCOM, por dhe në vende të tjera të BE-së, të tilla si: disiplina e re e platformave të shpërndarjes së videove; rregullimi në VSP; tri fushat e ndërhyrjes: gjuha e urrejtjes - mbrojtja e të miturve - mbrojtja e konsumatorit; ndalimi i reklamave për lojërat e fatit; kontrolli prindëror online dhe verifikimi i moshës; licenca digjitale për të miturit; standardi i AGCOM mbi influencerat etj.
Gjithashtu në kuadër të detyrimit ligjor që ka AMA, për mënyrën se si i zbatojnë OSHMA-të kërkesat e

Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet e përgjithshme të 11 Majit 2025, si dhe për zgjedhjet e pjesshme lokale në 5 bashki, në 9.11.2025, janë organizuar trajnime me ekipin e monitoruesve të angazhuar në institucion.

Mbështetja ligjore për këtë angazhim të AMA-s, në cilësinë e autoritetit rregullator që monitoron pasqyrimin e fushatës zgjedhore në subjektet ofrues të shërbimit audioviziv (OSHMA), lidhet me zbatimin e nenit 19, pika 16, të ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; neneve 77-85 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe me zbatimin e dispozitave të vendimit të KQZ-së nr. 2, datë 30.01.2021 "Mbi metodologjinë e monitorimit të medias audio dhe audiovizive".

Trajnimet kanë qenë në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore për identifikimin e gjetjeve cilësisht dhe paraqitjen e tyre në kohë pranë KQZ-së. Me pjesëmarrësit janë diskutuar çështje të tilla, si ndarja e kohës për subjektet zgjedhore (parti/koalicione) si dhe aktorët politikë në edicionet e lajmeve; ndarja e kohës për subjektet zgjedhore (parti/koalicione) si dhe aktorët politikë në transmetimet e veprimtarive zgjedhore live; ndarja e kohës për subjektet zgjedhore (parti/koalicione) si dhe aktorët politikë në emisionet mbi procesin zgjedhore; volumin e kohës së transmetimit të reklamave politike etj.

Ndërkaq, në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, miratuar më 30.10.2025, AMA ka nisur zyrtarisht komunikimin me Zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë, përmes znj. Giulia Re dhe Oficeres së Projektit, me të cilat kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm për të mundësuar fillimin e procedurave për organizimin e trajnimit të posaçëm për Drejtorinë e Monitorimit dhe Analizës, pranë AMA-s.

Trajnimi do të jetë në funksion të rritjes së kapaciteteve njerëzore, duke pasur në vëmendje aspekte të përmbajtjeve të papërshtatshme që lidhen me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit, informacionit të shtrembëruar, përmbajtjeve gjatë proceseve zgjedhore dhe standardizimit të punës së monitoruesve me mbështetje teknologjike të avancuar. Jemi në kontakt me përfaqësuesit e KiE-së në Tiranë, për të mundësuar fillimin e procedurave për organizimin e trajnimit.
Nga AMA është nënvizuar domosdoshmëria e rritjes së kapaciteteve të monitorimit në këto aspekte, por dhe të tjera, që lidhen me nxitjen e cilësisë dhe shumëllojshmërisë programore për publikun, si dhe për të identifikuar raste të papërshtatshme, që nuk respektojnë kërkesat ligjore.

**3- Në kuadër të zbatimit të Kodit të ri të Transmetimit, duke pasur parasysh nga njëra anë, rritjen e ndjeshme të numrit të ankesave që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve (59.5% e ankesave krahasuar me 16.4% në 2023), dhe nga ana tjetër duke parë rritjen e ndjeshme të ankesave lidhur me shmangiet e tjera etike, ku përfshihet përorimi i fjalorit joetik, pasaktësitë apo devijimet në ligjërim, apo moskuptimi i specifikave të gjinive mediatike etj., institucioni të tregojë vëmendje të veçantë lidhur me rastet e ankesave për të drejtat e fëmijëve dhe privatësisë së tyre, si dhe të marrë masa për intensifikimin e edukimit mediatik.**

**Bazuar në të të dhënat statistikore mbi strukturën e ankesave në periudhën janar–dhjetor 2025, ju bëjmë me dije se, Këshilli i Ankesave ka trajtuar 432 ankesa, me objekt, si më poshtë:**

- Dëmtimi i figurës – 26.1%
- Shkelja e privatësisë – 15.4%
- Dhuna ose promovimi i dhunës – 8.8%
- Interesi më i lartë i fëmijës – 8.6%
- E drejta për t'u harruar – 6 %
- Diskriminimi gjinor – 2.5%
- Gjuha e urrejtjes – 0.5%

84% e ankesave janë paraqitur nga individë, ndërsa 16% nga institucione, organizata të shoqërisë civile apo subjekte tregtare. Gjatë kësaj periudhe, KA ka dhënë gjithsej 30 tërheqje vëmendjeje dhe 3 sanksione financiare.

Krahasuar me të dhënat e vitit 2024, të përfshira në Rezolutën e Kuvendit (ku 59.5% e ankesave lidhej me fëmijët), vihet re një ristrukturim i dukshëm i kategorive të shqetësimeve të publikut: rriten ndjeshëm raportimet që lidhen me privatësinë dhe dëmtimin e figurës dhe dhunën, ndërsa çështjet që prekin fëmijët shfaqen të shpërndara në një gamë më të gjerë objektesh specifike.
Kjo pasqyrë dëshmon një ndërgjegjësim të shtuar të qytetarëve, një kulturë më të rafinuar të raportimit, si dhe rritjen e pritshmërive të publikut ndaj standardeve të përmbajtjes audiovizive. Ai njeh domosdoshmërinë e forcimit të edukimit mediatik dhe të rritjes së kapaciteteve parandaluese të AMA-s, në funksion të mbrojtjes së fëmijëve dhe të interesit publik.

## 2.1 Nismat e Edukimit Mediatik

### 2.1.1 Aktivitete edukimi mediatik në institucionet e arsimit parauniversitar

Gjatë vitit 2025, AMA ka vazhduar programin e edukimit mediatik në institucionet e arsimit parauniversitar, duke thelluar punën e nisur në vitin 2024 në kopshte dhe shkolla të Tiranës dhe duke e shtrirë atë në qytete të tjera të vendit. Në këtë kuadër, u zhvilluan disa aktivitete të rëndësishme informuese dhe ndërgjegjësuese me nxënës të shkollave të mesme në Durrës, ku kryetarja e AMA-s zhvilloi takime me gjimnazet "Gjergj Kastrioti", "Naim Frashëri" dhe "Leonik Tomeo". Diskutimet u fokusuan tek gjuha e urrejtjes, bullizmi, ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, dhuna në media, keqpërdorimi i të dhënave personale, si dhe efektet e varësisë nga pajisjet digjitale—çështje të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve.
Gjatë takimeve u theksua se sa më të aftë të jenë nxënësit për të identifikuar rreziqet e botës virtuale, aq më të mbrojtur do të jenë ndërsa lundrojnë në mjedisin digjital dhe përfitojnë në mënyrë të shëndetshme nga teknologjia. Edukimi mediatik është një nga prioritetet e punës së AMA-s, pasi përfaqëson një investim afatgjatë dhe të sigurt për forcimin e të menduarit kritik të publikut dhe rritjen e qëndrueshmërisë së qytetarëve ndaj keqinformimit.

### 2.1.2 Fushata Edukimi Mediatik

Në gusht 2025, AMA nisi një bashkëpunim të strukturuar me Zyrën e OSBE-së në Tiranë, në kuadrin e vlerësimit ligjor dhe prodhimit të dhjetë videove me drejtim zhvillimin e një fushate mediatike e përqendruar te Edukimi Mediatik. AMA verifikoi përputhshmërinë e videove sensibilizuese me Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodin e Transmetimit. Përpara se fushata të niste në RTSH gjatë Javës së Edukimit Mediatik (24–31 tetor 2025), AMA analizoi aspektet ligjore të mesazheve në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijës dhe privatësisë si edhe mesazhet për luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe respektimin e dinjitetit. U propozuan përmirësime në gjuhë, formulime dhe standard gjuhësor dhe u ndërhy në elementët grafikë. Pas reflektimit të komenteve, videot, prej 24 tetorit 2025 u hodhën në transmetim në RTSH dhe subjektet ritransmetues, në kanalet e OSBE-së dhe platformat e AMA-s, respektivisht në linqet:
https://ama.gov.al/interesi-me-i-larte-i-femijes-dhe-mbrojtja-e-te-miturve-nga-permbajtjet-e-demshme/
https://ama.gov.al/bashkepunimi-ama-osbe-video-kunder-perdorimit-te-gjuhes-se-urrejtjes-ne-transmetime-televizive/
https://ama.gov.al/media-duhet-te-mbroje-te-drejtat-e-njeriut/
Gjithashtu AMA ka punuar gjatë gjithë vitit për Edukimin Mediatik të publikut. Janë publikuar materiale informuese/ndërgjegjësuese, infografika, postera digjitalë dhe informacione të tjera me tema gjithëpërfshirëse, si mbrotja e fëmijëve nga rreziqet e botës virtuale, mbrojtja e privatësisë, e të dhënave personale, përdorimet e Inteligjencës Atificiale, lufta kundër gjuhës së urrejtjes etj.
Publikimet i gjeni në linqet e mëposhtme:
https://ama.gov.al/rreziqet-e-mjediseve-kibernetike-ku-duhet-te-beni-kujdes/
https://ama.gov.al/rreziku-nga-bota-virtuale-komunikimi-me-femijet-tejet-i-rendesishem/
https://ama.gov.al/perdorimet-kryesore-te-inteligjences-artificiale-ne-media/
https://ama.gov.al/dallimi-mes-gjuhes-se-urrejtjes-dhe-lirise-se-fjales/
https://ama.gov.al/kujdes-pirateria-televizive-ka-disa-forma/
https://ama.gov.al/efektet-e-mundshme-te-demshme-te-perdorimit-te-ia/
https://ama.gov.al/lojrat-online-12-per-qind-e-adoleshenteve-te-ekspozuar-ndaj-rreziqeve/
https://ama.gov.al/category/edukimi-mediatik/
https://ama.gov.al/8-shtylla-per-nje-strategji-te-suksesshme-te-prinderimit-digjital/
Këto materiale janë pasqyruar edhe në profilet zyrtare të Kryetares së AMA-s dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, në rrjetet sociale.

**2.1.3 Fushata e konceptuar nga AMA me vëmendje interesin më të lartë të fëmijës**

Gjatë vitit 2025, AMA ka konceptuar dhe zhvilluar një fushatë të posaçme ndërgjegjësimi me fokus mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin audioviziv, në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe parimet e interesit më të lartë të fëmijës. Fushata synoi t'i paraprijë problematikave të evidentuara nga monitorimi dhe ankesat e publikut, duke ofruar mesazhe të qarta, të standardizuara dhe të orientuara drejt prindërve, gazetarëve, edukatorëve dhe vetë fëmijëve. Materialet e fushatës analizuan rreziqet e krahasimit online, përdorimin e fotografive të fëmijëve, ekspozimit ndaj dhunës dhe seksualizimit të hershëm, si dhe rreziqet e manipulimit digjital në Platformat e Shpërndarjes së Videove. Fushata i ndau situatat në tre kategori: përmbajtje që dëmtojnë privatësinë e fëmijës; përmbajtje që e ekspozojnë fëmijën ndaj traumës, dhunës apo stigmatizimit; dhe përmbajtje ku fëmija shfrytëzohet për audiencë, sensacionalizim apo klikime. Për secilin rast u dhanë udhëzime praktike për OSHMA-të, prindërit dhe vetë fëmijët. Videot u publikuan në web-in zyrtar të AMA-s, në linqet respektive:
https://ama.gov.al/te-dhenat-personale-te-femijeve-nuk-ndahen/
https://ama.gov.al/femijet-nuk-jane-audience-e-pambrojtur/
https://ama.gov.al/femija-nuk-perdoret-per-audience/
https://ama.gov.al/mendo-pastaj-kliko/
Fushata parashikoi edhe reformën vizuale të komunikimit (posterë digjitalë, udhëzues infografikë etj), që do të përgatiten për publikim në fillim të vitit 2026. Qëllimi është të forcohet kultura e mbrojtjes së fëmijëve në media dhe të krijohet një standard i unifikuar kombëtar për mënyrën e trajtimit të të miturve në përmbajtjet audiovizive.

- **Të kërkojë që Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive të hartojnë plane veprimi mbi aksesin në mënyrë progresive në shërbimet e ofruara prej tyre nga personat me aftësi të kufizuara si dhe të ketë në vëmendje që pikat e kontaktit në faqen e saj zyrtare për dhënien e informacionit dhe marrjen e ankesave për personat me aftësi të kufizuara, të jenë funksionale dhe lehtësisht të arritshme prej tyre.**

Në përmbushje të detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (neni 4, neni 3/10, neni 32/2 pika 1)dhe në Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023, si edhe në zbatim të pikës 4 të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, miratuar më 30.10.2025, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe aksesin e tyre në median audiovizive Autoriteti i Mediave Audiovizive i ka kërkuar OSHMA-ve marrjen e masave konkrete për të siguruar qasje progresive në shërbimet audiovizive për personat me aftësi të kufizuara dhe për të lehtësuar aksesueshmërinë e këtij komuniteti në faqet WEB, duke garantuar, që:

- faqet e tyre zyrtare online dhe llogaritë në Platformat e Shpërndarjes së Videove të mund të përdoren nga persona, me aftësi të kufizuara dëgjimi dhe shikimi, përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare të aksesueshmërisë (p.sh. ËCAG 2.1), duke përfshirë:
  - modalitet kontrasti (p.sh. high-contrast/dark mode),
  - opsione për personalizimin e madhësisë së tekstit,
  - titra dhe përshkrime audio për përmbajtjet audiovizive,
  - mundësinë e leximit zanor të teksteve (text-to-speech),
  - seksion të posaçëm, të dedikuar për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe kontaktet për asistencë dhe ankesa.

Për plotësimin e këtij detyrimi OSHMA-ve u është lënë një afat kohor prej 60 ditësh nga marrja e shkresës zyrtare të AMA-s, të njoftojnë lidhur me masat e marra apo të planifikuara në këtë drejtim, nëpërmjet evidentimit të hapave konkretë dhe afateve përkatëse.
Në ndjekje të të njëjtit standard faqja zyrtare www.ama.gov.al aktualisht përmban disa funksione thelbësore që mbështesin qasjen e përdoruesve me aftësi të kufizuara, ndër të cilat: modaliteti me kontrast të lartë (dark/high-contrast mode), opsionet për rritjen ose zvogëlimin e madhësisë së gërmave, si dhe përdorimi i një strukture përgjithësisht të qëndrueshme të navigimit. Këto elemente të zbatuara përputhen me modelet e disa autoriteteve rregullatore europiane, si ato të Greqisë, Kroacisë, Belgjikës dhe Spanjës, të cilat ofrojnë mjete të ngjashme të aksesueshmërisë në faqet e tyre zyrtare.

Në vijim, me qëllim përmbushjen e rekomandimit të Kuvendit, AMA do të angazhohet të krijojë në faqen zyrtare një seksion të posaçëm, brenda tremujorit të parë të vitit 2026, të dukshëm qartë në kryefaqe, të emërtuar "Për persona me aftësi të kufizuara". Ky seksion ndër të tjera do të përfshijë informacion zyrtar

mbi të drejtat e aksesit dhe shërbimet publike të AMA-s, kontaktin e personit të caktuar brenda institucionit për trajtimin e kërkesave, ankesave dhe asistencës së kësaj kategorie, udhëzime praktike për përdorimin e mjeteve të aksesueshmërisë të vendosura në faqen zyrtare,si dhe hapësira të dedikuara për dërgimin e ankesave, sugjerimeve dhe kërkesave për asistencë. Krijimi i këtij seksioni synon të forcojë transparencën institucionale dhe të garantojë qasje të barabartë në informacion, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe të standardeve WCAG 2.1 nivel AA.
Në funksion të garantimit të komunikimit efektiv me qytetarët me aftësi të kufizuara, AMA do të vendosë një formular të thjeshtuar kontakti, i cili do të përmbajë:

- etiketim të qartë të të gjitha fushave (clear and descriptive labels);
- struktura të lexueshme dhe të kuptueshme pa barriera teknike;
- mundësinë e përdorimit të tastierës për dorëzimin e kërkesës (keyboard navigation);
- opsionin e leximit zanor të përmbajtjes (read-aloud /voice guidance) kur përdoruesi e kërkon këtë funksion;
- sinjalistikë të qartë vizuale për përdoruesit me vështirësi të perceptimit.

Ky mekanizëm do të garantojë që procesi i komunikimit me AMA-në të mos jetë pengesë teknike dhe të respektojë parimet e aksesit universal. AMA do të vlerësojë implementimin e një moduli të avancuar "all-in-one accessibility", të ngjashëm me platformat e specializuara ndërkombëtare, i cili përfshin disa funksionalitete si lexues automatik (text-to-speech), rregullime të ngjyrave, kontrastit dhe distancimit të tekstit, funksione të fokusimit të theksuar (focus highlight), navigim të asistuar dhe opsione për përdorim me tastierë, opsione për konvertim të tekstit në formate alternative dhe optimizim të faqes në pajisje ndihmëse (assistive technologies).
Ky modul synon harmonizimin teknik të të gjitha faqeve dhe nënfaqeve të AMA-s, si dhe ofrimin e një niveli të standardizuar të aksesueshmërisë, në përputhje me praktikat më të mira të autoriteteve rregullatore europiane.

Bazuar në materialet referente që paraqesin modelet e faqeve të autoriteteve homologe në BE dhe rajon, AMA në tremujorin e parë të vitit 2026 do të ndërmarrë një proces të standardizimit të strukturës vizuale dhe funksionale të faqes zyrtare, i cili do të përfshijë unifikimin e menusë së navigimit dhe strukturës së informacionit, harmonizimin e dizajnit grafik në të gjitha faqet dhe nënfaqet, integrimin e funksioneve të aksesueshmërisë në çdo seksion të faqes, optimizimin e kodimit të faqes për pajtueshmëri me lexues automatikë dhe teknologji asistive (screen readers).
Ky proces siguron që të gjitha faqet ekzistuese dhe ato që do të publikohen në të ardhmen të jenë në përputhje me standardet WCAG dhe praktikat e rregullatorëve europianë.
Masat e parashikuara më sipër janë pjesë integrale e angazhimit të AMA-s për respektimin e rekomandimit të Kuvendit, si dhe të praktikave më të mira evropiane në ofrimin e shërbimeve të aksesueshme për qytetarët. Implementimi i tyre synon:

- rritjen e transparencës dhe qasjes së barabartë në informacion publik;
- përmbushjen e standardeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për aksesueshmërinë digjitale;
- forcimin e rolit të AMA-s si institucion i hapur dhe i përgjegjshëm;
- sigurimin e përfshirjes së grupeve vulnerabël në proceset e informimit publik;
- ndërtimin e një infrastrukture digjitale moderne, të besueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Këto praktika synojnë jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe krijimin e një mjedisi mediatik sa më gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët.




# 3. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES - RAPORTIN E BE-SË DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT[1]

**Disa nga rekomandimet e progres-raportit të BE-së për Shqipërinë, për vitin 2025:**

- **Adresimi i përqendrimit të lartë në pronësinë së medias dhe rritja e ndjeshme e transparencës së financimit të medias, duke përfshirë rishikimin e kërkesave ligjore për reklamën publike, në përputhje me standardet europiane**

Siç AMA ka raportuar edhe më parë, çdo vit institucioni harton Buletinin Periodik, i cili përmban një bazë të dhënash, përfshirë këtu edhe të dhëna për kuotat e pronësisë, që aksionarët e OSHMA-ve zotërojnë, jo vetëm në tregun mediatik, por edhe në fusha të tjera të industrisë mediatike. Buletini Periodik nr. 11, është i fundit i publikuar në faqen zyrtare të AMA-s dhe përmban të dhëna për vitin 2024. Gjithashtu, bazuar në nenin 62, pika 12 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, përveç kufizimeve në aksione të kompanive mediatike, përcaktohet edhe një "tavan" për të ardhurat nga reklamat. Sipas këtij neni, asnjë zotërues i licencave kombëtare të transmetimeve audio dhe licencave kombëtare të transmetimit audioviziv, përfshirë OSHMA-të e autorizuara për shërbimin e programeve të mbështetura në rrjete satelitore, në bazë të këtij ligji, nuk mund të transmetojnë më shumë se 30% të reklamave në tregun e transmetimeve audiovizive. Përmes këtij parashikimi ligjor, synohet të mënjanohet situata e përqendrimit të pushtetit mediatik në duart e një subjekti mediatik të licencuar për rrjet numerik kombëtar apo shërbim kombëtar audioviziv si dhe zotërimit të tregut mediatik, prej një ose më shumë subjektesh. Në bazë të këtij neni, AMA monitoron dhe publikon informacion periodik, në baza mujore, mbi volumin e reklamave të transmetuara nga transmetuesit kombëtarë. Nën monitorim mbahen edhe zëra të tjerë në transmetimet audiovizive si, koha e plotë në minuta dhe përqindje për partitë politike; koha për institucionet në minuta dhe përqindje; aktorët sinkron; temat e lajmit në minuta dhe përqindje në radio dhe televizione me licencë kombëtare, si dhe blerësit më të mëdhenj të hapësirës televizive. Kjo bazë e plotë e të dhënave mbi tendencat e transmetimeve audio dhe audiovizive publikohen çdo muaj edhe në faqen zyrtare të AMA-s https://ama.gov.al/monitorimi-i-permbajtjeve/.

Përveç kësaj, kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi parashikon kufizime që lidhen me formën e organizimit të shoqërisë mbajtëse të licencës së transmetimit audio/audioviziv numerik, përqindjen e aksioneve që mund të zotërojë një person fizik/juridik në këtë shoqëri, si dhe me numrin e licencave të transmetimit audio/audioviziv. Kufizime të tilla kanë për qëllim të sigurojnë nxitjen e pluralizimit në media dhe reklamimin e shumëllojshmërisë së përmbajtjes së tyre. Vlen gjithashtu të theksohet se me ndryshimet e fundit të propozuara në ligjin për mediat audiovizive, në kuadër të transpozimit të Direktivës së BE-së 2018/1808 (AVMSD), është përfshirë tashmë detyrimi që ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive duhet të bëjnë publik informacionin në lidhje me strukturën e tyre të pronësisë, duke përfshirë edhe pronarët përfitues.

[1] Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2025, datë 04.11.2025. https://enlargement.ec.europa.eu/document/doẽnload/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf, fq. 38.



INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL

Në prill të vitit 2024, AMA miratoi Rregulloren për ndryshimet në pronësi dhe deklarimin e pronarit përfitues. Rregullorja "Për kërkesat dhe procedurat e rishikimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënave të pronësisë së OSHMA-ve" për ndryshimet në strukturën pronësore solli risi mbi:

- Shqyrtimin nga AMA të ndryshimeve të ndodhura në strukturën pronësore brenda të njëjtit person juridik OSHMA, mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, të cilat nuk passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi;
- Shqyrtimin e ndryshimeve në strukturën pronësore mes personave juridikë privatë OSHMA, në rastet e hyrjes në marrëdhënie juridike civile të cilat passjellin cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca ose autorizimi;
- Deklarimin e informacionit mbi përbërjen e strukturës së pronësisë së personit juridik OSHMA mbajtës i licencës ose i autorizimit nga AMA, duke përfshirë pronarin përfitues;
- Transparencë e shtuar mbi origjinën e burimeve të financimit për kryerjen e transaksioneve tregtare të kapitalit të shoqërisë mediatike prej ortakut/aksionerit;
- Deklarim të çdo lloj konflikti të mundshëm interesi që ndikon në veprimtarinë e OSHMA - së prej pronarëve;
- Procedurës së vlerësimit të aplikimit dhe vendimarrjes prej AMA-s;
- Bashkëpunimin e rregullatorit me institucione ose agjenci të tjera shtetërore të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me zbatimin e rregullores në praktikë, rast pas rasti, etj.

Ky objektiv i arritur i Autoritetit të Mediave Audiovizive përgjatë vitit 2024, u përforcua më tej gjatë vitit 2025 me publikimin e një baze të dhënash mbi strukturën e pronësisë së OSHMA-ve të autorizuar/licencuar nga AMA. Dokumenti përmban të dhëna gjithëpërfshirëse për transparencën e strukturës së pronësisë, e aksesueshme nëpërmjet faqes online zyrtare të AMA-s, në rubrikën "Transparenca e Pronësisë së Medias" https://ama.gov.al/baza-e-te-dhenave-struktura-pronesore-e-oshma/. Kjo bazë të dhënash shërben si një burim qendror dhe i përditësuar që përmban informacion të detajuar mbi të gjithë ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale të licencuara dhe të autorizuara në Shqipëri. Ajo përfshin të dhëna si mbi personat juridikë ashtu edhe mbi pronarët individualë, duke u shtrirë deri në identifikimin e plotë të pronarëve përfitues përfundimtarë.

Në kuadër të detyrimeve periodike për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Europian në fushën e medias audiovizive dhe digjitale, strukturat përkatëse të AMA-s kanë ndërmarrë një rol proaktiv në identifikimin e mangësive të kuadrit ekzistues ligjor dhe në kontributin teknik përmes analizave ligjore dhe krijimit të tabelave të përputhshmërisë në kuadër të ndryshimeve përkatëse në ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar.

Në qendër të kësaj nisme ligjore, të ndërmarrë nga një deputet i Kuvendit të Shqipërisë, është prezantimi i një kuadri të ri për transparencën e pronësisë së medias, i cili detyron ofruesit e shërbimeve mediatike të deklarojnë informacion të detajuar mbi identitetin e tyre ligjor, strukturat e pronësisë, pronarët përfitues, pjesëmarrjen e shtetit dhe të ardhurat nga reklamat shtetërore dhe nga autoritetet publike të vendeve të treta. AMA ngarkohet me krijimin dhe mirëmbajtjen e një regjistri kombëtar të pronësisë së medias dhe me garantimin që këto të dhëna të jenë publikisht të aksesueshme, të sakta dhe të përditësuara rregullisht, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Biznesit. Këto masa transpozojnë drejtpërdrejt nenin 6 të Aktit Europian të Lirisë së Medias, EMFA dhe nenin 5 të AVMSD, të cilat kërkojnë që shtetet anëtare të sigurojnë transparencën e pronësisë së medias dhe të marrëdhënieve financiare me autoritetet publike, duke respektuar njëkohësisht parimet e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Europian në fushën e medias dhe në funksion të adresimit të piketave të ndërmjetme të identifikuara nga Komisioni Europian në lidhje me garantimin e pluralizmit mediatik dhe pavarësisë editoriale, Drejtoria e Legjislacionit dhe Integrimit Europian ka ofruar ekspertizë të specializuar në kuadër të Platformës së Dialogut, si mekanizëm konsultimi dhe bashkëpunimi me aktorët e sektorit të medias, për vendosjen e një regjimi të posaçëm për kontrollin e përqendrimit të medias. Ky regjim synon vendosjen e një mekanizmi të dedikuar rregullator

për vlerësimin e përqendrimeve në sektorin mediatik, duke i atribuar Autoritetit të Mediave Audiovizive kompetencë ekskluzive për të vlerësuar bashkimet, blerjet dhe ndryshimet e tjera strukturore në sektorin mediatik nga këndvështrimi i pluralizmit mediatik dhe autonomisë editoriale. Regjimi funksionon në mënyrë të pavarur nga zbatimi i ligjit të konkurrencës, por në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Konkurrencës.

Ndër të tjera parashikohen detyrime njoftimi për transaksionet e përqendrimit mediatik, kërkesa për pezullimin e transaksioneve deri në përfundimin e vlerësimit (standstill), garanci procedurale, të drejta pjesëmarrjeje për palë të treta, kritere të posaçme vlerësimi si dhe mekanizma ankimi. Përqendrimet mediatike që reduktojnë ndjeshëm pluralizmin e medias ose autonominë editoriale ndalohen, ndërsa lejohet miratimi me kusht në rastet kur provohen masa mbrojtëse të përshtatshme në interes publik.
Këto dispozita reflektojnë dhe transpozojnë elemente të përkufizimeve 70, 71 dhe 73 si dhe nenin 22 të Aktit Europian për Lirinë e Medias (EMFA), duke vendosur një standard në përputhje me praktikat rregullatore europiane për vlerësimin e përqendrimeve mediatike nga perspektiva e pluralizmit mediatik, të dallueshëm nga analiza ekonomike e konkurrencës. Në këtë kuadër, mekanizmi i propozuar synon gjithashtu vendosjen e një metodologjie të strukturuar për vlerësimin e ndikimit të përqendrimeve mbi pluralizmin mediatik dhe autonominë editoriale, në përputhje me qasjen e vlerësimit të rrezikut (risk-assessment) të parashikuar nga kuadri rregullator europian.

- **Adresimi i çështjes për forcimin e pavarësisë dhe autonomisë së rregullatorit**

Autoriteti i Mediave Audiovizive është autoriteti rregullator kolegjial dhe i pavarur në fushën e shërbimeve të transmetimit audio dhe audioviziv në Shqipëri, shërbimeve të tyre mbështetëse dhe Platformave të Shpërndarjes së Videove. AMA përbëhet nga Kryetari, Zv/Kryetari dhe pesë anëtarë; Anëtarët e Bordit të AMA-s nuk janë të ndikuar financiarisht ose politikisht; Anëtarët e Bordit propozohen nga shoqëria civile, ndër profesionistë të medias ose të drejtës në vend, dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Anëtarët kanë një mandat 5-vjeçar, me mundësinë e rinovimit të vetëm një mandati. Anëtarët e AMA-s kryejnë detyrat e tyre me integritet dhe pavarësi profesionale, duke shmangur çdo ndikim nga interesa financiare, pikëpamje politike dhe duke garantuar të drejtën e publikut për informacion.

Përveç Bordit, ka një strukturë tjetër që operon në mënyrë të pavarur brenda AMA-s, e cila është Këshilli Ankesave. Këshilli i Ankesave emërohet nga AMA me shumicë votash 3/5; Ai përbëhet nga Kryetari dhe 2 anëtarë ekspertë në fushën e medias. Ky Këshill ka një mandat 3-vjeçar, me mundësinë e rinovimit të vetëm një mandati. Këshilli i Ankesave trajton ankesat ose kërkesat për një program të transmetuar audioviziv, përmbajtje ose lajme, të marra nga çdo palë e interesuar, e cila ka pësuar ndonjë dëm në privatësinë, jetën private, dinjitetin ose të drejtat e tjera.

Pavarësia e Autoritetit garantohet me ligj nga:

1. Procesi i zgjedhjes së Kryetarit dhe anëtarëve dhe Kryetarit të AMA-s (nenet 8 - 12);
2. Rregullimi i mënyrës për të identifikuar rastet e mundshme të papajtueshmërisë dhe konflikteve të interesit të anëtarëve dhe Kryetarit të AMA-s (neni 7) – Anëtarët nuk duhet të kenë lidhje ose anëtarësi politike, të mos zotërojnë kapital, aksione, ose të drejta të tjera në fushën e medias audiovizive, të deklarojnë çdo rast të mundshëm të konfliktit të interesit në vendimmarrje, si dhe të mos shprehin ose mbajnë qëndrime publike që mund të dëmtojnë paanshmërinë e tyre;
3. Mënyra se si financohet Autoriteti (nenet 24 - 27) - Aktiviteti i AMA-s ka si qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të institucionit, përmes përdorimit efikas të burimeve të tij, duke përmbushur detyrat dhe nevojat e Autoritetit, duke u udhëhequr nga transparenca dhe llogaridhënia;
4. Mënyra e organizimit, funksionimit, kompetencave dhe vendimarrjes së AMA-s (nenet 15 - 21, 23, 28 - 29).

Në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 97/2013, datë 19.03.2013, burimet e financimit të AMA-s janë si më poshtë:
a) të ardhurat nga pagesat për dhënien dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime;
d) Të gjitha indikatorët financiarë publikohen në faqen e internetit të AMA-s.

Në përputhje me nenin 25 të ligjit të mësipërm, thuhet: "... Për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij, AMA përcakton, me një vendim të veçantë, të gjitha tarifat për licencat dhe/ose autorizimet e ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, shërbimeve të tjera, si dhe pagesat për përpunimin administrativ". Sipas vendimit të mësipërm, është miratuar Vendimi i AMA-,s Nr. 220, datë 01.12.2017 "Për përcaktimin e tarifave për licencat/autorizimet dhe shërbimet e kryera nga Autoriteti i Mediave Audiovizive" për të përcaktuar tarifat e mbledhura nga ofruesit e mediave. AMA është një institucion që vetëfinancohet dhe në përputhje me nenin 25(5) të Ligjit Nr. 97/2013, "... Çdo mbetje nga të ardhurat e tarifave/pagimeve, e mbetur pas shpenzimeve funksionale të AMA-s, në fund të vitit financiar, ruhet në llogaritë e AMA-s dhe përfshihet në planin e shpenzimeve të vitit tjetër...".

Nga gjithë sa më sipër, rezulton e dukshme se ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, garanton pavarësinë e plotë dhë të qartë të Autoritetit, duke filluar me dispozitat që përcaktojnë statusin e AMA-s, mënyrën e propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve dhe kryetarit të AMA-s, papajtueshmëritë dhe konfliktet e interesit të anëtarëve dhe kryetarit të AMA-s.

Në kuadër të kontributit teknik për përmbushjen e piketave të ndërmjetme të adresuara nga Komisioni Europian, Drejtoria e Legjislacionit dhe Integrimit Europian ka theksuar se garancitë e parashikuara në këtë drejtim forcojnë më tej pavarësinë dhe llogaridhënien e Autoritetit të Mediave Audiovizive, në përputhje me nenin 7 të EMFA-së, përmes konfirmimit të ndarjes së tij ligjore nga qeveria dhe çdo subjekt tjetër publik apo privat, kodifikimit të autonomisë funksionale, procedurave transparente të emërimit dhe shkarkimit, vendimmarrjes së arsyetuar dhe të ankueshme gjyqësisht, si dhe garantimit të burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore.

- **Forcimi i rregullave të reklamës mediatike për të pasur një transparencë dhe pavarësi mediatike, duke përfshirë rregullat e shpërndarjes së reklamave shtetërore**

Pjesë e kompetencave ligjore të Autoritetit të Mediave Audiovizive është edhe monitorimi i volumit të reklamave, të dhëna të cilat publikohen në faqen zyrtare online të institucionit si pjesë e procesit të matjes së përgjithshme të volumit të reklamave. Këtu përfshihet edhe monitorimi i reklamës institucionale, i cili, gjatë periudhave zgjedhore, kryhet sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Referuar sa më sipër, në kuadër të kontributit teknik të Autoritetit të Mediave Audiovizive për njohjen dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e medias, Drejtoria e Legjislacionit dhe Integrimit Europian, në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe Drejtorinë e Botimeve dhe Analizës, ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale për interpretimin e standardeve të përcaktuara nga Akti Evropian për Lirinë e Medias (EMFA), veçanërisht në lidhje me parashikimet e nenit 25 dhe Përkufizimit 73, që rregullojnë shpërndarjen e fondeve publike për reklamat shtetërore dhe kontratat për shërbime mediatike. Në këtë kuadër, aktivitetet e shkëmbimit të ekspertizës dhe forcimit të kapaciteteve administrative të zhvilluara gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në rritjen e kuptueshmërisë institucionale mbi këto standarde dhe në orientimin e mëtejshëm të qasjes rregullatore të AMA-s në përputhje me kërkesat e acquis të BE-së.




# 4. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT

Një ndër detyrat funksionale të AMA-s është verifikimi i respektimit të kushteve të licencës dhe/ose autorizimit nga subjektet që ushtrojnë veprimtari audio dhe/ose audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Mbështetur në nenin 78 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, AMA ka të drejtë të ushtrojë kontroll të veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi. AMA, gjithashtu ka kompetencë të vendosë sanksione sipas nenit 133, "Gjobat", për subjektet që veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Sanksionet me gjobë mund të vendosen nga inspektorët ose nga vetë AMA, me nismën e tyre, ose pas ankimit të subjekteve të interesuara.

Gjithashtu një fokus të veçantë ka pasur inspektimi dhe monitorimi i subjekteve audiovizive të autorizuara nga AMA për përsëritjen e përmbajtjes audiovizive, në lidhje me buketën programore që i ofrojnë qytetarëve, me cilësinë e transmetimeve si dhe me monitorimin e tyre për respektimin e kushteve të autorizimit. Inspektimi në këto subjekte kyhet kryesisht për monitorimin e përmbajtjes që ato transmetojnë, duke kontrolluar nëse përmbajtja është në përputhje me kontratat që ata depozitojnë në AMA çdo fillim viti.

Inspektimet janë kryer në bazë të ankesave të depozituara nga subjektet mbajtës të së drejtës, por edhe kryesisht nga AMA. Të gjitha ankesat/kërkesat e operatorëve për ndërhyrje mbi mosrespektimin e të drejtës së transmetimit nga subjektet kabllore/IPTV/OTT, autoriteti i ka realizuar duke iu dhënë përgjigje të gjithë subjekteve ankuese, si dhe duke marrë masat përkatëse në rast shkeljesh.

Sa i përket subjekteve të autorizuara nga AMA për ritransmetimin e produktit audioviziv, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, ka kryer inspektimet me rigorozitet dhe paanësi, duke marrë masat e duhura në rastet e shkeljes së ligjit 97/2013, i ndryshuar.

Vlen të theksohet se, pjesa dërrmuese e ankesave për shkeljen e të drejtave të transmetimit gjatë vitit 2025, lidhet me fenomenin e piraterisë televizive që kryhet nga subjekte të paautorizuara nga AMA për ofrimin e shërbimit audioviziv. Konkretisht bëhet fjalë për subjekte ISP (Internet Service Provider), të cilët nëpërmjet internetit kryejnë pirateri televizive pa autorizim nga AMA. Po ashtu një fenomen tjetër shqetësues që po shihet së fundmi është dhe shpërndarja e linqeve të ndryshme nëpërmjet grupeve që operojnë në rrjetet Telegram dhe Facebook. Kjo është një mënyrë shumë e sofistikuar që piratët

audiovizivë po përdorin së fundmi. Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, nëpërmjet specialistëve të saj, ka konstatuar 11 grupe të tilla që operonin në rrjetin Telegram. Për mbylljen e këtyre grupeve pirate u kontaktua direkt me këtë rrjet dhe në përgjigje të kërkesave të AMA-s, u mbyllen nga Telegram 7 prej tyre.

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Inspektimit, në kuadër të kontrolleve periodike në terren, ka konstatuar, brenda territorit shqiptar, 10 servera që transmetonin përmbajtje audiovizive pa të drejta Pas inspektimeve dhe mbledhjes së provave mbi përdorimin e tyre, këta servera janë sekuestruar dhe raportuar pranë institucioneve përkatëse.

Në 4 raste të tjera është konstatuar se serverat janë zhvendosur ose hostuar në kompani jashtë territorit të Shqipërisë. Për këto raste është realizuar raportimi pranë host-providerëve përkatës dhe është arritur mbyllja e tyre. Vlen të theksohet se disa nga host-providerët më të mëdhenj ndërkombëtarë kanë reaguar menjëherë ndaj raportimeve të AMA-s, si ExonHost (Rumani), Scaleway (Francë) dhe DataCamp (Angli) kanë kthyer përgjigje dhe, pas verifikimeve përkatëse, shërbimet e paligjshme janë mbyllur.

Për shkeljet e konstatuara janë depozituar edhe kallëzime në Policinë e Shtetit, pranë sektorit të krimit ekonomik, për ndjekjen e mëtejshme sipas legjislacionit në fuqi.
Për 2 subjekteve ISP që operonin në kundërshtim me ligjin 97/2013, të ndryshuar, është vepruar duke i gjobitur me nga 5.000.000 lekë secilin.




Siç dhe mund të shikohet nga tabela, DIM, ka rritur kapacitetet e saj monitoruesa nëpërmjet specialistëve IT, duke bërë të mundur identifikimin e subjekteve që piratojnë produkt audioviziv nëpërmjet internetit, si dhe duke bërë të mundur mbylljen e severave që operojnë jashtë vendit.
Gjithashtu gjatë vitit 2025, AMA përcolli pranë AKEP-it, 30 praktika zyrtare me kërkesë marrjen e masave, për mbylljen e 334 faqeve online, të cilat kryenin shkelje të ligjit 97/2013, i ndryshuar.
Lidhur me këtë fenomen, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes u ka kërkuar edhe Platformave të Shpërndarjes së Videove, si TikTok (nga janari deri në muajin Mars 2025) heqjen nga llogaritë e tyre të 579 link-eve, të cilët transmetonin produkt audioviziv pa të drejta transmetimi. Linqet pirate janë mbyllur nga platforma menjëherë pas raportimit nga ana e AMA-s.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese për periudhën 2022 – 2025 të ankesave nga subjektet:

| SUBJEKTI | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 |
|---|---|---|---|---|
| DigitAlb | 175 | 83 | 11 | 16 |
| Tring | 4 | 49 | 24 | 8 |

Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes në AMA, gjatë vitit 2025, përmes grupeve të veta të inspektimit, ka ushtruar 281 kontrolle të aktivitetit të OSHMA-ve. Inspektimet u iniciuan nga ankesat e marra nga subjektet mbajtës të së drejtave, por edhe nga AMA kryesisht.
Në përfundim të kontrolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative, janë marrë masat si më poshtë:

Dymbëdhjetë (12) vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA, që janë konstatuar në shkelje të ligjit nr.97/2013, i ndryshuar, prej të cilave:

- 5 (pesë) sanksione me gjobë, me vlerë 1.000.000 lekë secili, ndaj subjekteve përsëritës të shërbimit të të tretëve, për mosrespektim të të drejtave të transmetimit;
- 1 (një) sanksion me gjobë për moslejim kontrolli nga subjektet e autorizuara nga AMA, me vlerën 120.000 lekë;
- 2 (dy) sanksione me gjobë me vlerë 5.000.000 lekë secili ndaj subjekteve ISP (Internet Service Provider), të paautorizuara nga AMA, të cilët transmetonin produkt audioviziv në mënyrë pirate.
- 4 (katër) sanksione me gjobë me vlerë nga 40.000 lekë secili janë vendosur ndaj subjekteve OSHMA për mos-dorëzim të përmbajtjeve audiovizive;

Për 15 (pesëmbëdhjetë) raste të tjera është vendosur masa "Tërheqje Vëmendje" ndaj subjekteve OSHMA.

Tabela në vijim përmban informacion në formë krahasuese me katër vitet e mëparshme:

| VITI | INSPEKTIMET | GJOBA TOTAL | TËRHEQJE VËMENDJE | SEKUESTRIME |
|---|---|---|---|---|
| 2022 | 249 | 15 | 20 | - |
| 2023 | 332 | 9 | 3 | 3 |
| 2024 | 393 | 11 | 9 | 5 |
| 2025 | 281 | 12 | 15 | 1 |

Sa i përket veprimtarisë monitoruese, Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, gjatë vitit 2025, ka pasur në fokus të veçantë monitorimin e respektimit të së drejtës së transmetimit për filmat artistikë dhe ngjarjet sportive, në platforma/programe të ndryshme me pagesë. Gjatë vitit 2025 janë kryer 1.168 orë monitorime për të drejtat e transmetimit për filmat artistikë dhe ato sportive. Në këtë kuadër, theksojmë se për mbarëvajtjen e punës dhe rritjen e cilësisë, gjatë vitit 2025 është instaluar një sistem i ri regjistrimi, falë të cilit është bërë i mundur rritja e kapaciteteve monitoruese të AMA-s, nga 48 kanale/programe që ishin në vitin 2024, në 60 kanale/programe të monitoruara në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2025.
Ky sistem bën gjithashtu të mundur që regjistrimet të kryhen në mënyrë digjitale. Kjo risi ka përmirësuar punën e specialistëve, por edhe cilësinë e regjistrimit, në zë dhe figurë.

Lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit, Autoriteti, gjatë vitit 2025, kreu një numër të konsiderueshëm inspektimesh të subjekteve kabllore/IPTV/OTT në terren. Viti 2025 solli të reja në mënyrën e kryerjes së kontrolleve për shkeljen e të drejtave të transmetimit, ku specialistë pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Mbikëqyrjes kanë kryer dhe monitorimin e platformave online, duke identifikuar një sërë rastesh me servera të ndyshëm që përdoreshin për shpërndarjen dhe shitjen e produkteve audiovizive në mënyrë pirate. Pas identifikimit të këtyre shkeljeve, AMA, i ka raportuar ato pranë institucionit të AKEP për marrjen e masave për bllokimin e këtyre serverave.

Vendime për dënime me gjobë gjatë vitit 2025:

Në vitin 2025, AMA ka marrë masa administrative ndaj operatorëve duke vendosur gjoba me një vlerë të përgjithshme prej 15.740 mijë lekësh. Kjo dëshmon rolin aktiv të institucionit në mbikëqyrjen e tregut dhe në zbatimin e kuadrit ligjor ndaj subjekteve që shkelin rregullat në fuqi.

**Pagesat e kryera për gjoba dhe kamatëvonesa**

Gjatë të njëjtit vit, nga operatorët është arkëtuar shuma 2.660 mijë lekë nga detyrimet për gjoba dhe kamatëvonesa. Edhe pse kjo shumë ka ndikuar në uljen e një pjese të detyrimeve, niveli i arkëtimeve mbetet ende i pamjaftueshëm në raport me gjobat e vendosura, i cili vjen si rezultat i ankimimeve ne gjykatë të sanksioneve në pritjen e procedurave gjyqësore.

**Gjobat të shfuqizuara**

Gjatë vitit 2025, 4 gjoba në vlerë prej 3.260 mijë lekësh janë shfuqizuar ose reduktuar, dy gjoba bazuar në vendime të gjykatave, për dy gjoba të tjera është pranuar ankimim nga Bordi i AMA-s. Këto ndryshime lidhen me proceset e ankimit të ndjekura nga OSHMA-të në AMA dhe në gjykatë.

Ecuria e arkëtimeve nga gjobat për periudhën 2021–2025

Të dhënat mbi arkëtimin për sanksionet me gjobë gjatë viteve 2021–2025, si edhe pjesa e të ardhurave që i takon AMA-s, paraqiten në Tabelën nr. 1. në 000/lekë.

**Ecuria e arkëtimeve nga gjobat për periudhën 2021–2025**

Të dhënat mbi arketimin për sanksionet me gjobë gjatë viteve 2021–2025, si edhe pjesa e të ardhurave që i takon AMA-s, paraqiten në Tabelën nr. 1. në 000/lekë.

| Emërtimi | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|
| Arkëtimet në total nga gjoba (100%) | 2,553 | 5,951 | 5,478 | 1,771 | 2,660 |
| Të ardhura për AMA - n nga gjobat (20%) | 511 | 1,190 | 1,095 | 354 | 532 |

Gjatë kësaj periudhe, arkëtimet totale janë luhatur nga viti në vit, duke arritur në 2.660 mijë lekë në vitin 2025. Nga kjo shumë, pjesa që i kalon AMA-s, në masën 20%, është 532 mijë lekë.

**Detyrimi i mbetur për gjobat në fund të vitit 2025**

Në përfundim të vitit 2025, pas përfshirjes së detyrimeve të trashëguara, gjobave të reja, pagesave të realizuara dhe shumave të shfuqizuara ose të reduktuara, detyrimi total i mbetur arrin në 344.018 mijë lekë.



# 5. QEVERISJA E AUTORITETIT

### 5.1 Vendimarrja mbi licencat/autorizimet

Gjatë vitit 2025, në zbatim të detyrave funksionale, duke u ndalur kryesisht në procesin e zbatimit me efektshmëri dhe në përputhje me kuadrin ligjor, i cili rregullon veprimtarinë administrative në kuadër të ndjekjes së procedurave për licencimin/autorizimin, rinovim licence/autorizimi, miratimin e ndryshimeve në kushtet e licencës dhe/ose autorizimit, zgjerim zone etj., si dhe ndjekjen e procedurës së hetimit administrativ ndaj OSHMA-ve, të cilat në mosrespektim të detyrimeve finaciare dhe jo vetëm shkelin detyrimet ligjore që burojnë nga marrëdhënia administrative me AMA-n, janë ndërmarrë të gjithë hapat proceduriale për nisjen dhe ndjekjen e vijueshmërisë administrative për rastet objekt trajtimi.

Përveç kryerjes së funksioneve, lidhur me ndjekjen e procedurave për licencimin/autorizimin, rinovim licence/autorizimi, miratimin e ndryshimeve në kushtet e licencës dhe/ose autorizimit, zgjerim zone etj., gjatë periudhës raportuese, Drejtoria Ligjore ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në aspekte të tjera të veprimtarisë administrative të AMA-s, si përfaqësimi i institucionit në proceset gjyqësore ku institucioni është palë, draftimi i akteve rregullatore të ndërmarra gjatë vitit 2025, bashkëpunimi dhe këshillimi me organe të tjera shtetërore.

Referenca parësore ligjore, mbi të cilën e AMA e mbështet veprimtarinë e vet administrative dhe rregullatore, mbetet ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Gjithashtu, veprimtaria e AMA-s, ushtrohet në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën e medias audio dhe audiovizive. Legjislacioni dytësor (rregullore, vendime dhe udhëzime), i miratuar në bazë dhe zbatim të ligjit të posaçëm organik, luan një rol të rëndësishëm në realizimin e misionit dhe funksionit të Autoritetit.

**Aktet Rregullatore**

Në cilësinë e autoritetit rregullator për shërbimet audio dhe audiovizive dhe në zbatim të ligjit organik, Autoriteti i Mediave Audiovizive, edhe gjatë vitit 2025, ka punuar për hartimin apo ndryshimin e akteve nënligjore, me qëllim përmirësimin e aktivitetit të institucionit dhe lehtësimit të veprimtarisë së operatorëve audio/audiovizivë.

Gjatë vitit 2025, në zbatim të ligjit organik, ka lindur nevoja për plotësim të akteve rregullatore apo rregullim praktikash, iniciativë kjo e ardhur nga strukturat e brendeshme të AMA-s dhe verifikimit në terren të subjekteve OSHMA, lidhur me garantimin e të drejtave dhe ofrimin e shërbimit për të cilin janë pajisur me autorizim nga autoriteti. Në këto kushte, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), me vendimin nr. 73 në datë, 22.08.2025 ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren ekzistuese.

"Rregullore për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", miratuar me vendimin nr. 99 datë 07.06.2017 të AMA, e ndryshuar. Nëpërmjet këtij akti, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka synuar të përmirësojë dhe të plotësojë rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve dhe afateve të tyre, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përkatësisht neni 19 pika ë)... hartimi dhe miratimi i rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave dhe/ose autorizimeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

Në hartimin e draftit të rregullores, "Rregullore për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve" miratuar me vendimin nr.99 datë 07.06.2017, u respektuan parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, sigurisë juridike dhe transparencës. Në zbatim të detyrimeve ligjore, ky akt rregullator, i ndryshuar, kaloi në konsultim publik, në përfundim të të cilit u mblodhën dhe u trajtuan komentet e palëve të interesuara në proces.

Në zbatim të nenit 60 të ligjit organik, AMA, me nismën e vet, ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, ka çelur disa gara për dhënien e licencës së shërbimit të programit audio analog, duke marrë në konsideratë ekzistencën e kapaciteteve të lira teknike në rrjetet numerike të operatorit publik dhe operatorëve privatë lokalë të transmetimit.

Konkretisht, në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Rregullores "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge", miratuar me vendimin nr. 7, datë 21.02.2023 të AMA-s, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka shpallur 1 garë audio analoge. Në përfundim të procedurave institucioni ka proceduar me 1 vendim për dhënie licence transmetimi audio analoge. Dhënia në përdorim e frekuencave nga AMA bëhet në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave, duke pasur parasysh parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe objektivitetit. Për dhënien në përdorim të frekuencave si pasuri kombëtare e fundme, përdoret procedura e hapur në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Sa i përket aplikimeve për marrje autorizimi, aplikime të cilat shqyrtohen mbi bazë kërkese të subjekteve të interesuar, për vitin 2025 kanë shfaqur interes 15 subjekte. Në përfundim, AMA ka miratuar dhënien e autorizimit për një periudhë 5-vjeçare për ofrimin dhe përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor për subjektet kërkues.

Për aplikimet për licencë/autorizim, gjatë vitit 2025, AMA ka vendosur:
- Dhënien e autorizimit për 14 subjekte (përsëritës/ofrues në rrjete kabllorë/internet IPTV dhe OTT);
- Rinovimin e autorizimit për 23 subjekte (përsëritës/ofrues në rrjete kabllorë/internet IPTV dhe OTT;
- Rinovimin e licencës për 6 subjekte audio analoge;
- Heqje/konstatim pavlefshmërie të licencës/autorizimit për transmetime audiovizive për 11 subjekte (përsëritës/ofrues në rrjete kabllorë/ internet IPTV dhe OTT)
- Rrëzim aplikimi për marrje autorizimi për 1 subjekt (përsëritës/ofrues në rrjete kabllorë/ internet IPTV dhe OTT).

Gjithashtu gjatë vitit raportues, tre (3) subjekte ekzistues të autorizuar për përsëritjen e shërbimit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor, kanë kërkuar zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit, dy (2) subjekte ekzistues të autorizuar për përsëritjen e shërbimit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet kabllor, kanë kërkuar reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit dhe një (1) subjekt ekzistues, licencuar për shërbimin e programit audio, ka kërkuar zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit.

Vlen të theksohet se, në çdo rast, AMA ka respektuar frymën e ligjit duke mos anashkaluar në asnjë rast shkeljen e parashikimeve ligjore dhe njëherazi duke paralajmëruar se për çdo kundërvajtje administrative, ligji parashikon ndëshkimin me gjobë, ashtu sikurse dhe vendimmarrjen me heqje licence dhe/ose autorizim. Në kuadër të ndjekjes së planit të licencimit dhe njëherazi të dhënies së autorizimit për shfrytëzimin e çdo kapaciteti audioviziv për informimin e publikut, është ndjekur me koherencë dhe transparencë të plotë procesi i vendimarrjeve ndaj aplikimeve, si dhe komunikimeve të vazhdueshme zyrtare, për vijmësinë e mbajtjes së këtyre të drejtave që tashmë ata kanë.

**Ndryshimet në pronësi**

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, subjektet e licencuara/autorizuara kanë detyrimin që brenda 30 ditëve të njoftojnë AMA-n, lidhur me ndryshimet e ndodhura në kërkesën për licencë dhe/ose autorizim, për kalim të drejtash apo për ndryshime në strukturën e pronësisë, brenda të njëjtit subjekt tregtar. Ndër kushtet e licencës/autorizimit të subjekteve OSHMA, është dhe detyrimi për të njoftuar AMA-n për ndryshime në të dhënat e licencës dhe autorizimit.

Gjatë vitit 2025, janë sanksionuar me gjobë 4 subjekte për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, si dhe për mosnjoftimin e ndryshimit të të dhënave të shoqërisë. Në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje autorizimi, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kryerjes së ndryshimeve, si dhe të kërkojnë miratimin nga AMA.

**Për aplikimet për miratim të ndryshimeve në strukturën gjatë vitit 2025, AMA ka vendosur:**

- Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën pronësore të shoqërisë, të trajtuara në çdo rast për licencë/autorizim, janë materializuar me vendimmarrje 8 raste;
- Miratimin e ndryshimeve të ndodhura për ndryshimin e emrit të shoqërisë/subjektit OSHMA, janë materializuar me vendimarrje 3 raste;
- Kontrata RTSH-AMA

Në nenin 117 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se:

RTSH-ja, pas realizimit të një konsultimi publik, përgatit, jo më vonë se 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe më pas çdo 5 vjet, një kontratë të shërbimit të transmetimit publik, ku përcakton parimet që zbaton dhe veprimtaritë që merr përsipër për përmbushjen e qëllimeve të veta si transmetues publik, të cilën ia paraqet AMA-s.
Kontrata e shërbimit të transmetimit publik duhet të parashikojë, veç të tjerash:
a) natyrën dhe numrin e orëve të programeve të transmetimit për fëmijët;
b) natyrën dhe numrin e orëve të programeve të transmetimit për shkencën dhe teknologjinë;
c) numrin e botimeve që duhet të përgatisë, botojë dhe shpërndajë në përputhje me qëllimet e veta si transmetues publik;
ç) përpilimin, publikimin dhe shpërndarjen e materialeve audiovizive, të regjistruara në përputhje me qëllimet e veta si transmetues publik.
AMA mund të nënshkruajë kontratën e shërbimit të transmetimit publik ose të kërkojë rishikimin e saj brenda 30 ditëve nga paraqitja e saj.

**Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, me vendimin nr. 88 datë 21.10.2025, ka vendosur:**

- Miratimin e Kontratës së Shërbimit të Transmetuesit Publik midis AMA-RTSH, publikuar në faqen zyrtare të AMA.

## 5.2 Ecuria e proceseve gjyqësore

Investimi i pushtetit gjyqësor është një instrument i së drejtës, që e ka bërë AMA-n palë në procese të ndryshme gjyqësore, me palët e prekura nga aktet administrative si dhe vendimarrjet e Autoritetit.

Subjektet të cilët, mbështetur në dispozitat e ligjit organik, kanë ushtruar të drejtën e ankimit administrativ, rast pas rasti, më tej kanë investuar edhe organet gjyqësore sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative" si dhe Kodit të Procedurës Administrative. AMA përgjatë vitit 2025 ka qenë palë e paditur në procese gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme, kryesisht me subjekte audio/audiovizivë. Në gjykatë janë ankimuar vendimet e AMA-s lidhur me miratimin e sanksioneve ndaj subjekteve audio/audiovizivë dhe vendimeve për mosrinovimin e licencave etj. Si person juridik, edhe AMA në disa raste, ka vënë në lëvizje gjykatën në cilësinë e palës paditëse, kryesisht me palë të paditur subjektet lidhur me mosshlyerjen e detyrimeve

financiare që burojnë nga ligji dhe aktet nënligjore, përmbarues privatë gjyqësorë apo subjekte shkelës të fushës. Ligjshmëria dhe themeltësia e akteve administrative, që janë objekt shqyrtimi gjyqësor, lidhen me dënimet administrative ndaj subjekteve audio dhe/ose audiovizive, vendimet për heqjen/pavlefshmërinë e licencës etj. Në mungesë të shlyerjes vullnetare të detyrimeve financiare nga ana e OSHMA-ve, AMA, si person juridik publik, ka investuar organet gjyqësore, duke kërkuar prej subjekteve audio/audiovizive debitorë të shlyejnë detyrimet financiare ndaj AMA-s ose Buxhetit të Shtetit. Në raste të tjera, AMA i është drejtuar gjykatave kompetente edhe në cilësinë e palës kërkuese, sikurse është edhe rasti i paraqitjes së kërkesave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025, AMA është përfshirë në 39 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, nga të cilat:

**a) 21 procese gjyqësore në cilësinë e palës paditëse:**

- Fituar: 7;
- Humbur: 1;
- Kthim aktesh: 0;
- Në proces: 13;

**b) 17 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur:**

- Fituar: 4;
- Humbur: 1;
- Në proces: 10;
- Pushuar gjykimi: 0;
- Pezulluar: 2

**c) 1 proces gjyqësor në cilësinë e palës së tretë:**

- Në proces: 1

Ndaj proceseve gjyqësore të cilat rezultojnë të humbura në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, është ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe janë çështje në proces gjyqësor.
Në vijim, gjatë vitit 2025 janë administruar pranë AMA-s, 15 vendime të Gjykatës Administrative të Apelit, konkretisht:

- **Fituar: 10, nga të cilat:**
  - 9 vendime të formës së prerë, për vendime me sanksion;
  - 1 detyrim financiar.
- **Humbur: 4, nga të cilat:**
  - 2 për vendim me sanksion (gjobë);
  - 1 kundërshtim veprimesh përmbarimore;
  - 1 detyrim financiar.

**-Kthim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 1 nga të cilat:**

- 1 për detyrime financiare

AMA ka ndjekur në vijimësi ecurinë e çështjeve gjyqësore, të cilat janë në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, çështje këto të mbartura nga vitet paraardhëse. Edhe gjatë periudhës raportuese, ekzekutimi i vendimeve të AMA-s, të shndërruara në tituj ekzekutivë, në zbatim të nenit 132 të ligjit organik, ka vijuar të kryhet përmes shërbimit privat përmbarimor. Gjatë vitit 2025, AMA ka lidhur kontrata shërbimi për ekzekutimin e 19 titujve ekzekutivë, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe kanë vijuar edhe procedurat për ekzekutimin e titujve në zbatim të kontratave të lidhura në vitet e kaluara.

Gjithashtu gjatë vitit 2025, 20 subjekte debitorë kanë shlyer detyrimet nëpërmjet shërbimit përmbarimor por dhe vullnetarisht, për sanksionet me gjobë.

Në mënyrë të detajuar, pasqyrimi i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tri shkallët e gjyqësorit, jepet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur.


INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL



# 6. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM

## 6.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të transmetuara

Gjatë gjithë vitit 2025 AMA ka realizuar periodikisht shqyrtime tematike mbi përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të, duke vlerësuar përputhshmërinë ligjore të tyre. Shqyrtimet janë kryer mbi bazën e planifikimit, duke pasur parasysh problematikat më të shpeshta që hasen në programet e transmetuara, por dhe nga ndjeshmëritë e krijuara në publik për përmbajtje të caktuara.
Vëmendja kryesore për shqyrtimet tematike të realizuara gjatë vitit 2025 ka qenë mbi aspekte të rëndësishme, si mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme; gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit në çdo formë që paraqitet; shkeljet etike në përgjithësi; reklamat dhe komunikimet tregtare; përdorimi i gjuhës shqipe standarde të shkruar dhe të folur; tërësia programore të platformës së RTSH - së, në zbatim të kërkesave të Kontratës së Shërbimit etj.
Monitorimi është adresuar në përmbajtjet e transmetuara në OSHMA-të me licencë kombëtare apo ato lokale/rajonale; në OSHMA-të që kanë format programacioni gjeneralist apo tematik.

Nga 329 raste shqyrtimesh që janë analizuar gjatë vitit 2025, janë identifikuar 106 raste që nuk kanë respektuar kërkesat e ligjit 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.
Nga 106 rastet e shkeljeve të identifikuara, pas analizimit të detajuar dhe profesional, referuar dhe kuadrit legjislativ, për 94 raste AMA ka dërguar njoftim zyrtar tek OSHMA-të për "Tërheqje vëmendjeje", kurse për 12 raste ka dërguar njoftimin "Sanksion me gjobë".

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat në shifra për vitin 2025, si dhe dinamika në 4 vitet e mëparshme.

| | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 |
|---|---|---|---|---|---|
| Shqyrtime tematike | 67 | 96 | 114 | 241 | 329 |
| Identifikuar me shkelje | 24 | 38 | 49 | 62 | 106 |
| "Tërheqje vëmendjeje" | 24 | 38 | 48 | 47 | 94 |
| "Sanksion me gjobë" | - | - | 1 | 15 | 12 |

Tipologjia e shkeljeve të konstatuara gjatë vitit 2025 përmblidhet në tabelën vijuese:

| Tipologjia | Raste | Përqindje |
|---|---|---|
| Gjuhë urrejtjeje e diskriminimi, si dhe shkelje etike | 41 | 39% |
| Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme | 23 | 22% |
| Problematika me reklamat e komunikimet tregtare | 22 | 20% |
| Përdorimi i gjuhës shqipe të shkruar e të folur | 16 | 15% |
| Të tjera (2 raste për pretendim trajtimi holistik; 1 rast për mbrojtjen e të dhënave personale; 1 rast mbi zbatimin e Kontratës së Shërbimit nga Transmetuesi Publik) | 4 | 4% |
| **Total** | 106 | 100% |

- **Gjuhë urrejtjeje e diskriminimi, si dhe shkelje etike.** Rastet e shqyrtuara dhe të analizuara kanë qenë jo vetëm në programet debatuese, por dhe gjatë edicioneve informative, në formën e deklarimeve me gjuhë urrejtjeje. Tipologjia e shkeljeve të kësaj kategorie në pjesën më të madhe ka qenë me përdorim gjuhe urrejtjeje (në 21 raste); shkelje etike (në 11 raste) dhe në formën e diskriminimit janë identifikuar 9 raste (2 racizëm, 2 mizogjini, 2 krahiniste, 2 mbi bazën e besimit fetar, si dhe 1 rast si diskriminim social).

Gjatë analizimit të shkeljeve të konstatuara, AMA ka pasur si referencë kërkesat e ligjit 97/2013, i ndryshuar, por edhe Kodin e Transmetimit që ndalon transmetimin e përmbajtjeve që nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtari të një grupi, mbi baza të tilla, si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja, besimi, opinioni politik, kombësia, anëtarësimi i një pakice kombëtare, prona, lindja, paaftësia, mosha apo orientimi seksual, si dhe çdo formë tjetër diskriminimi. Shkeljet janë gjykuar dhe si cënim i dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut, apo dhe si nevojë e respektimit të rregullave të etikës dhe moralit publik, si dhe për të mos transmetuar programe që mund të nxisin vepra penale.

Kur emisionet kanë qenë të drejtpërdrejta në transmetim janë konsideruar dhe ndërhyrjet e moderatorëve, të cilat për rastet e mësipërme kanë qenë shumë të zbehta, ose duke i kaluar qëndrimet e papërshtatshme me indiferentizëm. AMA mbetet me qëndrimin se pluraliteti i mendimeve dhe këndvështrimeve gjatë diskutimeve në studiot audiovizive, liria e shprehjes, nuk kanë asnjë lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes e diskriminimit, që përmes shkarkimeve emocionale të dikujt që shpërdoron lirinë e fjalës sulmon dhe fyen të tjerët.

Për 41 rastet e mësipërme, AMA ka adresuar 33 "Tërheqje vemendjeje, si dhe 8 "Sanksion me gjobë" për OSHMA-të ku janë konstatuar shkeljet.

- **Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme. Natyra e shkeljeve të kësaj kategorie ishte:**

-13 raste lidhen me trasmetimin e pamjeve të rënda në orar të papërshtatshëm dhe pa teknika mbulimi, kur mendohet se para ekranit janë fëmijët, duke mos respektuar ligjin 97/2013, i ndryshuar, se programet audio dhe audiovizive të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, do të transmetohen vetëm në atë mënyrë që siguron se fëmijët normalisht nuk do t'i dëgjojnë ose shohin ato, përmes zgjedhjes së kohës së transmetimit, aplikimit të mjeteve të verifikimit të moshës ose përmes masave të tjera teknike.

-6 raste të transmetimit në orar të papërshtatshëm të përmbajtjeve muzikore me fjalor jo etik, pamje të dhunshme, të përdorimit të alkoolit apo substancave psikotrope etj., duke mos respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit se, OSHMA-të duhet të shmangin transmetimet me përmbajtje dhune, bullizmi, gjuhe urrejtjeje, me fjalor banal apo të papërshtatshëm, transmetimet e pakontrolluara dhe të dëmshme për fëmijët, përfshirë këngë dhe/ose video në oraret e aksesueshme nga fëmijët.


INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL

-2 raste të transmetimit të pamjeve për të rritur në orar të papërshtatshëm, kur para ekranit mendohet se janë fëmijët
-2 raste reklamash bullizuese ku shfaqen femijët që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të tyre.
Nga monitorimi periodik i përmbajtjeve të transmetuara është vënë re se identifikimi i përmbajtjeve të papërshtatshme nuk është vënë re në programat e dedikuara për fëmijët, apo programet e realizuara nga fëmijët. Shkeljet janë identifikuar në emisionet informative ku jepen pamje të ngjarjeve të rënda (aksidente, ushtrim dhune etj). Siç u përmend më sipër, shkelje janë konstatuar dhe në kanalet muzikore me përfshirjen e transmetimeve të këngëve me fjalor jo etik, me pamje të dhunshme, të përdorimit të alkoolit apo substancave psikotrope etj.
Për 23 rastet, AMA ka adresuar 22 "Tërheqje Vëmendjeje", si dhe 1 "Sanksion me gjobë" për OSHMA-të ku janë konstatuar shkeljet.

- **Problematika me reklamat dhe komunikimet tregtare.** Nga 22 rastet e identifikuara gjatë shqyrtimeve dhe analizave të kryera, u vu re se në 6 raste u transmetuan reklama dhe komunikime tregtare të fshehta; po në 6 raste ato ishin me përmbajtje të papërshtatshme; në 4 raste u konstatua reklamë në fushën e shëndetit; në 2 raste u transmetuan reklama të zgjeruara jashtë kohës së lejuar; si dhe në 1 rast kishte reklamë vetëm në gjuhë të huaj.
Në vlerësimin e shkeljeve të kësaj natyre, AMA i është referuar përcaktimeve të ligjit 97/2013, i ndryshuar, për komunikimin e fshehtë audioviziv me natyrë tregtare, që është paraqitja me fjalë ose figurë e mallrave, shërbimeve, emërtimit, markës së prodhimit ose i veprimtarive të një prodhuesi mallrash ose ofruesi shërbimesh, në programe, kur një paraqitje e tillë, nga ofruesi i shërbimit të mediave, ka për qëllim të shërbejë si reklamë dhe mund të mashtrojë publikun mbi natyrën e tij. Në mënyrë të qartë ligji thotë se komunikimet me natyrë tregtare të fshehura janë të ndaluara, apo se lajmet dhe programet informative që lidhen me politikën nuk mund të sponsorizohen.
Për rastet kur përmbajtjet reklamuese kanë qenë nga fusha e shëndetit, referenca ka qënë tek përcaktimi ligjor se komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive për produktet farmaceutike apo produktet dhe trajtimet mjekësore, që jepen vetëm me recetën e mjekut, janë të ndaluara. Referencë e rëndësishme është dhe "Rregullorja për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare, format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave", që shprehet se gjatë transmetimeve televizive është e ndaluar që realizuesit e programit dhe pjesëmarrësit në të, të bëjnë reklamimin e barnave.
Për 22 rastet e shkeljeve me transmetim reklame dhe komunikimi tregtar, AMA ka adresuar 19 "Tërheqje Vëmendjeje", si dhe 3 "Sanksion me gjobë" për OSHMA-të ku janë konstatuar shkeljet.

- **Përdorimi i gjuhës shqipe të shkruar e të folur.** Në muajin korrik 2025, AMA realizoi një shqyrtim të përmbajtjeve të transmetuara me objektiv respektimin e standardit letrar të gjuhës shqipe, të shkruar dhe të folur, nga OSHMA-të. Nga përmbajtjet e monitoruara u vu re se, nga redaksitë ka mungesë kujdesi për zbatim të standardit letrar të shkruar e të folur, duke mos kapur nivelin e detyrimit dhe rolit që kanë mediat audiovizive për ruajtjen dhe përdorimin e gjuhës amtare në programet audiovizive. Përgjithësisht gjuha e folur, në lajme dhe programe informative, veçanërisht në televizionet kombëtare, dëshmon për rritje të kujdesit ndaj drejtshqiptimit e komunikimit, po nuk respekton me përpikëri parimet, normat dhe kërkesat gjuhësore.
Në programet me natyrë argëtuese janë identifikuar dhe komunikime në zhargon të moderatorëve me të ftuarit, si dialogje të rëndomta që hasen në mjedise të lirshme kafenesh apo mjedise të tjera publike dhe private. Gjatë gjithë periudhës së monitorimit, në të gjitha OSHMA-të, u vërejtën mjaft raste të përdorimit të panevojshëm, nga gazetarët e moderatorët, të fjalëve, fjalive e ndërtimeve sintaksore të gjuhëve të huaja. AMA në mënyrë periodike publikon raste të përdorimit të fjalëve të huaja nga redaksitë audio/audiovizive, në kuadër të nismës "Fol shqip".
Nga vlerësimi i përmbajtjeve të transmetuara u konstatua se, edhe pse ka përmirësime, në televizionet informative, në shkrimin e titrave, por dhe në televizione kombëtare, në titrat e edicioneve informative, vijon të mos përdoret gërma "Ë"(e madhe) dhe "Ç" (e madhe). Kjo krijon dhe vështirësi e keqkuptime te teleshikuesit. Në mjaft raste të tjera, në të njëjtat televizione, sidomos në përkthimin e filmave e dokumentarëve, germat "Ë", "ë", "Ç", "ç", përdoren sipas normës drejtshkrimore.

Për AMA-n transmetimet audiovizive kanë një rol dhe ndikim shumë të rëndësishëm te ndjekësit, jo vetëm për informim, edukim dhe argëtim, por dhe për ruajtjen dhe pasurimin e gjuhës shqipe. Standardi i shqipes së folur dhe të shkruar është përgjegjësi redaksionale, si pjesë e shërbimit dhe angazhimit të tyre për përmbajtje sa më cilësore dhe të shumëllojshme.
Pas shqyrtimit të realizuar në muajin qershor 2025, AMA u dërgoi njoftim zyrtar "Tërheqje vëmendjeje" 16 OSHMA-ve.

Përmbledhja e shkeljeve të identifikuara gjatë viti 2025 jepet në tabelën vijuese:

| KATEGORIA E SHKELJES | OSHMA | EMISIONI/RUBRIKA | SANKSIONI |
|---|---|---|---|
| Shkelje etike<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, germa "ç"; neni 33, pika 1, germa "b" | TV Kombëtar | Rubrikë debati | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b dhe 2/dh; neni 33, pika 1/d; si dhe Kodi i Transmetimit në pikat 4.5; 4.6; 4.11; 4.66; 4.67 dhe 4.69. | TV Rajonal | Tërësia programore | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b dhe 2/dh; neni 33, pika 1/d; si dhe Kodi i Transmetimit në pikat 4.5; 4.6; 4.11; 4.66; 4.67 dhe 4.69. | TV Rajonal | Tërësia programore | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b dhe 2/dh; neni 33, pika 1/d; si dhe Kodi i Transmetimit në pikat 4.5; 4.6; 4.11; 4.66; 4.67 dhe 4.69. | TV Rajonal | Tërësia programore | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b dhe 2/dh; neni 33, pika 1/d; si dhe Kodi i Transmetimit në pikat 4.5; 4.6; 4.11; 4.66; 4.67 dhe 4.69. | TV Rajonal | Tërësia programore | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1, neni 33, pika 1/"ç"; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 3.9. | TV Rajonal | Edicione informative | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1, neni 33, pika 1/"ç"; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 3.9. | TV Rajonal | Edicione informative | Tërheqje vëmendjeje |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1, neni 33, pika 1/"ç"; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 3.9. | TV Rajonal | Edicione informative | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1, neni 33, pika 1/"ç"; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 3.9. | TV Rajonal | Edicione informative | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1, neni 33, pika 1/"ç"; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 3.9. | TV Rajonal | Edicione informative | Tërheqje vëmendjeje |
| Reklamë e papërshtatshme<br>Nuk u respektua ligji nr 97/2013, i ndryshuar, neni 42/6 | TV Rajonal | Blloku i reklamave | Tërheqje vëmendjeje |
| Reklamë e papërshtatshme<br>Nuk u respektua ligji nr 97/2013, i ndryshuar, neni 42/6 | TV Kombëtar | Blloku i reklamave | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji nr 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1; neni 4 pika 1/b | TV Rajonal | Emision social | Tërheqje vëmendjeje |
| Shkelje etike<br>Nuk u respektua ligji nr 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b; neni 33, pika 1/d; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 11. | TV Kombëtar | Emision argëtues | Tërheqje vëmendjeje |
| Reklamë e papërshtatshme<br>Nuk u respektua ligji nr 97/2013, i ndryshuar, neni 42/6 . | TV Kombëtar | Blloku i reklamave | Tërheqje vëmendjeje |
| Shkelje etike<br>Nuk u respektua ligji nr 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/ç. | TV Rajonal | Emision argëtues | Tërheqje vëmendjeje |
| Gjuhë diskriminuese, racizëm<br>Nuk u respektua ligji nr 97/2013, i ndryshuar, neni 32, pika 4; nenin 33, pika 1/ç; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 7.9. | TV Kombëtar | Emision sportiv | Tërheqje vëmendjeje |
| Shkelje etike<br>Nuk u respektua ligji nr 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1.6; pika 7.9. | TV Rajonal | Emision informativ-argëtues | Tërheqje vëmendjeje |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Mbrojtja e të dhënave personale<br>Nuk u respektua Kodi i Transmetimit, pika 1.12. | TV Rajonal | Emision debat | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1, neni 33, pika 1/"ç"; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 3.9. | TV Rajonal | Edicione informative | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1, neni 33, pika 1/"ç"; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 3.9. | TV Rajonal | Edicione informative | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1, neni 33, pika 1/"ç"; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 3.9. | TV Rajonal | Edicione informative | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 32/1, neni 33, pika 1/"ç"; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 3.9. | TV Rajonal | Edicione informative | Tërheqje vëmendjeje |
| Shkelje etike<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b; neni 32/1, pika 1; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 4.69. | TV Rajonal | Emision investigativ-argëtues | Tërheqje vëmendjeje |
| Përmbajtje joetike ndaj besimit fetar.<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, pika 4; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 1.6. | TV Kombëtar | Emision argëtues | Tërheqje vëmendjeje |
| Gjuhë diskriminuese<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, pika 4; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 1.6. | TV Kombëtar | Emision argëtues | Tërheqje vëmendjeje |
| Shkelje etike<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 33, neni 4, pika 2/"d" e "dh"; si dhe Kodi i Transmetimit pika 1.5; pika 5.31 dhe pika 5:34. | TV Kombëtar | Emision argëtues | Sanksion me gjobë |
| Mbrojtja e fëmijëve<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 1/b, neni 33, pika 1/"ç", neni 32/1; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 1.4 dhe pika 2.18. | TV Rajonal | Emision social | Sanksion me gjobë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Gjuhe diskriminuese<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika “dh”, neni 33, pika “d”, si dhe Kodi i Transmetimit, pika 1.6 dhe 5.1. | TV Rajonal | Emision debat | Tërheqje vëmendjeje |
| Reklamë e papërshtatshme<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 42, pika 5; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 4.43. | TV Rajonal | Blloku i reklamave | Tërheqje vëmendjeje |
| Reklamë e papërshtatshme<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 42, pika 5; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 4.43. | TV Kombëtar | Blloku i reklamave | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve, reklamë e papërshtatshme<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 42, si dhe Kodi i Transmetimit, pikat 4.48, 4.51; 4.54). | TV Kombëtar | Blloku i reklamave | Tërheqje vëmendjeje |
| Mbrojtja e fëmijëve, reklamë e papërshtatshme<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 42, si dhe Kodi i Transmetimit, pikat 4.48, 4.51; 4.54). | TV Kombëtar | Blloku i reklamave | Tërheqje vëmendjeje |
| Shkelje etike<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 33, pika 1/d dhe neni 32/1, pika 4/c. | TV Kombëtar | Emision debatues | Tërheqje vëmendjeje |
| Përmbajtje e papërshtatshme përmes mjekësisë holistike<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika1/ç; neni 33, pika1/f; neni 46, pika 2/b; si dhe Kodi i Transmetimit, pika 1.9. | TV Rajonal | Emision informativ | Tërheqje vëmendjeje |
| Shkelje etike<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pikat 2/b; 2/d dhe 2/dh; neni 32/1); si dhe Kodi i Transmetimit, pika 4.69. | TV Kombëtar | Emision argëtues | Tërheqje vëmendjeje |
| Reklamë e zgjeruar në kohë të papërshtatshme<br>Nuk u respektua ligji, 97/2013, i ndryshuar, neni 38, pika 2/b. | TV Kombëtar | Blloku i reklamave | Tërheqje vëmendjeje |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shkelje etike<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, pika 2/d e 2dh; neni 32, pika 4/a. | TV Kombëtar | Rubrikë edukative | Tërheqje vëmendjeje |
| Gjuha shqipe e folur dhe e shkruar.<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, ku përcaktohet detyrimi i OSHMA-ve për përdorimin e standardit letrar të gjuhës shqipe | TV Kombëtar | Tërësia programore | Tërheqje vëmendjeje |
| Gjuha shqipe e folur dhe e shkruar.<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, ku përcaktohet detyrimi i OSHMA-ve për përdorimin e standardit letrar të gjuhës shqipe. | TV Kombëtar | Tërësia programore | Tërheqje vëmendjeje |
| Gjuha shqipe e folur dhe e shkruar.<br>Nuk u respektua ligji 97/2013, i ndryshuar, neni 4, ku përcaktohet detyrimi i OSHMA-ve për përdorimin e standardit letrar të gjuhës shqipe | TV Kombëtar | Tërësia programore | Tërheqje vëmendjeje |
8. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (debat në studio), me publikim të paautorizuar të dhënash personale, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 46, pika 4/d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 1, pika 1.1, 1.12, Seksioni 2, pika 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.25) – (Datë 03.03.24).
9. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (debat në studio), me publikim të paautorizuar të dhënash personale, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 46, pika 4/d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 1, pika 1.1, 1.12, Seksioni 2, pika 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.25) – (Datë 04.04.24).
10. Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime (debat në studio), me publikim të paautorizuar të të dhënave personale sensitive (kartela mjekësore), në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33, pika 1/dh) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 3, pika 3.18) – (Datë 26.05.24).
11. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (debat në studio), me cenim të figurës, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33, pika 1/c) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 1, pika 1.3, Seksioni 2, pika 2.16, Seksioni 3, pika 3.18) – (Datë 26.05.24).
12. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1,2 dhe Neni 33, pika ç,d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).
13. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1,2 dhe Neni 33, pika ç,d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).
14. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1,2 dhe Neni 33, pika ç,d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).
15. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1,2 dhe Neni 33, pika ç,d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025)
16. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1,2 dhe Neni 33, pika ç,d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).
17. Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1,2 dhe Neni 33, pika ç,d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).
18. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1,2 dhe Neni 33, pika ç,d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).
19. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1,2 dhe Neni 33, pika ç,d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).
20. Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1,2 dhe Neni 33, pika ç,d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).

21. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1.2 dhe Neni 33, pika ç.d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).
22. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të një të miture viktimë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1.2 dhe Neni 33, pika ç.d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.47 dhe Seksioni 4, pika 4.24, 4.25) – (Datë 25.07.2025).
23. Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të miturve dëshmitarë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1.2 dhe Neni 33, pika ç.d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.14 dhe Seksioni 4, pika 4.25) – (Datë 25.07.2025).
24. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me identifikim të tërthortë të miturve dëshmitarë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 32/1, pika 1.2 dhe Neni 33, pika ç.d) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.14 dhe Seksioni 4, pika 4.25) – (Datë 25.07.2025).
25. Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me publikim të paautorizuar të dhënash personale të viktimës së një aksidenti dhe pamjeve të ndjeshme nga vendngjarja, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33, pika 1/dh) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni Seksioni 3, pika 3.18)– (Datë 31.07.2025).
26. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me publikim të paautorizuar të dhënash personale të viktimës së një aksidenti dhe pamjeve të ndjeshme nga vendngjarja, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33, pika 1/dh) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni Seksioni 3, pika 3.18) – (Datë 31.07.2025).
27. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (edicione lajmesh), me publikim të paautorizuar të dhënash personale të viktimës së një aksidenti dhe pamjeve të ndjeshme nga vendngjarja, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 33, pika 1/dh) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni Seksioni 3, pika 3.18) – (Datë 31.07.2025).
28. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (debat në studio), me nxitje dhune, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 4, pika 2/dh, Neni 32, pika 4/a, Neni 32/1, pika 1, Neni 46, pika 2/dh) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 1, pika 1.5, 1.6, Seksioni 3, pika 3.9, 3.10, 3.11, Seksioni 4, pika 4.13, 4.19, 4.59, 4.60, 4.69/1)– (Datë 08.10.2025).
29. Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime (debat në studio), me publikim të paautorizuar të të dhënave personale dhe shkelje të prezumimit të pafajësisë, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni)– (Datë 13.11.2025).
30. Një subjekti audioviziv iu tërhoq vëmendja për transmetime (debat në studio), me identifikim të dhënash personale të fëmijës, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 4, pika 1/b) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.2, 2.12 dhe Seksioni 4, pika 4.1, 4.4) – (Datë 09.12.2025).
31. Një subjekti audioviziv kombëtar iu tërhoq vëmendja për transmetime (debat në studio), me identifikim të dhënash personale të fëmijës, në shmangie të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar (Neni 4, pika 1/b) dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr.60, datë 10.07.2023, i ndryshuar (Seksioni 2, pika 2.2, 2.12 dhe Seksioni 4, pika 4.1, 4.4) – (Datë 09.12.2025).


INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL




Grafiku i mësipërm paraqet masat administrative të marra gjatë viteve 2023–2025, të ndara në tre kategori: tërheqje vëmendjeje, gjoba dhe sensibilizime. Siç shihet, masa më e shpeshtë ka qenë tërheqja e vëmendjes, me rritje të ndjeshme në vitin 2024 (36 raste) dhe një ulje të lehtë në 2025 (31 raste). Gjoba janë përdorur më rrallë, me numrin më të ulët në vitin 2024 (2 raste) dhe më të lartë në 2023 (6 raste). Sensibilizimet kanë shënuar rritje të qëndrueshme, nga 2 raste në 2023 në 6 raste si në 2024, ashtu edhe në 2025, duke reflektuar një qasje më proaktive ndaj edukimit dhe ndërgjegjësimit.

**2. Studim sasior për perceptimin e qytetarëve dhe/apo grupeve të ndryshme të interesit për standardet etike të ofertës audiovizive dhe Platformave të Shpërndarjes së Videove, lirinë e shprehjes dhe të drejtat e gazetarëve**

Në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe ligjore të Autoritetit të Mediave Audiovizive, si dhe në funksion të forcimit të bazës faktike mbi të cilën mbështetet vendimmarrja rregullatore, gjatë periudhës dhjetor 2024 – mars 2025 u realizua një studim kombëtar i perceptimit të publikut shqiptar mbi standardet etike të ofertës audiovizive dhe digjitale, i konceptuar nga Këshilli i Ankesave dhe i zbatuar në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT).

Nisma për ndërmarrjen e këtij kërkimi sasior të mirëfilltë u ndërtua mbi disa nevoja strukturore të identifikuara nga AMA dhe Këshilli i Ankesave gjatë viteve të fundit: përfundimi i procesit të digjitalizimit dhe zgjerimi i ndjeshëm i ofertës audiovizive; ndryshimi i mënyrave të konsumit mediatik nga publiku; detyrimet që rrjedhin nga përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Europian; shtimi i nismave qytetare që artikulojnë perceptime dhe pritshmëri ndaj medias; si dhe mungesa e deriatëhershme e një baze statistikore të pavarur dhe të verifikueshme për të mbështetur vendimmarrjen e Autoritetit.

Studimi u konceptua si vrojtim kombëtar sasior, me standarde të plota shkencore, duke respektuar legjislacionin për statistikat zyrtare dhe duke u realizuar përmes intervistave ballë për ballë (CAPI), mbi bazën e një kampioni të rastësishëm të shtresëzuar sipas zonës gjeografike, moshës, gjinisë dhe dendësisë së popullsisë. Pyetësori u hartua nga Këshilli i Ankesave dhe iu nënshtrua procesit të përshtatjes metodologjike nga INSTAT, me qëllim garantimin e përfaqësueshmërisë dhe besueshmërisë së rezultateve.

Përmbajtja e pyetësorit përfaqësoi një risi të rëndësishme në raport me vrojtimet e mëparshme, pasi për herë të parë, krahas vlerësimit të standardeve klasike etike të transmetimeve audiovizive, u përfshinë në mënyrë të strukturuar edhe dimensione të tilla si: perceptimi mbi dezinformimin, Platformat e Shpërndarjes së Videove dhe rrjetet sociale, kontrolli i sjelljes digjitale, mbrojtja e fëmijëve dhe të dhënave personale, si dhe pozicioni i gazetarit dhe presionet mbi profesionin në shoqërinë shqiptare.

Rezultatet e studimit, të përpunuara dhe të interpretuara gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, ofruan për Kuvendin dhe për Autoritetin një pasqyrë të qartë, të matshme dhe empirike të marrëdhënies së publikut me median. Të dhënat treguan se audienca shqiptare konsumoi media në mënyrë intensive, kryesisht përmes platformave online dhe rrjeteve sociale, ndërkohë që perceptoi një nivel të lartë rreziku nga dezinformimi pikërisht në këto hapësira digjitale. Një pjesë e konsiderueshme e publikut deklaroi mungesë aftësish për verifikimin e informacionit dhe kontrollin e kohës së qëndrimit online, çka evidentoi nevojën për ndërhyrje të strukturuara në fushën e edukimit mediatik dhe digjital.

Në lidhje me standardet etike të transmetimeve audiovizive, studimi evidentoi një ndarje të qëndrimeve publike: nga njëra anë, shumica e të anketuarve vlerësoi se pluralizmi, respektimi i jetës private dhe mosdiskriminimi fetar ishin në përgjithësi të garantuara; nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme shprehu shqetësime serioze lidhur me trajtimin e fëmijëve në media, përdorimin e shenjave paralajmëruese, transmetimin e programeve të dëmshme gjatë orareve të ndaluara, si dhe përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe çështjet e diskriminimit në kuptimin më të gjerë.

Një vlerë e veçantë e këtij studimi qëndroi në faktin se ai përforcoi rolin e Këshillit të Ankesave si organ vlerësues i standardeve etike, duke i ofruar një instrument objektiv për të krahasuar perceptimin publik me praktikat konkrete të trajtimit të ankesave dhe vendimmarrjen rregullatore. Të dhënat e vrojtimit shërbyen tashmë si referencë empirike për interpretimin e ankesave, për përcaktimin e proporcionalitetit të masave administrative dhe për orientimin e politikave rregullatore të AMA-s në përputhje me interesin publik.

Në plan më të gjerë institucional, studimi ofroi të dhëna të besueshme mbi gjendjen reale të mjedisit mediatik, perceptimet e qytetarëve dhe sfidat e reja që solli transformimi digjital. Ai e zhvendosi vlerësimin e standardeve etike nga perceptimet fragmentare drejt një baze të strukturuar statistikore. Vlerat konkrete të studimit për vitin 2025 qëndruan në mundësinë e ofruar për të orientuar vendimmarrjen, për të forcuar transparencën dhe për të mbështetur Autoritetin në ushtrimin e funksionet e tij rregullatore.

### 3. Angazhim në kuadrin e mbrojtjes nga Dezinformimi gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vijuar angazhimin e tij institucional në adresimin e fenomenit të Dezinformimit, në përputhje me kompetencat rregullatore të përcaktuara nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në funksion të mbrojtjes së interesit publik, standardeve etike të informimit dhe besueshmërisë së mjedisit mediatik.
Qasja e AMA-s ndaj Dezinformimit është ndërtuar mbi një kombinim të mekanizmave rregullatorë, interpretimit të standardeve etike përmes vendimmarrjes administrative, si dhe mbështetjes së masave parandaluese, përfshirë edukimin mediatik, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe forcimin e vetërregullimit. Në këtë kuadër, Këshilli i Ankesave ka ushtruar rolin e tij funksional në shqyrtimin e përmbajtjeve audiovizive dhe në vlerësimin e rasteve ku dezinformimi ndërthuret me shkelje të etikës profesionale, cenim të interesit publik apo të drejtës për informim të saktë.

Një element i rëndësishëm mbështetës për këtë qasje gjatë vitit 2025 ka qenë realizimi i studimit kombëtar të perceptimit mbi standardet etike të ofertës audiovizive, i konceptuar nga AMA përmes Këshillit të Ankesave dhe i realizuar në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, në periudhën dhjetor 2024 – mars

2025. Rezultatet e këtij studimi kanë evidentuar se publiku shqiptar percepton Dezinformimin si një nga sfidat kryesore të mjedisit informativ bashkëkohor, veçanërisht në platformat online dhe rrjetet sociale, por me ndikim të drejtpërdrejtë edhe në besimin ndaj medias audiovizive tradicionale. Këto të dhëna kanë shërbyer si bazë empirike për orientimin e qëndrimeve rregullatore dhe për forcimin e proporcionalitetit të vendimmarrjes administrative të Autoritetit.
Paralelisht me veprimtarinë rregullatore, AMA ka kontribuar edhe në proceset strategjike kombëtare që lidhen me adresimin e Dezinformimit. Në kuadër të hartimit të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030, Kryetarja e Këshillit të Ankesave ka marrë pjesë në grupin e ekspertëve pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke sjellë në këtë proces ekspertizën rregullatore të Autoritetit në fushën e medias audiovizive. Ky kontribut ka ndihmuar në reflektimin në Strategji të rolit të autoriteteve rregullatore të medias, të nevojës për ndarje të qartë kompetencash dhe të rëndësisë së respektimit të lirisë së shprehjes në çdo ndërhyrje kundër Dezinformimit.
Në vlerësim përfundimtar, angazhimi i Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe i Këshillit të Ankesave, si pjesë e tij, gjatë vitit 2025 në fushën e mbrojtjes nga Dezinformimi, ka qenë i strukturuar, i bazuar në projekte dhe bashkëpunime konkrete sipas fushave të ekspertizës dhe i koordinuar me proceset strategjike kombëtare. Vlera konkrete e këtij angazhimi qëndron në forcimin e kapaciteteve rregullatore, në mbështetjen e vendimmarrjes mbi evidencë, bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe faktorë të tjerë të tregut dhe në kontributin institucional për ndërtimin e një mjedisi informativ më të besueshëm dhe më rezistent ndaj Dezinformimit.

## 4. Angazhim në kuadrin e Edukimit Mediatik

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka vijuar dhe thelluar angazhimin e tij strategjik në fushën e Edukimit Mediatik, duke e konsideruar këtë dimension si një nga instrumentet kryesore parandaluese për mbrojtjen e interesit publik, forcimin e të menduarit kritik dhe rritjen e rezistencës së publikut, veçanërisht të të rinjve dhe fëmijëve, ndaj rreziqeve të mjedisit audioviziv dhe digjital. Nismat e zhvilluara gjatë këtij viti përfaqësojnë një vijimësi të punës së nisur në vitin 2024, por njëkohësisht shënojnë edhe zgjerim gjeografik, tematik dhe konceptual të ndërhyrjeve edukuese të AMA-s.
Në kuadër të Edukimit Mediatik në institucionet e arsimit parauniversitar, AMA ka vijuar aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuese me nxënës të shkollave të mesme, duke e shtrirë këtë program përtej Tiranës, në qytete të tjera të vendit. Gjatë vitit 2025, janë zhvilluar takime me më shumë se 200 nxënës të 3 gjimnazeve të qytetit të Durrësit, "Gjergj Kastrioti", "Naim Frashëri" dhe "Leonik Tomeo" ku u trajtuan çështje që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve në mjedisin mediatik dhe digjital. Diskutimet janë fokusuar në identifikimin dhe kuptimin e gjuhës së urrejtjes, bullizmit online, ekspozimit ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, dhunës në media, keqpërdorimit të të dhënave personale dhe efekteve të varësisë nga pajisjet digjitale. Qasja e ndjekur synon jo vetëm informimin, por edhe ndërtimin e aftësive kritike te nxënësit për të dalluar rreziqet e botës virtuale dhe për të përdorur teknologjinë në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme.
Paralelisht me aktivitetet në shkolla, AMA ka zhvilluar gjatë vitit 2025 një sërë fushatash të strukturuara të Edukimit Mediatik për publikun e gjerë. Një ndër nismat më të rëndësishme ka qenë bashkëpunimi me Zyrën e OSBE-së në Tiranë, i nisur në muajin gusht 2025, për prodhimin dhe vlerësimin ligjor të një pakete prej dhjetë videosh sensibilizuese, të paracaktuara për një fushatë kombëtare të edukimit mediatik. AMA ka ushtruar rolin e saj rregullator në verifikimin e përputhshmërisë së këtyre materialeve me ligjin nr. 97/2013 dhe Kodin e Transmetimit, duke analizuar në mënyrë të posaçme aspektet që lidhen me interesin më të lartë të fëmijës, mbrojtjen e privatësisë, luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe respektimin e dinjitetit njerëzor. Përpara nisjes së transmetimit të fushatës, gjatë Javës së Edukimit Mediatik (24–31 tetor 2025), u propozuan përmirësime konkrete në gjuhë, formulime dhe elemente grafike, me qëllim rritjen e qartësisë dhe efektivitetit të mesazheve. Pas reflektimit të këtyre komenteve, videot u transmetuan në RTSH dhe u publikuan në platformat zyrtare të OSBE-së dhe AMA-s, duke arritur një shtrirje të gjerë publike, respektivisht:
https://ama.gov.al/interesi-me-i-larte-i-femijes-dhe-mbrojtja-e-te-miturve-nga-permbajtjet-e-demshme/
https://ama.gov.al/bashkepunimi-ama-osbe-video-kunder-perdorimit-te-gjuhes-se-urrejtjes-ne-transmetime-televizive/
https://ama.gov.al/media-duhet-te-mbroje-te-drejtat-e-njeriut/

Gjatë gjithë vitit 2025, AMA ka vijuar gjithashtu publikimin e materialeve informuese dhe ndërgjegjësuese në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale, përmes infografikave, posterëve digjitalë dhe artikujve tematikë. Këto përmbajtje kanë trajtuar në mënyrë të vazhdueshme tema si mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet e botës virtuale, privatësia dhe të dhënat personale, përdorimi i Inteligjencës Artificiale në media, dallimi midis lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, rreziqet e piraterisë audiovizive dhe ndikimet e lojërave online tek adoleshentët. Qasja e ndjekur synon ndërtimin e një kulture të qëndrueshme informimi dhe vetëdijeje mediatike në publik.

Materialet janë publikuar respektivisht si më poshtë:

1. https://ama.gov.al/gjuha-e-urrejtjes-disa-keshilla-per-te-mbrojtur-femijet-qe-lundrojne-ne-internet/
2. https://ama.gov.al/si-te-mbrojme-femijet-nga-gjuha-e-urrejtjes/
3. https://ama.gov.al/keshilla-si-te-mbrojme-femijet-nga-gjuha-e-urrejtjes/
4. https://ama.gov.al/disa-keshilla-se-si-duhet-te-silleni-me-femijet-kur-ata-perballen-me-gjuhen-e-urrejtjes/
5. https://ama.gov.al/8-shtylla-per-nje-strategji-te-suksesshme-te-prinderimit-digjital/
6. https://ama.gov.al/teknologjia-dhe-praktikat-e-prinderimit/
7. https://ama.gov.al/lojrat-online-12-per-qind-e-adoleshenteve-te-ekspozuar-ndaj-rreziqeve/
8. https://ama.gov.al/efektet-e-mundshme-te-demshme-te-perdorimit-te-ia/
9. https://ama.gov.al/kujdes-pirateria-televizive-ka-disa-forma/
10. https://ama.gov.al/dallimi-mes-gjuhes-se-urrejtjes-dhe-lirise-se-fjales/
11. https://ama.gov.al/perdorimet-kryesore-te-inteligjences-artificiale-ne-media/
12. https://ama.gov.al/rreziku-nga-bota-virtuale-komunikimi-me-femijet-tejet-i-rendesishem/
13. https://ama.gov.al/rreziqet-e-mjediseve-kibernetike-ku-duhet-te-beni-kujdes/
14. https://ama.gov.al/interesi-me-i-larte-i-femijes-dhe-mbrojtja-e-te-miturve-nga-permbajtjet-e-demshme/
15. https://ama.gov.al/bashkepunimi-ama-osbe-video-kunder-perdorimit-te-gjuhes-se-urrejtjes-ne-transmetime-televizive/
16. https://ama.gov.al/media-duhet-te-mbroje-te-drejtat-e-njeriut/

Një element i veçantë i vitit 2025 ka qenë konceptimi dhe zhvillimi nga AMA i një fushate të dedikuar me fokus interesin më të lartë të fëmijës në mjedisin audioviziv. Kjo fushatë është ndërtuar mbi problematikat e evidentuara nga monitorimi dhe nga ankesat e publikut dhe synon t'u paraprijë shkeljeve përmes ndërgjegjësimit dhe udhëzimit praktik. Materialet e fushatës trajtojnë rreziqet e ekspozimit të fëmijëve në media, përfshirë cenimin e privatësisë, ekspozimin ndaj dhunës dhe traumës, seksualizimin e hershëm dhe shfrytëzimin e fëmijëve për audiencë apo sensacionalizëm. Qasja e ndjekur kategorizon situatat problematike dhe ofron udhëzime konkrete për operatorët audiovizivë, prindërit dhe vetë fëmijët. Videot janë publikuar në faqen zyrtare të AMA-s, respektivisht:

https://ama.gov.al/te-dhenat-personale-te-femijeve-nuk-ndahen/
https://ama.gov.al/femijet-nuk-jane-audience-e-pambrojtur/
https://ama.gov.al/femija-nuk-perdoret-per-audience/
https://ama.gov.al/mendo-pastaj-kliko/

Fushata parashikon edhe zhvillimin e një pakete vizuale të plotë komunikimi, e cila do të publikohet gjatë vitit 2026.

Në vlerësim përfundimtar, nismat e edukimit mediatik të zhvilluara nga AMA gjatë vitit 2025 dëshmojnë një qasje të qëndrueshme dhe të strukturuar, që kombinon edukimin formal, ndërgjegjësimin publik dhe ndërhyrjen parandaluese. Këto nisma përfaqësojnë një investim afatgjatë në mbrojtjen e audiencave vulnerabël, në forcimin e standardeve etike dhe në ndërtimin e një mjedisi mediatik më të sigurt, më të përgjegjshëm dhe më rezistent ndaj rreziqeve të informacionit në epokën digjitale.



# 8. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE

**8.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit**

Referenca parësore ligjore, mbi të cilën e AMA e mbështet veprimtarinë e vet administrative dhe rregullatore, mbetet ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Gjithashtu, veprimtaria e AMA-s ushtrohet në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore, që rregullojnë fushën e medias audio dhe audiovizive. Legjislacioni dytësor (rregullore, vendime dhe udhëzime), i miratuar në bazë dhe zbatim të ligjit të posaçëm organik, luan një rol të rëndësishëm në realizimin e misionit dhe funksionit të Autoritetit.

Gjatë periudhës raportuese, institucioni ka marrë pjesë aktive në tryezat dhe konsultimet lidhur me ndryshime të qenësishme të kuadrit ligjor, mbi të cilin mbështetet veprimtaria administrative e Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ka vijuar plotësimi i legjislacionit dytësor me akte rregullatore që synojnë krijimin e një mjedisi të shëndetshëm e të rregulluar mediatik, ku të garantohet zhvillimi dhe përmirësimi i sektorit të transmetimeve audiovizive.

**8.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA - ve**

AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
Funksionet kryesore të AMA-s sipas nenit 19 janë: a) shqyrtimi i propozimeve dhe aplikimeve për ushtrimin e shërbimeve të transmetimit, përfshirë aplikimet për transmetime numerike dhe dhënia e autorizimeve ose licencave përkatëse, në përputhje me këtë ligj, përfshirë shërbimet e ofruara nga RTSH-ja; b) lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar;
Gjithashtu në funksion të kompetencave që burojnë nga ligji organik, AMA kontrollon zbatimin e këtij ligji nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të këtij ligji dhe, në rast shkeljesh, vendos sanksione. AMA monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga OSHMA-të.
Në nenin 23 të ligjit "Kompetencat e AMA-s ... për realizimin në mënyrë të plotë të funksioneve të saj, AMA ka këto kompetenca: a) lëshon licenca dhe/ose autorizime; b) u kërkon mbajtësve të licencave dhe/ose autorizimeve realizimin e detyrimeve financiare ndaj AMA-s; c) siguron zbatimin e kushteve të licencave dhe/ose autorizimeve të lëshuara prej saj;
Në nenin 55 të ligjit janë përcaktuar llojet e licencave dhe autorizimeve dhe afatet e tyre përkatësisht: Autorizimet e shërbimit të programit audio dhe autorizimet e shërbimit të programit audioviziv, kur shërbimi mbështetet në rrjetet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 54 të këtij ligji, janë: a) satelitor, kur shërbimi mbështetet në një sistem satelitor; b) kabllor kur shërbimi mbështetet në një sistem kabllor;

c) shërbimi on line, kur shërbimi mbështetet në internet; ç) ofrues shërbimi, përfshirë shërbimin e aksesit të kushtëzuar.
Gjithashtu në Neni 78-të po këtij ligji, AMA ka të drejtë të ushtrojë kontroll të veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Çdo inspektim, veçanërisht inspektimi i veprimtarisë programore, nuk duhet të cenojë lirinë e shprehjes. I licencuari bashkëpunon me AMA-n për realizimin e këtij funksioni. AMA autorizon nëpunës të specializuar të administratës së vet apo persona të tjerë të specializuar për të realizuar këtë inspektim nëse: a) ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, që tregojnë se i licencuari dhe/ose i autorizuari nuk realizon shërbimin në përputhje me kushtet e licencës dhe/ose autorizimit; b) realizimi i shërbimit të ofruar nga i licencuari shkakton interferenca; c) ka informacion për veprimtari të palicencuar dhe/ose të paautorizuar.

Në zbatim të dispozitave të nenit 78-të, të ligjit nr 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar dhe nga verifikimet në terren nga ana e inspektorëve të AMA, të subjekteve OSHMA lidhur me garantimin e të drejtave dhe ofrimin e shërbimit për të cilin janë pajisur me autorizim nga autoriteti u vërejt se shërbimet e të autorizuarve nuk janë në përputhje të plotë me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në autorizim.

Në këto kushte, AMA me iniciativën e vet, por bazuar dhe në ankesat e subjekteve mbajtëse të të drejtave të transmetimit, pas një analize dhe konsultimi publik të rregullores sipas përcaktimeve në ligj, miratoi Vendimin nr. 73/2025 për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren ekzistuese, nr. 99/2017, "Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve", i cili përmban përmirësime, shtesa dhe rregullime kryesisht në kriteret e përgjithshme për dhënien e autorizimeve me qëllim detyrimin e OSHMA (Ofrues i Shërbimit Mediatik Audioviziv), për të transmetuar vetëm në formatin që është në përputhje me autorizimin që disponon apo do të marrë gjatë rinovimit, dhe nuk mund të transmetojë një format tjetër që nuk është në përputhje me autorizimin që disponon apo do të marrë gjatë rinovimit.

Në vështrim tërësor Vendimi nr. 73/2025 i AMA për disa ndryshme dhe shtesa në rregulloren, "Për procedurat dhe kriteret e dhënies së autorizimeve nr. 99/2017", i ndryshuar, është propozuar dhe është detyrë funksionale e autoritetit për t'i prerë rrugën piraterisë dhe abuzimit me të drejtën e transmetimit që gëzojnë subjektet e licencuara nga AMA, të cilët sipas ligjit duhet të transmetojnë vetëm në bazë të autorizimit/licencës që kanë marrë për ato shërbime që vetë OSHMA-të kanë kërkuar dhe AMA ka miratuar. Veprimi jashtë këtyre normave ligjore përbën shkelje dhe abuzim me tregun audioviziv si dhe shkel konkurrencën e ndershme në treg.

### 8.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit

Siç u theksua me lart, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr. 97/2013, datë 04.03.2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili është ndërtuar në përputhje me Direktivën 2010/13/BE për Shërbimet Mediatike Audiovizive (AVMSD) dhe rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimet mbështetëse të tyre mbi parimin e neutralitetit teknologjik. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për funksionimin e tregut audioviziv në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për ushtrimin e kompetencave rregullatore të AMA-s.
Gjatë periudhës raportuese, AMA ka vijuar procesin e plotësimit dhe modernizimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor. Në zbatim të legjislacionit organik dhe në respektim të parimeve të transparencës institucionale dhe konsultimit publik, hartimi i legjislacionit zbatues është shoqëruar nga procese të strukturuara konsultimi dhe këshillimi me palët e interesuara, përfshirë Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA), aktorët e tregut, institucionet publike dhe shoqërinë civile.
Në kuadër të detyrimeve periodike për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e medias audiovizive dhe digjitale, strukturat përkatëse të Autoritetit të Mediave Audiovizive kanë zhvilluar një rol aktiv në procesin e njohjes dhe analizimit të kuadrit ligjor evropian, si një parakusht thelbësor për transpozimin dhe zbatimin e tij në legjislacionin kombëtar. Ky proces ka përfshirë

angazhimin e drejtorive të ndryshme të institucionit në funksion të kuptimit dhe përshtatjes së standardeve të acquis, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ushtrimin e funksioneve administrative dhe rregullatore të AMA-s. Në të njëjtën kohë, përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve, është synuar forcimi i njohurive profesionale dhe përgatitja institucionale për zbatimin efektiv të këtyre standardeve, duke garantuar një gatishmëri operacionale që ndërthur ndërgjegjësimin institucional me zhvillimin e kapaciteteve administrative. Në këtë kontekst, janë marrë në konsideratë zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian, veçanërisht Rregullorja (BE) 2022/2065 për Shërbimet Digjitale (Digital Services Act – DSA), e cila vendos rregulla të drejtpërdrejta për shërbimet ndërmjetëse në tregun e brendshëm, duke përfshirë urdhrat për veprim kundër përmbajtjeve të paligjshme dhe urdhrat për dhënie informacioni sipas neneve 9 dhe 10 të DSA-së, detyrimin për caktimin e përfaqësuesit ligjor dhe pikës kombëtare të kontaktit sipas neneve 12 dhe 13, si dhe vendosjen e mekanizmave të detajuar "njoftim–veprim" në përputhje me nenin 16 të DSA-së dhe rregullimin e sistemeve të brendshme të trajtimit të ankesave sipas nenit 20 të DSA-së. Këto rregulla janë veçanërisht të rëndësishme në rastet e ritransmetimit të paautorizuar të ngjarjeve të drejtpërdrejta, ku shpesh konstatohet transmetimi i paligjshëm nga subjekte që nuk gëzojnë të drejta transmetimi, duke u shkaktuar dëm ekonomik mbajtësve të ligjshëm të këtyre të drejtave. Në këtë kuadër, AMA ka evidentuar nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor në fuqi, nevojë e cila synohet të adresohet përmes ndryshimeve ligjore që pritet të ndërmerren në kuadër të procesit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian, me qëllim parandalimin e abuzimeve me të drejtat e transmetimit dhe garantimin e mbrojtjes efektive të aktorëve të përfshirë në tregun mediatik. Në vijim të këtij procesi, Drejtoria e Legjislacionit dhe Integrimit Euopean, Drejtoria Ligjore dhe Integrimit Europian, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit, pas një procesi të thelluar njohjeje me këto zhvillime ligjore dhe në vijim të sesioneve trajnuese të mundësuara nga partnerët ndërkombëtarë të institucionit, ka kontribuar në konsolidimin e kapaciteteve institucionale dhe në forcimin e ekspertizës teknike brenda AMA-s. Këto kapacitete shërbejnë tashmë si bazë për vlerësimin dhe mbështetjen e ndërhyrjeve të nevojshme ligjore në këtë fushë, në funksion të përafrimit të mëtejshëm të kuadrit kombëtar me standardet e Bashkimit Evropian dhe rritjes së efektivitetit të mekanizmave rregullatorë kundër piraterisë dhe shkeljeve të të drejtave të transmetimit.

Në kuadër të këtij procesi reformues AMA ka ofruar kontribut teknik përmes analizave juridike dhe vlerësimit të përputhshmërisë së kuadrit ligjor ekzistues, në veçanti të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", me standardet dhe kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e medias dhe shërbimeve digjitale, duke marrë në konsideratë veçanërisht Aktin Europian të Lirisë së Medias (EMFA), Rregulloren për Shërbimet Digjitale (DSA) dhe Direktivën 2010/13/BE për Shërbimet e Medias Audiovizive (AVMSD). Ky proces është mbështetur në një analizë të detajuar institucionale të praktikave ekzistuese të mbikëqyrjes dhe rregullimit të sektorit mediatik, të krahasuara me kërkesat dhe standardet e kuadrit rregullator evropian të adresuara nga Komisioni Evropian. Në këtë kontekst, analiza institucionale është përqendruar në disa fusha kyçe të rregullimit mediatik. Një ndër elementët qendrorë lidhet me transparencën e pronësisë së medias, në përputhje me nenin 6 të EMFA-s dhe nenin 5 të AVMSD-së, duke u njohur se identifikimi i qartë i subjekteve që kontrollojnë ose përfitojnë nga ofruesit e shërbimeve mediatike përbën një element themelor për garantimin e pavarësisë editoriale, pluralizmit mediatik dhe konkurrencës së ndershme në treg. Në të njëjtën linjë, janë analizuar garancitë ligjore që lidhen me mbrojtjen e pavarësisë editoriale dhe ndalimin e çdo forme ndërhyrjeje shtetërore ose ndikimi politik apo ekonomik në politikat editoriale dhe vendimmarrjen profesionale të ofruesve të shërbimeve mediatike, në përputhje me kërkesat e EMFA-s. Gjithashtu, është vlerësuar edhe përputhshmëria e mekanizmave ekzistues institucionalë me kërkesat e nenit 7 të EMFA-s lidhur me garantimin e pavarësisë institucionale dhe funksionale të autoriteteve rregullatore, duke shqyrtuar elemente të tilla, autonominë funksionale të institucionit, procedurat transparente të emërimit dhe shkarkimit, vendimmarrjen e arsyetuar dhe të ankueshme gjyqësisht, si dhe garantimin e burimeve financiare dhe njerëzore të mjaftueshme për ushtrimin efektiv të funksioneve rregullatore. Analiza juridike

nga Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Legjislacionit dhe Integrimit kane trajtuar edhe çështjet që lidhen me rregullimin e sistemeve të matjes së audiencës, në përputhje me nenin 24 të EMFA-s dhe artikujt 12, 69, 70 dhe 71 të saj, duke vlerësuar nevojën për respektimin e parimeve të transparencës, paanshmërisë. Janë analizuar standardet evropiane që lidhen me transparencën dhe shpërndarjen e fondeve publike për reklamat shtetërore dhe kontratat për shërbime mediatike, në përputhje me nenin 25 të EMFA-s dhe perkufizimin 73 të saj, duke theksuar nevojën për procedura objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese, si dhe për publikimin periodik të të dhënave mbi shpenzimet publike në sektorin mediatik. Në nenin 22 të EMFA-s, strukturat e përfshira janë njohur me mekanizmat për kontrollin e përqendrimeve mediatike, duke vlerësuar rolin e autoritetit rregullator në shqyrtimin e bashkimeve, blerjeve dhe ndryshimeve të tjera strukturore në sektorin e medias nga këndvështrimi i pluralizmit mediatik dhe pavarësisë editoriale, në bashkëpunim institucional me Autoritetin e Konkurrencës.

Në tërësi, ky proces analitik dhe institucional ka shërbyer jo vetëm për identifikimin e nevojave për ndërhyrje ligjore dhe institucionale, por edhe për forcimin dhe konsolidimin e kapaciteteve administrative të Autoritetit, si dhe për vlerësimin e kapaciteteve ekzistuese në funksion të përputhjes me zhvillimet e reja rregullatore që burojnë nga legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e medias dhe shërbimeve digjitale.




# 9. TRANSMETIMET NUMERIKE

## 9.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital Dy (DD2)

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), si institucioni i ngarkuar me ligj për administrimin dhe menaxhimin e spektrit të frekuencave audio dhe audiovizive, është angazhuar aktivisht në procesin e lirimit të brezit të njohur si Dividenti i Dytë Digjital (DD2), i cili përfshin brezin e frekuencave 694–790 MHz (kanalet 49–60). Ky proces synon rialokimin e këtij brezi për përdorim nga shërbimet e komunikimeve mobile me brez të gjerë, përfshirë teknologjitë LTE dhe 5G.

Për lirimin e brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive dhe kalimin e frekuencave të Digjital Dividentit DY (DD2) në përdorim për rrjetet e komunikimeve elektronike të lëvizshme, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka ndjekur një sërë hapash për të përmbushur këtë tranzicion, duke përfshirë inventarizimin e rrjeteve numerike, koordinimin ndërkufitar dhe përditësimin e planifikimit të frekuencave. Planit të Ri Numerik UHF u realizua në bashkëpunim të ngushtë me shtetet fqinje për koordinimin e frekuencave. Ky plan synonte ruajtjen e 7 rrjeteve aktuale televizive në Shqipëri, duke e bërë vendin tonë të vetmin që me planin e ri të ndarjes së kanaleve televizive numerike ka arritur të ruajë dhe të konfirmojë përdorimin e 7 rrjeteve numerike.

Pas finalizimit me sukses të procesit të koordinimit ndërkufitar, plani përfundimtar u miratua nga AMA dhe u formalizua në ndarjen e re të kanaleve televizive numerike, e cila paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

| Rrjetet Numerike | AL 001D | AL 002D | AL 003D | AL 004D | AL 005D | AL 006D | AL 007D | AL 008D | AL 009D | AL 010D | AL 011D | AL 012D | Numri i kanaleve në total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| MUX 1 (RTSH) | 33 | 42 | 42 | 33 | 33 | 42 | 28 | 36 | 27 | 37 | 28 | na | 6 |
| MUX 2 (RTSH) | 34 | 40 | 40 | 34 | 34 | 40 | 27 | 22 | 28 | 38 | 27 | na | 6 |
| MUX 3 (KLAN) | 28 | 30 | 30 | 28 | 41 | 30 | 41 | 29 | 45 | 23 | 23 | na | 6 |
| MUX 4 (DIGITALB) | 21 | 36 | 38 | 21 | 21 | 45 | 31 | 48 | 48 | 48 | 31 | na | 5 |
| MUX 5 (TOP CHANNEL) | 22 | 32 | 32 | 24 | 39 | 47 | 39 | 47 | 47 | 47 | na | na | 6 |
| MUX 6 (MEDIA VIZION) | 45 | 45 | 45 | 45 | 43 | 43 | 43 | 43 | 43 | 43 | na | na | 6 |
| MUX 7 (ADTN) | 23 | 23 | 25 | 23 | 23 | 25 | 35 | 32 | 21 | 35 | na | na | 5 |
| Lokale | 41 | 26 | 27* | na | na | na | na | 34* | na | 42* | na | na | 26 |

Ky proces, përveç rëndësisë së tij për riorganizimin e brendshëm të spektrit, është gjithashtu një detyrim i përcaktuar nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikimeve (ITU) dhe një kërkesë e përsëritur në kuadër të takimeve të fundit të Grupit të Politikave të Spektrit Radio (RSPG), duke marrë shkas nga interferencat ndërkufitare dhe nevoja për përmbushjen e detyrimeve
ndërkombëtare. Gjithashtu, Bashkimi Evropian e ka bërë të qartë se zbatimi i vendimit të Parlamentit dhe Këshillit të BE për lirimin e brezit 700 MHz është një detyrim i qartë dhe lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e kritereve të kapitullit të transformimit digjital në procesin e anëtarësimit.

Bazuar në detyrimet që burojnë nga procesi i lirimit të frekuencave të Dividentit të Dytë Digjital (DD2), Autoriteti i Mediave Audiovizive ka realizuar komunikimeve zyrtare gjatë muajit gusht dhe shtator 2025 me OSHMA-të, ku është evidentuar se operatorët kanë paraqitur kërkesat e tyre për vlerësimin e kompensimit financiar. Ata kanë theksuar se vlerësimi i fundit teknik dhe ekonomik është kryer në vitin 2022 dhe, për pasojë, vlerat aktuale nuk pasqyrojnë realisht kostot e rritura të pajisjeve dhe të procesit të migrimit teknik.
Në datën 11 shtator 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) hodhi në konsultim publik projektligjin "Për lirimin e frekuencave të Dividentit të Dytë Digjital (DD2)". Në vijim të këtij procesi, më 25 shtator 2025, në ambientet e AMA-s u zhvillua një takim konsultues me përfaqësues të RTSH-së dhe operatorëve privatë kombëtarë, ku u diskutua gjerësisht projektligji dhe u analizuan ndikimet e mundshme të tij në aspektin teknik dhe financiar.
Gjatë këtij takimi, operatorët parashtruan një sërë propozimesh dhe kërkesash të argumentuara, të cilat kishin për qëllim përshtatjen e kornizës financiare dhe metodologjike të kompensimit me realitetin e tregut dhe me kostot aktuale të migrimit teknik. Në përfundim të diskutimeve, OSHMA-të dakordësuan se propozimet e tyre janë:

- Ndryshimi i monedhës së llogaritjes së kompensimit nga euro në lekë, duke u bazuar në kursin e dhjetorit 2022;
- Vlerësimi i kostove të pajisjeve në përputhje me çmimet reale të tregut;
- Përdorimi i fondit të kompensimit vetëm për operatorët privatë kombëtarë, me përjashtim të RTSH-së;
- Organizimi i një takimi të dytë me përfaqësues të Ministrisë për të thelluar diskutimet mbi metodologjinë e kompensimit dhe afatet e zbatimit.

Minutat e këtij takimi u përcollën pranë MIE-së me shkresën nr. 2286/2 prot., datë 26.09.2025 dhe në vijim, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me anë të shkresës me nr. 228/6 prot. datë 02.10.2025, i ka kërkuar Autoritetit të Mediave Audiovizive të përfundojë analizën dhe vlerësimin e impaktit në strategjinë e migrimit të DD2 dhe të kostove të procesit të kompensimit, si rezultat i ndryshimeve të ndodhura nga viti 2022 në rrjetet transmetuese të OSHMA-ve, mbi bazën e metodologjisë së propozuar nga konsulentët e BE-së.
Në vijim të procesit, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka kërkuar nga OSHMA-të kombëtare që të dërgojnë pranë AMA-s informacionin e përditësuar në lidhje me çdo ndryshim në konfigurimin teknik të infrastrukturës së rrjetit (shtim/pakësim stacionesh) të ndodhur pas vitit 2022, i cili mund të ndikojë në planin e migrimit dhe në procesin e kompensimit financiar.
Në muajin tetor 2025 OSHMA-të kanë kthyer përgjigje mbi ndryshimet e kryera, përmes shkresave përkatëse, ku kanë paraqitur ndryshimet e kryera në rrjet dhe investimet e realizuara që nga viti 2022, i cili shënon momentin e vlerësimit të fundit.
Me administrimin e informacionit, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka kontaktuar dhe komunikuar me ekspertin e grupit të kontraktuar në kuadër të projektit të Bashkimit Evropian "Mbi asistencën teknike në fushën e telekomunikacionit" ne vitin 2022 dhe e ka ftuar atë të kontribuojë në vlerësimin e përditësuar të ndikimit dhe në përcaktimin e kostove që lidhen me procesin e lirimit të brezit DD2.
Eksperti do të kryejë vlerësimin e ndryshimeve dhe impaktin e tyre gjate 3 viteve të fundit, duke shqyrtuar mundësinë për ri-përdorim ose përshtatje të pajisjeve ekzistuese transmetuese pas migrimit të frekuencës, mundësinë reale për të shitur ose riparuar pjesërisht pajisjet e zëvendësuara, si dhe relevancën e kostove standarde të fuqisë punëtore dhe vlerësimeve të ngarkesës së punës duke marrë parasysh praktikat aktuale të tregut. Qëllimi i këtij vlerësimi nuk është rimodelimi i metodologjisë së përdorur në vitin 2022, por sigurimi i përputhshmërisë së saj me realitetin e tregut dhe parametrat e përditësuar në vitin 2026.

Eksperti ka njohuritë dhe eksperiencën e duhur mbi metodologjinë e mëparshme të llogaritjes së kostove të migrimit, modelet e simulimit të mbulimit dhe analizat tekniko–financiare të rrjeteve ekzistuese. Duke pasur parasysh se, ka qenë ekspert i kontraktuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Asistencë Teknike për sektorin e telekomunikacionit", angazhimi i tij siguron që procesi të realizohet me të njëjtën metodologji, në mënyrë transparente dhe pa kontestime.
Meqënëse vlerësimet e mëparshme përbëjnë referencë zyrtare për projektligjin "Për lirimin e frekuencave të Dividentit të Dytë Digjital (DD2)", ekspertiza nga i njëjti ekspert ofron një analizë më të qëndrueshme. Duke marrë parasysh kompleksitetin e procesit të migrimit të brezit 700 MHz dhe rëndësinë e tij për zhvillimin teknologjik të vendit, angazhimi i të njëjtit ekspert për asistencë teknike, i mundësuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian për projektin "Asistencë Teknike për sektorin e telekomunikacionit", paraqitet si një domosdoshmëri strategjike për realizimin e një analize të besueshme dhe për të siguruar përputhje të plotë me rekomandimet ndërkombëtare.
Në përfundim, eksperti do të përgatisë dhe prezantojë rezultatet e përditësuara të vlerësimit të kostove pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive brenda muajit shkurt 2026, të cilat do të publikohen në Raportin e vitit tjetër.

**9.2. Administrimi dhe Planifikimi i spektrit të frekuencave**

Administrimi dhe planifikimi i spektrit të frekuencave përbëjnë një nga funksionet themelore të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), duke qenë se spektri i radiofrekuencave është një burim natyror i kufizuar dhe me rëndësi strategjike për ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë.




Në vitin 2025, në kuadër të përmirësimit të procesit të administrimit dhe planifikimit të spektrit, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm, duke implementuar me sukses përditësimin në versionin më të ri të Sistemit të Administrimit të Frekuencave, duke zëvendësuar versionin e mëparshëm të përdorur prej vitit 2016.
Ky sistem përbën një pjesë të rëndësishme të infrastrukturës së AMA-s, duke integruar teknologji të avancuara për menaxhimin e spektrit të frekuencave, për të siguruar një komunikim të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm në mjedisin e sotëm të rrjeteve të transmetimeve audio/audiovizive, veçanërisht në kontekstin e zhvillimeve të reja teknologjike dhe perspektivës së implementimit të radios digjitale në Shqipëri. Ky hap është shembull i një strategjie të qartë dhe të përgjegjshme për përmirësimin e administrimit të spektrit të frekuencave, duke përcaktuar një rruge të pastër drejt një përdorimi më efikas të burimeve të frekuencave audio/audiovizive në Shqipëri. Nëpërmjet këtij investimi, është ndërtuar një

platformë e avancuar që sjell shumë përparësi për AMA-n në administrimin dhe planifikimin e spektrit të frekuencave, duke përfshirë:

- Module të avancuara për planifikimin dhe simulimin e rrjeteve të radios digjitale DAB+, duke mundësuar analizën e mbulimit të multiplex-eve dhe optimizimin e konfigurimit të rrjeteve SFN (Single Frequency Network). Ky funksionalitet i mundëson AMA-s të realizojë planifikim më të saktë të rrjeteve të radios digjitale dhe të vlerësojë në mënyrë të besueshme skenarët e implementimit të teknologjisë DAB+ në territorin shqiptar;
- Krijimi dhe menaxhimi i databazave të stacioneve transmetuese, duke përfshirë parametrat teknikë të transmetimit (fuqia, frekuenca, koordinatat gjeografike, lartësia e antenës, diagrami i rrezatimit etj.). Mundëson një databazë të qëndrueshme dhe të arritshme për historikun e caktimeve frekuencore, duke përmirësuar transparencën dhe disponueshmërinë e të dhënave;
- Modele të përditësuara të përhapjes së sinjalit radio, në përputhje me rekomandimet më të fundit të ITU-R, duke rritur ndjeshëm saktësinë e analizave të mbulimit dhe garanton që planifikimi i frekuencave të realizohet në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Integrim i avancuar me sistemet gjeografike (GIS) për vizualizimin e mbulimit dhe analizën hapësinore të rrjeteve të transmetimit. Në këtë mënyrë, analizohet më qartë shpërndarja territoriale të sinjalit dhe të identifikojnë zonat me mbulim të pamjaftueshëm ose me mbivendosje sinjali;
- Mundësi të zgjeruara për analizën e interferencave dhe koordinimin ndërkombëtar të frekuencave, duke parandaluar ndërhyrjet e dëmshme ndërmjet transmetuesve dhe lehtëson proceset e koordinimit me administratat fqinje të spektrit.
- Optimizim të proceseve të simulimit dhe përpunimit të të dhënave, duke rritur ndjeshëm shpejtësinë dhe efikasitetin e analizave teknike. Si rezultat, AMA mund të realizojë analiza më të shpejta dhe më efikase gjatë procesit të planifikimit dhe administrimit të frekuencave.




*Ndërtimi i databazës me parametrat teknikë të rrjetit të operatorit OSHMA dhe implementimi i tyre në sistemin HTZ për qëllime analize dhe planifikimi të rrjetit të transmetimit.*




Simulimi i mbulimit të pikave transmetuese në territorin e Shqipërisë



Raporti mbi territorin e mbuluar sipas niveleve të sinjalit të percaktuara 52 dbu/60dbu/70dbu

### 9.2.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive

Bazuar në aktet ligjore e nënligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, brezi frekuencor, i përcaktuar për transmetime tokësore numerike DTT, është brezi UHF dhe VHF. Bazuar në Planin Kombëtar Numerik (PKN), banda UHF, aktualisht, është në përdorim nga operatorët audiovizivë, që mundësojnë transmetimet numerike në të gjithë territorin e vendit. Operatori publik shqiptar RTSH disponon frekuenca për dy rrjete numerike si dhe 5 operatorët privatë kombëtarë numerikë kanë në dispozicion frekuenca për 1 rrjet numerik secili prej tyre.

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka realizuar përgatitjen e të gjitha materialeve teknike që përmbajnë parametrat teknikë të secilës pikë transmetuese të rrjeteve të operatorëve të transmetimit audioviziv. Këto materiale përfshijnë të dhëna të detajuara mbi frekuencën e operimit, fuqinë e transmetimit, koordinatat gjeografike të vendndodhjes së stacioneve, lartësinë dhe karakteristikat e antenës, si dhe parametrat e tjerë teknikë të nevojshëm për identifikimin dhe analizën e rrjeteve të transmetimit.

Dokumentacioni teknik i përgatitur është strukturuar në përputhje me kërkesat dhe formatet e përcaktuara nga Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikimeve (ITU), me qëllim që këto të dhëna të mund të regjistrohen dhe publikohen përmes platformës TerraNotices. Në këtë mënyrë, frekuencat dhe karakteristikat teknike të rrjeteve transmetuese njoftohen zyrtarisht në ITU, sipas percaktimeve të Radio Rregulloreve të ITU-së (ITU-RR) duke garantuar transparencë ndërkombëtare, koordinim me administratat e tjera të spektrit dhe mbrojtjen e përdorimit të frekuencave të planifikuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Materialet e realizuara nga programi TerRaNotice*




### 9.2.2 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka vijuar procesin e administrimit dhe koordinimit të brezit FM (88–108 MHz), në funksion të garantimit të përdorimit efikas të spektrit të frekuencave dhe shmangies së ndërhyrjeve ndërkufitare. Në këtë kuadër, AMA ka vijuar proçesin e koordinimit me vendet nënshkruese të Marrëveshjes GE84 për transmetimet analoge audio FM, për evidentimin e hapësirave të optimizimit dhe shtimit të kapaciteteve transmetuese, ku ka administruar një sërë kërkesash për koordinim frekuencash, të cilat janë raportuar dhe trajtuar në platformën ndërkombëtare BRIFIC, në përputhje me procedurat dhe standardet e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve (ITU).
Kërkesat e administruara kanë përfshirë analiza teknike dhe studime të detajuara të përputhshmërisë radioelektrike, me qëllim vlerësimin e ndikimit të emetimeve FM në zonat kufitare dhe sigurimin e bashkëjetesës pa ndërhyrje të sistemeve të transmetimit. Në kuadër të këtyre studimeve, AMA ka zhvilluar bashkëpunim dhe shkëmbim teknik informacioni me administratat homologe të shteteve fqinje dhe rajonale, konkretisht me Greqinë, Maqedoninë e Veriut, Bosnje dhe Hercegovinën, si dhe Bullgarinë.
Nga Analiza për Okupimin e Brezave të Frekuencave FM për 12 qarqet ku AMA ka instaluar stacione fikse monitorimi, jepen Brezat me Okupim të Ulët (0-25%) të Mesëm (25-55%) dhe të Lartë (55-95%), si më poshtë:



AMA, gjatë vitit 2025, ka kryer studimet teknike me qëllim:
- Rinovimin e 6 licencave të subjekteve që ofrojnë transmetime audio analoge;
- Zgjerimin e zonës së licencimit të 1 subjekti të interesuar;
- Ndryshimin e karakteristikave teknike të transmetimit me qëllim mbulimin e plotë të zonës së licencimit.

Procesi i koordinimit ka përfshirë shqyrtimin e parametrave teknikë të transmetimit, si frekuenca, fuqia rrezatuese, vendndodhja e stacioneve transmetuese dhe karakteristikat e antenave, duke synuar respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe mbrojtjen e shërbimeve ekzistuese. Përmes këtij angazhimi, AMA ka kontribuar në ruajtjen e stabilitetit të spektrit FM, në rritjen e cilësisë së shërbimeve audio dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e administrimit të frekuencave radio.

### 9.2.3 Koordinimi i frekuencave të brezit audio dhe audioviziv

Koordinimi i frekuencave përbën një komponent thelbësor të administrimit të spektrit, me qëllim shmangien e interferencave të brendshme/ndërkufitare dhe garantimin e përdorimit të harmonizuar të frekuencave me administratat fqinje.

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka qenë pjesëmarrës aktiv në takimet e Nën-Grupit RSPG të zhvilluara më 15 janar 2025, 26 mars 2025, 12 maj 2025 dhe 18 shtator 2025, si dhe në takimet në kuadër të Marrëveshjes Rajonale Adriatike dhe Joniane për DAB, të mbajtura më 11 mars 2025, 8 prill 2025, 29 maj 2025, 4 korrik 2025, 26 shtator 2025 dhe 9 dhjetor 2025. Gjithashtu, më 25 mars 2025, AMA ka zhvilluar një takim bilateral me administratën italiane për diskutimin e parametrave teknikë të teknologjisë DAB.

Në kuadër të procesit të koordinimit të brezit III VHF për transmetimet audio/audiovizive digjitale (në teknologjinë DVB-T2 dhe T-DAB), me vendet që lagen nga ujërat e deteve Adriatik dhe Jon (Itali, Kroaci, Slloveni, Mal i Zi, Bosnje Hercegovinë, Greqi dhe Shqipëri), iniciuar nga administrata e Italisë, edhe gjatë vitit 2025 janë organizuar disa takime, me qëllim rialokimin dhe përdorimin e këtij brezi në mënyrë efikase, proporcionale dhe pa interferenca të dëmshme.

AMA është angazhuar në mënyrë aktive në diskutimet teknike dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe përditësimin e kësaj marrëveshjeje, ku janë reflektuar arritjet kryesore dhe përmirësimet e realizuara në aspektin e koordinimit rajonal për implementimin e radios digjitale DAB. Gjatë këtyre takimeve, krahas koordinimit të kanaleve digjitale është trajtuar gjithashtu rishikimi i tekstit të Marrëveshjes, si dhe përditësimi dhe harmonizimi i anekseve përkatëse teknike, me qëllim përshtatjen e tyre me zhvillimet më të fundit teknologjike dhe kërkesat aktuale të menaxhimit të spektrit.

Paralelisht, janë prezantuar dhe diskutuar edhe përmirësimet e realizuara në kuadër të Marrëveshjes DAB, në funksion të sigurimit të koherencës rregullatore dhe teknike ndërmjet proceseve të radios digjitale dhe politikave evropiane të spektrit.

Situata e DAB/DAB+ në Shqipëri gjatë vitit 2025 paraqet një progres të qëndrueshëm në drejtim të planifikimit spektral, zhvillimit të rrjeteve dhe harmonizimit ndërkombëtar të frekuencave.

Për sa më sipër, gjatë vitit 2025, AMA ka arritur:
- koordinimin teknik të kanaleve DAB me të gjitha shtetet fqinje;
- përfitimin e tre rrjeteve DAB, të strukturuara në 11 allotmente dhe 1 sub-allotment;
- kryerjen e detyrave specifike të frekuencave dhe harmonizimin e parametrave teknikë të transmetuesve, në përputhje me marrëveshjet rajonale Adriatiko-Joniane;
- dërgimin e parametrave teknikë për koordinim ndërkombëtar në nivel administrativ dhe teknik.

AMA ka nisur një projekt bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës, me qëllim projektimin e një sistemi monitorimi DAB për monitorim të vazhdueshëm të spektrit të frekuencave 174-240 MHz dhe kontroll të cilësisë së transmetimeve DAB.

Ndërsa, sa i takon takimeve të Nën-Grupit RSPG, AMA ka kontribuar në diskutimet mbi çështjet e aktiviteteve ndërkufitare me vendet jo-evropiane, duke raportuar progresin e realizuar për lirimin e brezit 700 MHz dhe ndikimin e tij në koordinimin ndërkombëtar të frekuencave.

Një çështje tjetër me rëndësi e trajtuar në kuadër të takimeve të Nën-Grupit RSPG lidhet me interferencat ndërkufitare të shkaktuara mes vendeve anëtare, ku janë reflektuar ankesa nga shtetet fqinje, përfshirë

Kroacinë, Italinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, si pasojë e moslirimit të plotë të brezit DD2. Në këtë kontekst, AMA është angazhuar aktivisht në adresimin dhe zgjidhjen e këtyre problematikave, duke ndërmarrë masa teknike konkrete si realizimi i migrimeve tranzitore, modifikimi i parametrave të transmetimit dhe rregullimi i drejtimeve të antenave, në bashkëpunim të ngushtë me Operatorët e Shërbimit të Medias Audiovizive (OSHMA).
Një nga problematikat kryesore të ngritura nga pala greke lidhur me interferencën në kanalin 41 (Ch.41), të cilat emetoheshin nga jugu i Shqipërisë, gjatë takimit të fundit të Nën-Grupit RSPG është zbardhur dhe konfirmuar si e zgjidhur nga ana e Shqipërisë.

**9.3 Monitorimi i spektrit të frekuencave**

Gjatë vitit 2025, Sektori i Monitorimit të Frekuencave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) ka ushtruar veprimtarinë e tij në mënyrë të vazhdueshme, të planifikuar dhe në përputhje me kompetencat ligjore, dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshjet dhe rekomandimet ndërkombëtare, veçanërisht ato të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve (ITU), me qëllim garantimin e përdorimit të rregullt, efikas dhe të ligjshëm të spektrit të frekuencave audio/audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë.
Monitorimet janë kryer si në terren, ashtu edhe përmes sistemit të qendërzuar të monitorimit, duke siguruar kontroll të plotë teknik të transmetimeve audio dhe audiovizive, duke garantuar kontroll të vazhdueshëm të parametrave teknikë të transmetimit dhe respektimin e kushteve të licencimit nga operatorët audiovizivë.

Veprimtaria monitoruese gjatë vitit 2025 është konceptuar në komponentët si më poshtë:
a) Monitorimi periodik i spektrit të frekuencave audio dhe audioviziv
b) Monitorimi i Spektrit Të Frekuencave Audio me anë të Sistemit Të Qendërzuar Të Monitorimit Të Frekuencave (SQMF)
c) Monitorimi i spektrit audioviziv në të gjithë territorin e vendit në kuadër të vlerësimit të mbulimit me sinjal nga transmetuesi publik RTSH
Për të gjitha monitorimet e realizuara gjatë vitit 2025 janë hartuar raporte teknike mujore të detajuara, të cilat përfshijnë rezultatet e matjeve, problematikat e konstatuara, rekomandimet teknike dhe dokumentacionin mbështetës për vendimmarrjet institucionale të AMA-s.

Gjatë vitit 2025, Sektori i Monitorimit të Frekuencave ka përmbushur me sukses të gjitha detyrimet e parashikuara në urdhrat përkatës, duke siguruar kontroll të vazhdueshëm të spektrit audio dhe audioviziv, dokumentim teknik të gjendjes së sinjalit në qarqet kryesore të vendit, identifikim dhe zgjidhje të shkeljeve dhe interferencave, si dhe raportim të standardizuar në mbështetje të vendimmarrjes së AMA-s.

a) Monitorimi periodik i spektrit të frekuencave audio dhe audioviziv
Monitorimi periodik i spektrit të frekuencave audio dhe audiovizive kryhet në baza mujore, sipas Urdhrit nr. 226, datë 18.07.2025, në pikat transmetuese kryesore në Republikën e Shqipërisë, me një komplet pajisjesh portative, në mënyrë që të kryejnë gjithë tipet e matjeve.

Qëllimi kryesor i monitorimit në terren është verifikimi i parametrave teknikë të transmetimit audio dhe audioviziv, identifikimi i ndërhyrjeve të mundshme në spektrin audioviziv dhe evidentimi i funksionimit të rrjeteve transmetuese në përputhje me kushtet e licencës.
Përdorimi i frekuencave duhet të jetë sipas përcaktimeve të Planit Kombëtar të Frekuencave dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të licencës dhe spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

*Pamje e pajisjeve të përdorura për monitorimin e spektrit të frekuencave*

Matës fushe




Antena Rohde&Schwarz 500 – 3000 MHz



Band Scanner GPS




Analizator spektri Anritsu MS 2712 E



Gjurmues interference dore (Anritsu 2700)



*Kullë transmetimi e OSHMA-ve*










*Matjet e kryera me matësin e fushës*




*Matje e kryera me Analizatorin e Spektrit*

Realizimi i monitorimeve për vitin 2025 është kryer në 24 pika transmetimi. Këto monitorime kanë pasur si qëllim verifikimin e përputhshmërisë së parametrave teknikë të transmetimit me kushtet e përcaktuara në licencat përkatëse të operatorëve. Gjatë procesit të kontrollit janë analizuar elementë teknikë si frekuenca e operimit, fuqia e transmetimit, karakteristikat e antenave dhe parametrat e tjerë të transmetimit që ndikojnë në funksionimin e rrjeteve të transmetimit dhe në përdorimin korrekt të spektrit të frekuencave.
Pas përfundimit të verifikimeve teknike dhe analizës së të dhënave të mbledhura nga monitorimet në terren, nuk janë konstatuar raste të operatorëve që të emetojnë transmetime në kundërshtim me kushtet teknike të përcaktuara në licencat përkatëse.

b) Monitorimi i spektrit të frekuencave audio me anë të Sistemit të Qendërzuar të Monitorimit të Frekuencave (SQMF).

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka vijuar realizimin e monitorimit në kohë reale të spektrit të frekuencave audio, duke përdorur sistemin e Qendërzuar të Monitorimit të Frekuencave (SQMF). Monitorimi kryhet përmes një infrastrukture të dedikuar prej 12 stacionesh fikse monitoruese të brezit Fm 88 Mhz -108 Mhz, të vendosura në bashkitë Shkodër, Kukës, Durrës, Fier, Berat, Gjirokastër, Korçë, Vlorë, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Librazhd, si dhe nga qendra qendrore e kontrollit në ambientet e AMA-s në Tiranë.
Sistemi i monitorimit, i cili funksionon pa ndërprerje dhe siguron mbledhjen e të dhënave në kohë reale, ka mundësuar gjatë vitit 2025 vlerësimin e cilësisë së transmetimeve audio, analizën e spektrit FM dhe evidentimin e çdo devijimi teknik apo shkeljeje të parametrave të licencimit.
Monitorimi i zhvilluar është realizuar në zbatim të Urdhrit nr. 227, datë 18.07.2025, i cili parashikon monitorimin e përditshëm të transmetimeve audio FM përmes sistemit të qendrës së monitorimit të frekuencave (SQMF) për 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë dhe ka si qëllim:

- Identifikimin e menjëhershëm të rasteve kur operatorët ndryshojnë frekuencat, pikat e transmetimit apo parametrat e tjerë teknikë pa dijeninë e AMA-s, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit dhe mbulimin e territorit.
- Identifikimin e menjëhershëm të sinjaleve të ardhura nga vendet fqinje drejt zonave kufitare të vendit tonë, të cilat duhen marrë në konsideratë gjatë planifikimit dhe ndryshimit të frekuencave për të shmangur interferencat e mundshme.
- Zbulimin e përdorimit të paligjshëm të spektrit audio FM nga persona të paautorizuar, duke siguruar ruajtjen e konkurrencës së ndershme në treg.
- Zgjidhjen më të shpejtë të problematikave si interferenca të dëmshme apo ndërprerje të shërbimit audio në zona të caktuara.
- Reduktimin e monitorimeve periodike në terren dhe mundësimin e monitorimeve më të detajuara e specifike.
- Lehtësimin e procedurave për përcaktimin e frekuencave për operatorët audio, pa qenë e nevojshme monitorimi fizik rast pas rasti.



*Paraqitja grafike e analizës së spektrit në brezin FM (87–108 MHz) përmes sistemit të monitorimit*



Realizimi i monitorimeve për vitin 2025 është kryer në 12 qarqe dhe pas verifikimeve përfundimtare, nuk janë konstatuar operatorë audio të cilët emetojnë transmetime jo në përputhje me kushtet teknike të licencës.

c) Monitorimi i spektrit audioviziv në të gjithë teritorin e vendit në kuadër të vlerësimit të mbulimit me sinjal nga transmetuesi publik RTSH

Monitorimi i mbulimit të sinjalit audioviziv të Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) është kryer gjatë periudhës Gusht–Dhjetor 2025, në përputhje me kontratën e shërbimit të transmetuesit publik, të miratuar me vendimin e AMA-s nr. 88, datë 21.10.2025.

Monitorimi i spektrit audioviziv në të gjithë territorin e vendit, në kuadër të vlerësimit të mbulimit me sinjal nga transmetuesi publik RTSH ne Zbatim i Urdhrit nr. 239, datë 13.08.2025.

Matjet kishin për qëllim vlerësimin e mbulimit real të sinjalit publik audioviziv, identifikimin e zonave me mbulim të dobët ose të munguar dhe formulimin e propozimeve teknike për përmirësimin e cilësisë së sinjalit.

*Parametrat e shërbimit të transmetimit DVB-T2 të RTSH të analizuar me analizues transmetimi (transport stream analyzer)*



Monitorimi i mbulimit të sinjalit audioviziv të RTSH-së është realizuar në mënyrë të planifikuar ne 4 qarqe dhe nga rezultatet e matjeve është konstatuar se transmetimet e RTSH mungojnë në Pikën transmetuese Kodër-Marinë, Arapaj dhe Qarku Kukës.

Referuar rëndësisë publike të shërbimit të ofruar nga RTSH dhe detyrimeve që rrjedhin nga licencimi për mbulimin e territorit, është njoftuar RTSH për marjen e masave të nevojshme për rikthimin sa më parë të sinjalit të transmetimit në këto zona.

### 9.4 Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizivë

Interferencat e shkaktuara nga transmetimet FM në brezin e navigacionit ajror (108-137 Mhz)

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka trajtuar ankesën e pranuar nga Mali i Zi (EKIP) lidhur me ndërhyrje në frekuencën 123.7 MHz, e cila bën pjesë në brezin aeronautik 108–137 MHz. Pas një verifikimi të detajuar teknik, u konstatua se ndërhyrja vinte nga Radio Shqip. AMA ndërmori masat e nevojshme për rregullimin e parametrave të transmetimit. Si rezultat, ndërhyrja u eliminua plotësisht, duke siguruar që frekuenca të funksionojë sipas standardeve ndërkombëtare dhe pa ndërprerje për shërbimet e aeronautikës.

Në një rast tjetër, Autoriteti ka marrë një ankesë nga Kroacia (HACOM) për frekuencën 108.8 MHz, ku ndërhyrja shkaktohej nga Radio Club FM. AMA ka kryer analizën e rastit dhe ka ndërhyrë drejtpërdrejt për të korrigjuar parametrat teknikë të transmetuesit. Falë këtyre veprimeve, problematika u zgjidh shpejt dhe frekuenca u normalizua, duke ruajtur bashkëpunimin teknik ndërkufitar dhe stabilitetin e spektrit FM në rajon.

| Administrata | Brezi | Frekuenca | Subjekti | Statusi |
|---|---|---|---|---|
| **EKIP – Mali i Zi** | 108–137 MHz | 123.7 MHz | Radio Shqip | Zgjidhur |
| **HACOM – Kroaci** | 88–108 MHz | 108.8 MHz | Club FM | Zgjidhur |




*Spektri i sinjalit të transmetuesit FM i matur me analizues spektri, që paraqet shpërndarjen e fuqisë në frekuencë dhe rënien e komponentëve jashtë brezit të transmetimit*



Për sa më sipër, masat e marra kanë konsistuar në analizë teknike, verifikim në terren dhe vendosje të parametrave të transmetimit brenda kufijve të lejuar, duke shmangur interferencat e dëmshme dhe duke garantuar respektimin e detyrimeve ndërkombëtare për përdorimin e harmonizuar të spektrit frekuencor.
Interferenca shkaktuar drejt vendeve të tjera ne brezin UHF (700 Mhz)
Referuar interferencave në transmetimet audiovizive gjatë vitit 2025, AMA ka administruar ankesën e rregullatorit Malazes, Grek, Maqedonas, Kroat dhe Italian të cilat identifikojnë nivele shumë të larta sinjali në territoret e tyre respektive të emetuara nga transmetuesit tanë audioviziv dhe ku kërkohet lirimi në një kohë sa më të shpejt të brezit 700 MHz nga transmetimet audiovizive, pasi po pengojnë operimin e transmetimeve të lëvizshme 5G me vendet përkatëse.
AMA ka arritur të zgjidhë disa nga këto ankesa përmes migrimeve tranzitore provizore, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e spektrit frekuencor në dispozicion. Megjithatë, në kushtet aktuale, nuk është e mundur të implementohen skenarë të tjerë teknikë provizorë për eliminimin e interferencave me shtetet fqinje. AMA është në përpjekje të vazhdueshme për të zbatuar të gjitha rregullimet teknike të mundshme që mund të realizohen, me qëllim minimizimin sa më të madh të ndërhyrjeve dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të frekuencave, brenda kufijve të kapaciteteve të spektrit në dispozicion.
Interferencat e shkaktuara brenda vendit
Gjatë vitit 2025, AMA nuk ka administruar asnjë ankesë lidhur me interferencat e shkaktuara brenda vendit.
Interferencat e shkaktuara nga transmetimet audiovizive në brezin LTE 800
Nuk janë administruar ankesa nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.

**9.5 Sektori TIK**
Gjatë vitit 2025, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me misionin rregullator të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), duke garantuar funksionimin e pandërprerë të infrastrukturës teknologjike dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të proceseve monitoruese, rregullatore dhe administrative të institucionit.
Veprimtaria e sektorit është fokusuar në sigurimin e stabilitetit operacional, mbrojtjen e informacionit dhe ofrimin e mbështetjes teknike të specializuar, në një kontekst ku infrastruktura teknologjike përbën një element thelbësor për ushtrimin efektiv të kompetencave ligjore, mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse të AMA-s.




Grafiku paraqet në mënyrë përmbledhëse fushat kryesore të veprimtarisë së Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në mbështetje të funksioneve rregullatore të AMA-s gjatë vitit 2025. Përqindjet kanë karakter orientues dhe pasqyrojnë shpërndarjen relative të angazhimit të sektorit ndërmjet mbështetjes së monitorimit audioviziv, sigurisë kibernetike, proceseve të licencimit/mbikëqyrjes së OSHMA-ve dhe administrimit të infrastrukturës IT. Paraqitja vizuale synon të evidentojë balancën funksionale të veprimtarisë së Sektorit TIK dhe rolin e tij ndërsektorial në ushtrimin e kompetencave të AMA-s.

Grafiku paraqet në mënyrë përmbledhëse fushat kryesore të veprimtarisë së Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në mbështetje të funksioneve rregullatore të AMA-s gjatë vitit 2025. Përqindjet kanë karakter orientues dhe pasqyrojnë shpërndarjen relative të angazhimit të sektorit ndërmjet mbështetjes së monitorimit audioviziv, sigurisë kibernetike, proceseve të licencimit/mbikëqyrjes së OSHMA-ve dhe administrimit të infrastrukturës IT. Paraqitja vizuale synon të evidentojë balancën funksionale të veprimtarisë së Sektorit TIK dhe rolin e tij ndërsektorial në ushtrimin e kompetencave të AMA-s.

### 9.5.1 Funksionimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës teknologjike

Gjatë gjithë vitit raportues, Sektori TIK ka garantuar funksionimin normal dhe të qëndrueshëm të:
- pajisjeve kompjuterike dhe serverëve institucionalë;
- rrjeteve të komunikimit dhe lidhjeve të dedikuara të të dhënave;
- sistemeve mbështetëse të monitorimit audio dhe audioviziv;
- platformave administrative dhe databazave institucionale.

Shërbimet IT janë ofruar në mënyrë të vazhdueshme, duke garantuar funksionimin 24/7 të infrastrukturës kritike dhe duke shmangur ndërprerje operative që mund të cenonin proceset e monitorimit, arkivimit dhe analizës teknike të transmetimeve audiovizive.

Mbështetja teknike për stafin e AMA-s është realizuar në mënyrë të përditshme, duke adresuar nevojat që lidhen me përdorimin e pajisjeve IT, komunikimin elektronik, administrimin e informacionit dhe përpunimin e dokumentacionit zyrtar.

### 9.5.2 Mbështetja teknologjike e proceseve të monitorimit audioviziv

Një fokus i veçantë gjatë vitit 2025 ka qenë mbështetja teknologjike e proceseve të monitorimit audioviziv, të cilat përbëjnë një funksion themelor të AMA-s.

Pajisjet elektronike dhe sistemet ndihmëse të përdorura për regjistrimin, analizimin dhe verifikimin e transmetimeve audio dhe audiovizive kanë funksionuar në mënyrë të qëndrueshme, duke garantuar:
- ruajtjen e materialeve me vlerë prove ligjore;
- integritetin dhe autenticitetin e regjistrimeve;
- aksesueshmërinë e të dhënave për qëllime verifikimi, hetimi administrativ dhe vendimmarrjeje.

Kapacitetet e ruajtjes së të dhënave janë administruar në mënyrë të tillë që të përballojnë volumin e konsiderueshëm të regjistrimeve të krijuara gjatë monitorimeve, veçanërisht për monitorime përmbajtjesh, procese zgjedhore dhe verifikime teknike të zhvilluara në territor.

### 9.5.3 Siguria e informacionit dhe mbrojtja kibernetike

Gjatë vitit 2025, Sektori TIK ka ndërmarrë një proces të strukturuar për hartimin, formalizimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë së informacionit dhe infrastrukturës teknologjike në AMA, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë kibernetike.

Në këtë kuadër, janë hartuar dhe propozuar për miratim politika të unifikuara sigurie, të cilat përfshijnë masa teknike dhe organizative për:
- menaxhimin e fjalëkalimeve dhe kredencialeve të aksesit;
- kontrollin e aksesit fizik dhe logjik në sisteme;
- sigurinë e komunikimit elektronik;
- mbrojtjen ndaj kodeve të dëmshme dhe sulmeve kibernetike;
- përdorimin e sigurt të internetit dhe aseteve IT;
- menaxhimin dhe raportimin e incidenteve të sigurisë.

Zbatimi i këtyre politikave ka kontribuar drejtpërdrejt në garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit institucional, si dhe në forcimin e qëndrueshmërisë së infrastrukturës teknologjike ndaj rreziqeve operative dhe kibernetike.

### 9.5.4 Mbështetja teknike e proceseve rregullatore dhe të licencimit

Sektori TIK ka luajtur një rol kyç në mbështetjen teknike të proceseve të licencimit, autorizimit, regjistrimit dhe mbikëqyrjes së ofruesve të shërbimeve të mediave audiovizive (OSHMA).

Gjatë vitit 2025, sektori ka realizuar vlerësime teknike të dosjeve të aplikimit për subjekte që ofrojnë shërbime:

- **Dhënie autorizime:**

14 subjekte (8 subjekte për përsëritjen e shërbimit të programit dhe 6 subjekte për ofrimin e shërbimit të programit audoviziv)

- **Rinovime autorizimi:**

23 subjekte (15 subjekte për përsëritjen e shërbimit të programit dhe 8 subjekte për ofrimin e shërbimit të programit audoviziv)

- **Zgjerim dhe reduktim/zvogëlim i zonës së ofrimit shërbimeve licencë/autorizim:**

5 subjekte (3 subjekte për përsëritjen e shërbimit të programit zgjerim dhe 2 subjekte për përsëritjen e shërbimit të programit audoviziv zvogëlim zone)




Grafiku paraqet strukturën e tregut audioviziv në Shqipëri gjatë vitit 2025, duke evidentuar dominimin e shërbimeve digjitale (OTT/IPTV/VOD) në raport me shërbimet tradicionale kabllore. Kjo strukturë justifikon rolin qendror të Sektorit TIK në vlerësimin teknik, monitorimin dhe mbikëqyrjen e platformave digjitale, si dhe në garantimin e sigurisë dhe funksionimit të qëndrueshëm të tregut audioviziv.
Vlerësimi teknik është përqendruar në verifikimin e përputhshmërisë së pajisjeve dhe infrastrukturës së deklaruar me kërkesat rregullatore në fuqi, analizimin e arkitekturës së shpërndarjes së sinjalit, kontrollin e parametrave teknikë të transmetimit dhe vlerësimin e masave të sigurisë teknike dhe monitorimit.
Në rastet kur janë konstatuar mangësi apo paqartësi, janë kërkuar plotësime dhe sqarime teknike, ndërsa për raste të veçanta janë kryer edhe verifikime teknike në terren. Të gjitha veprimet janë dokumentuar në raporte dhe shënime teknike, të cilat kanë shërbyer si bazë për vijimin e procedurave administrative dhe vendimmarrëse.
Veprimtaria e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit gjatë vitit 2025 ka garantuar mbështetjen e plotë teknike të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe ushtrimin pa ndërprerje të funksioneve të tij rregullatore dhe mbikëqyrëse.
Puna e kryer ka krijuar një bazë të qëndrueshme teknologjike për zhvillimet e ardhshme, duke kontribuar në forcimin e mekanizmave të monitorimit, rritjen e sigurisë së informacionit dhe përgatitjen e institucionit për sfidat teknike dhe rregullatore të vitit 2026.



# 10. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Në vijim të informacionit të përcjellë në Raportin Vjetor të AMA-së për vitin 2024 mbi programin e auditimit me nr. 896/2 prot., datë 03.11.2022, të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), gjatë vitit 2023, me objekt "Mbi auditimin Financiar dhe të përputhshmërisë", programit të auditimit me nr. 900/1 prot, datë 11.10.2023 me objekt: "Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH për auditimin e evaduar në 6 - mujorin e parë të vitit 2023", KLSH kreu procedurën përkatëse të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe në datën 29.12.2023, përcolli pranë AMA-s Raportin përfundimtar, ku nënvizon opinionin se: nga 46 rekomandime, niveli i zbatimit është:

- 30 rekomandime janë zbatuar plotësisht;
- 15 rekomandime janë në proces zbatimi
- 1 rekomandim i pa zbatuar.

Përgjatë vitit 2025 AMA ka vijuar me marrjen e masave për zbatueshmërinë e rekomandimeve në proces, duke qënë në fokus të aktivitetit të Autoritetit, ndërkohë që lidhur me rekomandimin e pa zbatuar, AMA me shkresën nr. 3226/5 prot.,datë 20.12.2023 ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH) mbi qëndrimin e institucionit për rekomandimin dhe kërkimit për rivlerësim të rekomandimit.
Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1479 prot., datë 12.12.2024 "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e performancës të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2023", KLSH nëpërmjet Akt Verifikimit nr. 3 kërkoi nga AMA zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Në përgjigje të Akt-Verifikimit nr. 3, datë 16.01.2025 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Departamenti i Auditimit të Performancës, administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), me nr. 230 prot., datë 16.01.2025, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Garantimi i mbrojtjes së të drejtës së autorit", AMA me shkresën nr. 230/5 prot.,datë 20.05.2025 drejtuar KLSH ka pranuar rekomandimet dhe ka marrë masat e mëposhtme:

1. Autoriteti i Mediave Audiovizive do të bashkëpunojë me Ministrinë e Kulturës si Ministria përgjegjëse, ISHMT për të ndërmarrë inciativa ligjore lidhur me "shmangien e mbivendosjes së kompetencave sipas fushave të përgjegjësisë", në përputhje me përcaktimet ligjore të Ligjit 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Lidhur me rekomandimin mbi memorandumet e bashkëpunimit me institucionet në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit, ISHMT dhe AMA kanë rënë dakort dhe palët kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit midis dy institucioneve lidhur me garantimin e mbrojtjes të së drejtës së autorit me nr. 937/1 prot, datë 19.03.2025.



# 11. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL

## 11.1 Organizimi i brendshëm i institucionit

**Organizimi i brendshëm i institucionit**

Në zbatim të Planit Strategjik të Veprimit 2024–2026 të AMA-s, miratuar me vendimin nr. 18, datë 26.02.2024, të anëtarëve të AMA-s, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivë-Protokoll ka orientuar veprimtarinë e saj drejt forcimit të kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të funksionimit të brendshëm të institucionit. Në këtë kuadër, fokusi kryesor i punës ka qenë menaxhimi efikas i burimeve njerëzore, si dhe zhvillimi profesional i nëpunësve ekzistues dhe i punonjësve të rekrutuar rishtazi.
Në kuadër të përmirësimit të organizimit të brendshëm, është vijuar me forcimin e koordinimit ndërmjet njësive organizative, duke synuar rritjen e efikasitetit në komunikim, qartësimin e përgjegjësive dhe respektimin e afateve procedurale. Ky bashkëpunim ka ndikuar në përmbushjen më të mirë të detyrave funksionale dhe në garantimin e një veprimtarie administrative të qëndrueshme dhe të harmonizuar. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivë-Protokoll ka luajtur një rol mbështetës dhe koordinues në organizimin e brendshëm të institucionit, duke garantuar administrimin korrekt të dokumentacionit, respektimin e kuadrit ligjor në marrëdhëniet e punës dhe funksionimin normal të proceseve administrative.

Në funksion të forcimit të etikës profesionale dhe rritjes së integritetit në ushtrimin e detyrave administrative, institucioni ka zbatuar në mënyrë të vazhdueshme udhëzimet, manualet dhe materialet orientuese të hartuara nga Departamenti i Administratës Publike (DAP). Këto dokumente kanë shërbyer si bazë për informimin dhe orientimin e punonjësve mbi standardet e sjelljes, parimet e etikës në administratën publike, konfliktin e interesit, transparencën dhe përgjegjshmërinë në punë. Nëpërmjet kësaj qasjeje, është synuar konsolidimi i një kulture institucionale të mbështetur në profesionalizëm, korrektësi dhe respektim të rregullave të administratës publike.

Në lidhje me pozicionet e parashikuara në strukturën aktuale të miratuar me vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 86/2022 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)", për të cilat marrëdhëniet juridike dhe financiare të punës rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, gjatë periudhës raportuese janë lidhur gjithsej 4 kontrata pune për plotësimin e pozicioneve vakante të strukturës.

Në muajin shkurt 2025, AMA, në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit të AMA-s nr. 30, datë 16.04.2015, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 86/2022 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)", si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në R.SH", i ndryshuar, në përfundim të mandatit të Kryetarit dhe Anëtarëve të Këshillit të Anëtarëve, bëri publikimin zyrtar të shpalljeve të pozicioneve vakante, Kryetar dhe Anëtar i Këshillit të Ankesave. Thirrja për aplikim për vend të lirë pune për Kryetar dhe Anëtar të Këshillit të Ankesave u publikua në faqen elektronike zyrtare të AMA-s.
Në përfundim të afatit 30-ditor të shpalljes publike, me vendimin e anëtarëve të AMA-s, nr. 25, datë 03.04.2025, u zgjodh Kryetari i Këshillit të Ankesave, ndërsa me vendimin nr. 26, datë 03.04.2025, të anëtarëve të AMA-s, u zgjodhën dy anëtarë e tij.
Po ashtu, procesi i plotësimit të vendeve vakante në strukturë për nëpunësit civil ka vijuar edhe gjatë vitit 2025, duke hartuar planin vjetor të rekrutimit dhe duke përfshirë të gjitha fazat ligjore për çdo pozicion të shpallur.
Gjithësej, gjatë vitit 2025 janë realizuar 8 rekrutime për pozicionet respektive vakante, nëpërmjet procedurave ligjore deri në nxjerrjen e urdhrave të emërimit rast pas rasti. Aktualisht, janë vakante sipas strukturës 3 pozicione pune, të cilat janë pjesë e pozicioneve të punës në shërbimin civil, nëpunës të nivelit ekzekutiv (3 specialistë).
Sa i përket plotësimit të vendeve vakante me nëpunës civil gjatë vitit 2025, nga 8 nëpunës civilë të emëruar gjithsej:

- 1 është nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues (me procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil);
- 3 nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues (nëpunës me procedurën e ngritjes në detyrë);
- 4 nëpunës të nivelit ekzekutiv (1 nëpunës me procedurën e lëvizjes paralele dhe 3 nëpunës me procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil).

### 11.2 Programi i transparencës

Autoriteti i Mediave Audiovizive e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe si një institucion i pavarur publik, sigurohet që të jetë transparent ndaj publikut, duke zbatuar dispozitat që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.
Programi i transparencës, i cili është publikuar në faqen zyrtare të institucionit, është hartuar sipas modelit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe është i ndarë në disa nënkategori. Në të përfshihen, korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit, në kuadër të ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AMA-n, informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AMA-s, informacion për procedurat e prokurimit/ procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, shërbimet që ofrohen nga AMA, procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve, informacione/ dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AMA etj.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Autoritetit, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare https://ama.gov.al/. Në përmbajtje të programit të transparencës, evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menu-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet, me linkun përkatës. Përveç kësaj, çdo dokument i bërë publik është përditësuar në formë e përmbajtje.

Faqja zyrtare e AMA-s është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve, gjë e cila mbikëqyret dhe nga nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, i caktuar nga institucioni si person përgjegjës.

AMA ka ndjekur standardin e tërheqjes së mendimeve, sugjerimeve dhe propozimeve nga ana e grupeve të interesit, duke zbatuar me rigorozitet proceset e konsultimit dhe këshillimit publik, prej të cilave përmirëson projektet e paraqitura në faqen zyrtare të AMA-s. Gjithashtu Autoriteti publikon "Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve", i cili pasqyron të gjitha kërkesat për informacion, që kanë mbërritur në institucion dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 1 (një) muaj dhe publikohet në faqen e internetit të Autoritetit. Gjatë vitit 2025, pranë AMA-s kanë mbërritur rreth 40 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar sipas standardit të rregulluar nga ligji nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar.

- **Kategorizimi i kërkesave sipas tematikave është si më poshtë:**

► Kërkesa për informacion lidhur me përmbajtjet në platformat e mediave online: 6 kërkesa
► Kërkesa për informacion lidhur me trajtimin dhe masat e marra për përmbajtjet e dëmshme, gjuhën e urrejtjes, shkelje të Kodit të Transmetimit në transmetimet audiovizive: 6 kërkesa
► Kërkesa për informacion lidhur me procedurat e marrjes së licencës/autorizimeve nga AMA, apo procedurave të tjera lidhur me licencat/autorizimet (rinovim, ndryshim emri, kalimin e të drejtave, etj.): 11 kërkesa
► Kërkesa për informacion lidhur me procesin e monitorimit të fushatës zgjedhore: 2 kërkesa
► Kërkesa për informacion lidhur me frekuencat: 3 kërkesa
► Kërkesa për informacion të tjera, lidhur me çështje të ndryshme: 12 kërkesa

- **Katogorizimi i kërkesave sipas subjekteve paraqitet si më poshtë:**




Në shërbim të publikut dhe përmirësimit të procedurave administrative, pjesë e transparencës janë dhe formularët digjitalë për ankesa/aplikime, duke mundësuar thjeshtimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut. Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së rregullatorit, ndikon në fuqizimin e besueshmërisë së qytetarëve.

Lehtësimi i barrës burokratike, nëpërmjet komunikimit me publikun apo dhe me subjektet që Autoriteti licencon/autorizon, është një nga synimet kryesore të institucionit, kjo dhe falë postës elektronike të AMA-s, info@ama.gov.al. Gjithashtu, duke qenë se rrjetet sociale Facebook dhe Instagram janë në përdorim nga shumë qytetarë, AMA ka në këto rrjete adresat e saj zyrtare, gjë e cila ka rritur interaktivitetin me qytetarët|

dhe është parë si mënyrë efikase për të arritur qëllimet në rrugë më të shpejtë dhe më pak burokratike.

AMA ka publikuar një bazë të dhënash me informacion rreth operatorëve audio dhe audiovizivë në Republikën e Shqipërisë, e cila gjendet në rubrikën OSHMA, në faqen WEB të saj. Në të përfshihen të dhënat e të gjithë OSHMA-ve që AMA ka autorizuar/licencuar, të përmbledhura në një format, i cili është lehtësisht më i përdorshëm nga qytetarët apo grupet e interesit.

Një objektiv i arritur i Autoritetit të Mediave Audiovizive përgjatë vitit 2025 është edhe publikimi i një baze digjitale të dhënash mbi strukturën e pronësisë së OSHMA-ve të autorizuar/licencuar nga AMA. Kjo bazë të dhënash është lehtësisht e gjendshme dhe e mundshme për përdorim nga çdo i interesuar, pasi ndërtimi dhe struktura e informacionit të publikuar është realizuar në mënyrë të tillë që të jetë e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë. Ky informacion gjendet në faqen WEB të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në rubrikën "Transparenca e Pronësisë së Medias".

Mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive janë të hapura për takimet me qytetarët që kanë ankesa/pyetje apo për subjektet që kanë paqartësi në procesin e plotësimit të dokumenteve, vështirësi në fazat e aplikimit apo pyetje rreth procesit të marrjes/rinovimit të licencës. Drejtoritë e Autoritetit, të udhëhequra kryesisht nga drejtorët, zhvillojnë takime ballë për ballë, në sallën e pritjes, duke vendosur në shërbim të subjekteve apo qytetarëve informacionin e nevojshëm, duke shmangur procesin burokratik, që mund të krijohet nëpërmjet komunikimit shkresor. Po ashtu, në vijim të komunikimit dhe transparencës mes subjekteve/qytetarëve dhe Autoritetit, në faqen zyrtare të AMA-s, krahas email-it zyrtar janë të publikuara dhe email-et e drejtuesve të secilës drejtori.
Nëpërmjet hyrjes në fuqi të ndryshimeve më të fundit në ligjin nr. 97/2013, datë 19.03.2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të cilat u realizuan kryesisht me qëllim përafrimin e legjislacionit të brendshëm në fushën e mediave audiovizive me Direktivën e BE 2018/1808 (Direktiva e Shërbimeve Mediatike Audiovizive), janë përforcuar detyrimet e institucionit për të mundësuar aksesin sa më të përshtatshëm në informacion për kategoritë e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK).
Përcaktimi i një personi kontakti në faqen zyrtare për dhënien e informacionit dhe marrjen e ankesave, lehtësisht të arritshme nga Personat me Aftësi të Kufizuara në shikim e dëgjim, ndihmojnë në përmbushjen e objektivave të AMA-s, të dala në zbatim të ligjit organik për mediat audiovizive, si dhe të praktikave më të mira të së drejtës së BE-së, mbi të drejtën e qasjes në informacion nga komunitete me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë, që e bën të pamundur gëzimin e së drejtës së informimit.

Së dyti, sa i takon elementëve të aksesueshmërisë për Personat me Aftësi të Kufizuar, analizuar në një kornizë më të gjerë, Plani Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK 2021–2025), i miratuar me VKM - në nr. 276, datë 12.05.2021, përfshin në objektivin e tij specifik nr. 3: "realizimin e aksesueshmërisë në informimin dhe në komunikim për personat me aftësi të kufizuar", konkretisht aksesueshmërinë e kësaj kategorie në faqet e internetit. Qëllimi i aksesueshmërisë në internet është heqja e barrierave ndaj personave me aftësi të kufizuara në përdorimin e faqeve të internetit.

- Individët që janë të verbër ose me shikim të reduktuar, kërkojnë që faqet e internetit të shoqëruara me lexues të ekranit, të cilët lexojnë tekstin me zë të lartë; ofrojnë tekste alternative për imazhet dhe përshkruajnë imazhet; lejojnë ndryshimin e madhësisë së tekstit, imazheve dhe faqosjet e faqeve dhe sigurojnë mjete alternative të lundrimit në internet;
- Personat që nuk dëgjojnë apo kanë vështirësi dëgjimi, do të kërkojnë titra për çdo përmbajtje, përfshirë dhe video, multi - player, aplikacione;
- Personat me aftësi të kufizuara në lëvizje, mund të kërkojnë kohë shtesë për të lundruar në internet.

Masat e parashikuara synojnë përmirësime të kuadrit ligjor ekzistues, duke përfshirë zhvillimin/adaptimin e standardeve të sigurimit të qasjes në internet, për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses në baza të barabarta me të tjerët në faqet e internetit të sektorit publik, shërbimet, aplikacionet dhe përmbajtjen e tyre.

## 11.3 Aktivitete të Autoritetit

Gjatë vitit 2025 AMA ka vijuar aktivitetet e saj me grupet e interesit, në lidhje me çështje të rëndësishme, që prekin median audiovizive. Në kuadër të proceseve të ndryshimeve në rregulloret e AMA-s, përafrimit të legjislacionit të brendshëm me asquis e BE-së, intensifikimit të bashkëpunimit me partnerët dhe rregullatorët e vendeve të rajonit dhe më gjerë, bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe çështjeve të tjera me rëndësi, AMA ka kryer një sërë veprimtarish e takimesh si:

- AMA iniciuese dhe pjesëmarrëse në takimet me fokus Dezinformimin, Edukimin Mediatik, gjuhën e urrejtjes etj.

Viti 2025 ka qenë për AMA-n një vit me fokus të shtuar në sfida, me të cilat përballet në mënyrë të vazhdueshme mjedisi mediatik, ndër të cilat përmenden Dezinformimi, Edukimi Mediatik, gjuhën e urrjetjes, luftën kundër piraterisë së transmetimeve audiovizive, raportimi me perspektivë gjinore, etj. Përgjatë gjithë vitit 2025, AMA është angazhuar, herë si organizues dhe herë si pjesëmarrës në takime me grupet e interesit, organizata të shoqërisë civile, përfaqësi të misioneve të ndryshme ndërkombëtare si UNESCO, OSCE/ODIHR, Këshilli i Europës, etj., të cilat kanë patur në fokus pikërisht këto problematika. Këtu vlen të përmendet mbështetja e AMA-s për organizata të shoqërisë civile, si "Qendra Faktoje", për trajnimin e gazetarëve me temë:"Dezinformimi në kohë lufte dhe konflikti." Në kuadër të këtij bashkëpunimi u organizuan 4 tryeza me profesionistë të medias në Tiranë, një në Elbasan dhe një në Durrës dhe me pjesëmarrjen e 67 profesionistëve të medias. Trajnimi u ofroi atyre informacion të përgjithshëm mbi Dezinformimin, si funksionon dhe si ta trajtojnë atë. Duke u përqendruar në shembuj konkretë të përhapjes së Dezinformimit, u analizuan narrativat mashtruese dhe mënyrat e përhapjes së Dezinformimit, metodat dhe mjetet që gazetarët mund të përdorin për të verifikuar përmbajtjen, dhe gjithashtu u zhvilluan diskutime interavtive me detyra, për të testuar këto mjete gjatë trajnimeve. Të dhënat e mbledhura gjatë dhe pas trajnimeve u përdorën për të krijuar një dokument politikash me gjetje dhe rekomandime konkrete se si të ndërtohet qëndrueshmëria e medias në Shqipëri. Këto përfundime u prezantuan në një tryezë të përbashkët, organizuar nga AMA dhe Qendra "Faktoje", me 22 maj 2025, dhe ku merrnin pjesë përfaqësues nga Kuvendi i Shqipërisë, shoqëria civile, gazetarë, studiues etj. Bazuar në gjetjet e këtij studimi u dhanë edhe katër rekomandime strategjike: Futja e Njohurive Mediatike në të gjitha nivelet e arsimit; Reformimi i standardeve të prodhimit të mediave online për të prioritizuar cilësinë mbi sasinë; Nxitja e bashkëpunimeve midis medias dhe organizatave të verifikimit të fakteve; Integrimi i Studimeve të Dezinformimit në kurrikulat e shkencave shoqërore dhe komunikimit.
Gjatë 2025 AMA ka vijuar gjithashtu bashkëpunimin me Aleancën Kundër Gjuhës së Urrejtjes, duke u angazhuar si partnere themeluese e kësaj Aleance, në takime të ndryshme mbi rëndësinë e edukimit mediatik si një mjet për të luftuar gjuhën e urrejtjes, si dhe mbrojtjen e publikut nga Dezinformimi, përdorimi me kujdes i të dhënave personale sidomos në Platformat e Shpërndarjes së Videove.
AMA është treguar bashkëpunuese dhe e gatshme për t'u angazhuar edhe në takimet dhe ndërmarrjet e Departamentit të Gazetarisë, kjo veçanërisht në kuadër të propozimeve për ndryshime në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nismë kjo e cila ka vijuar përgjatë gjithë vitit 2025.

- Takime në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional

Bashkëpunimet ndërinstitucionale dhe ato me partnerët ndërkombëtarë, kanë qënë të shumta edhe përgjatë 2025 dhe shumë pozitive. AMA ka marrë pjesë në një sërë tryezash bashkëpunimi me institucione të tjera të vendit, për çështje dhe/ose problematika të ndryshme, apo në kuadër të përafrimit të legjislacionit me acquis e BE-së. AMA dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) kanë organizuar një tryezë të përbashkët, me temë kushtet e punës së gazetarëve dhe mundësia e përmirësimit të këtyre kushteve. Në tryezë merrnin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, gazetarë etj., dhe rezultat i saj është publikimi i përbashkët i Manualit, "Punë dinjitoze në sektorin e medias", me informacione mbi të drejtat e punësimit që gazetarët e tregut mediatik duhet të gëzojnë.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, Autoriteti i Mediave Audiovizive është angazhuar gjithashtu duke marrë pjesë në takime e tryeza, siç ishte ajo me temë Dezinformimi shëndetësor, organizuar nga kreu i Shoqatës Shqiptare të Urgjencës Mjekësore dhe Katastrofave (SHSHMUK), me pjësemarrjen e përfaqësuesve të urdhrave profesionalë të fushës së shëndetësisë, institucioneve të rendit, universitete, mjek të njohur dhe përfaqësues të medias. AMA e ka qartësisht të përcatuar ligjërisht pozicionin e vet sa i takon reklamave shëndetësore apo trajtimit të çështjeve të shëndetit, dhe zbatimin e ligjit e ndjek nëpërmjet monitorimit që u bëhët përmbajtjeve audiovizive.
Autoriteti i Mediave Audiovizive ka qenë i pranishëm edhe në tryezat e konsultimit me grupet e interesit mbi draftin e Kodit të ri Penal, duke dhënë mendime e sugjerime në funksion të sigurimit të një mjedisi mediatik sa më të drejtë dhe por dhe një mjedis mediatik ku gazetarët të jenë më të mbrojtur në ushtrimin e detyrës së tyre.
Përgjatë vitit 2025 ka vijuar bashkëpunimi i ngushtë edhe me Transmetuesin Publik, Radio Televizionin Shqiptar, duke u angazhuar në takime e tryeza që synojnë një media publike moderne dhe në shërbim të qytetarëve. Marrëdhënia ndërmjet AMA-s dhe RTSH-së është një raport i përcaktuar ligjërisht, i cili përkufizon qartë përgjegjësitë dhe pritshmëritë nga të dy institucionet. Kjo marrëdhënie nuk është vetëm teknike apo procedurale, por është thelbësore për garantimin e një media publike të lirë, të pavarur dhe të orientuar drejt interesit qytetar.

- Takime në kuadër të monitorimit të procesit zgjedhor

Viti 2025 ishte një vit elektoral për Shqipërinë, proces në të cilin AMA është e angazhuar në monitorimin respektimin nga ana e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizive nga fillimi deri në fund të fushatës zgjedhore, të kërkesave të Kodit Zgjedhor, sipas Metodologjisë së miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
Autoriteti i Mediave Audiovizive ka zhvilluar disa takime para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor, duke iu përgjigjur interesit të ekspertëve, vëzhguesve dhe përfaqësuesve të OSBE/ODIHR, KiE, KRIIK, etj., lidhur me monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive gjatë procesit zgjedhor, që synon të garantojë që fushatat zgjedhore në mediat audiovizive të jenë të drejta dhe të paanshme. Në këto takime është diskutuar mbi rolin e AMA-s në këtë proces dhe mundësinë për bashkëpunime me partnerë të tillë për AMA-n si OSCE/ODIHR apo KiE.

- Trajnim i stafit të AMA-s, në kuadër të forcimit të kapaciteteve

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka organizuar një trajnim dy ditor të stafit, në kuadër të forcimit të kapaciteteve, me trajnues përfaqësues të Autoritetit Audioviziv Italian, AGCOM, me temë "Rregullimi i Platformave të Shpërndarjes së Videove". Kjo tregon edhe bashkëpunimin e ngushtë të AMA-s me AGCOM, sidomos në çështje që kanë të bëjnë me shkëmbimin e eksperiencave në përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë evropian. Gjatë trajnimit u sollën raste konkrete dhe praktikat italiane në evidentimin dhe trajtimin e rasteve të shkeljes së ligjit nga individë dhe Platformave të Shpërndarjes së Videove.
Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Këshillin e Europës, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) zhvilloi një tryezë pune dyditore me stafin e tij, me fokus transpozimin e Aktit Europian për Lirinë e Medias (EMFA) dhe për Shërbimet Digjitale (DSA). Aktiviteti u organizua në kuadër të programit të përbashkët BE–Këshilli i Europës, "Facility Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë III". Diskutimet u përqendruan në rolin e AMA-s si autoritet rregullator në mbrojtjen e lirisë së medias, garantimin e pluralizmit dhe pavarësisë editoriale, transparencën e pronësisë mediatike dhe mbikëqyrjen e tregut online. Përmes shkëmbimit të praktikave më të mira europiane, tryeza kontribuoi në forcimin e kapaciteteve institucionale të AMA-s, veçanërisht në drejtim të zbatimit të ligjit dhe përballimit të sfidave që sjell transformimi digjital, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian.

- Takimi i 12-të i BRAF në Shqipëri

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), më datat 16–18 shtator 2025, organizoi në Shqipëri takimin e 12-të vjetor të Forumit të Autoriteteve Rregullatore të Transmetimeve në Detin e Zi (Black Sea Broadcasting

Regulatory Authorities Forum – BRAF). Ky aktivitet mblodhi përfaqësues të niveleve drejtuese të autoriteteve rregullatore të mediave audiovizive nga vendet anëtare të këtij forumi, përfshirë Turqinë, Azerbajxhanin, Greqinë, Serbinë, Armeninë, Bullgarinë, Moldavinë dhe Gjeorgjinë, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme dialogu për çështje me interes të përbashkët për rregullimin e mediave në rajonin e Detit të Zi.

Tema qendrore e takimit ishte "Gjuha e Urrejtjes dhe e Drejta për Informim në Mediat Audiovizive dhe Platformat Online", një temë që pasqyron sfidat aktuale me të cilat përballen autoritetet rregullatore në një mjedis mediatik gjithnjë e më të ndërlidhur dhe të ndikuar nga zhvillimet digjitale. Diskutimet u përqendruan në mënyrën se si autoritetet rregullatore mund të adresojnë përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjeve diskriminuese, duke garantuar njëkohësisht respektimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtës së publikut për informim të saktë dhe të besueshëm.

Takimi u zhvillua në dy sesione kryesore pune, të cilat përfshinë prezantime nga autoritetet rregullatore pjesëmarrëse, diskutime tematike dhe shkëmbim praktikash mbi qasjet rregullatore dhe instrumentet ligjore të përdorura në secilin vend për mbikëqyrjen e mediave audiovizive dhe përballimin e sfidave që lidhen me përmbajtjet problematike në media dhe në platformat digjitale.

Më 17 shtator, aktiviteti u zhvillua në qytetin e Vlorës. Në fjalën hapëse, Kryetarja e Autoritetit, znj. Armela Krasniqi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rajonal ndërmjet autoriteteve rregullatore për të adresuar sfidat e përbashkëta që lidhen me rregullimin e mediave dhe garantimin e standardeve profesionale në hapësirën audiovizive. Ajo vlerësoi gjithashtu rëndësinë e organizimit të këtij forumi në Shqipëri, duke e konsideruar atë si një mundësi për të forcuar dialogun rajonal dhe për të ndarë përvojat e vendeve pjesëmarrëse në përballimin e sfidave të reja që sjell transformimi digjital i mediave.
Gjatë këtij sesioni, pjesëmarrësit u njohën me raportin e takimit të 11-të të BRAF, të mbajtur në Baku, Azerbajxhan, ndërsa më pas vijuan prezantimet e raporteve të vendeve (country reports) nga secili autoritet rregullator anëtar. Këto prezantime ofruan një panoramë të zhvillimeve më të fundit në kuadrin ligjor dhe rregullator të mediave në vendet përkatëse, duke evidentuar sfidat që lidhen me monitorimin e përmbajtjeve audiovizive, ndikimin e platformave online dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit në hapësirën mediatike.

Më 18 shtator, aktiviteti vijoi me diskutime tematike të organizuara në dy panele kryesore. Paneli i parë u përqendrua në çështjen e gjuhës së urrejtjes dhe të drejtës për informim në mediat audiovizive, duke analizuar qasjet rregullatore dhe mekanizmat ligjorë të përdorur nga autoritetet përkatëse për të ruajtur balancën ndërmjet lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së interesit publik. Paneli i dytë trajtoi çështjen e gjuhës së urrejtjes dhe të drejtës për informim në platformat online, duke evidentuar sfidat që paraqet mjedisi digjital dhe nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, si dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në adresimin e përmbajtjeve të dëmshme. Diskutimet theksuan rëndësinë e një qasjeje të koordinuar dhe të harmonizuar ndërmjet autoriteteve rregullatore përballë sfidave të përbashkëta që lidhen me zhvillimet e shpejta të teknologjisë dhe transformimin e mënyrës së shpërndarjes së informacionit. Në këtë kontekst, u nënvizua nevoja për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe për shkëmbimin e vazhdueshëm të praktikave më të mira në rregullimin e mediave dhe në mbrojtjen e standardeve të lirisë së shprehjes.

Organizimi i këtij takimi nga Autoriteti i Mediave Audiovizive përbën një kontribut të rëndësishëm në forcimin e rolit të Shqipërisë në dialogun rajonal mbi rregullimin e mediave dhe zhvillimet në hapësirën audiovizive. Gjithashtu, ky aktivitet shërbeu për të thelluar bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve rregullatore të rajonit të Detit të Zi dhe për të promovuar një qasje të përbashkët në përballimin e sfidave që lidhen me garantimin e lirisë së shprehjes, mbrojtjen nga gjuha e urrejtjes dhe sigurimin e të drejtës së publikut për informim në një mjedis mediatik gjithnjë e më kompleks dhe digjital.

- Mbi procesin e Matjes së Shikueshmërisë

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në cilësinë e autoritetit rregullator, ka vijuar angazhimin e tij nxitës për krijimin e një sistemi transparent, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të Matjes së Shikueshmërisë audiovizive në tregun shqiptar, duke mbështetur dhe asistuar ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) qoftë në aspektin metodologjik qoftë në atë institucional. Si rezultat i një procesi të strukturuar dialogu, prezantimit dhe analizimit të modeleve referuese të matjes së audiencës të aplikuara në vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian, me qëllim orientimin e aktorëve të tregut drejt zgjedhjes së modelit më të përshtatshëm për realitetin shqiptar, si dhe falë bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara, është arritur konstituimi i KPI-së dhe ndërmarrja e hapave për formalizimin e tij, përfshirë regjistrimin si subjekt juridik dhe përmbushjen e detyrimeve administrative përkatëse.

Tashmë ka përfunduar procesi i regjistrimit të KPI si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke fituar të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ky status në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Duke qenë nje subjekt me personalitet të plotë juridik, KPI ka konstituuar organet e tij drejtuese, përfshirë Bordin e Drejtorëve dhe Drejtorin Ekzekutiv, si dhe ka përfunduar regjistrimin pranë autoriteteve fiskale të Republikës së Shqipërisë. Këto zhvillime hapin rrugën për nisjen efektive të procesit të matjes së audiencës si një instrument kyç për vlerësimin e ndikimit të mediave dhe për mbështetjen e tregut mediatik, drejt ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm të matjes së audiencës në Shqipëri..

Funksionimi normal i kësaj organizate tashmë lidhet me thirrjet për shprehje interesi të publikuara nga KPI drejtuar kompanive të njohura evropiane dhe ndërkombëtare të specializuara në sistemet e matjes së audiencës. Deri në përfundimin e procesit të konfirmimit të disponueshmërisë dhe marrëveshjeve kontraktuale ndërmjet KPI dhe këtyre kompanive, AMA do të vazhdojë të ushtrojë rolin e saj të qartë si lehtësuese dhe mbështetëse e këtij procesi, në përputhje me kompetencat e saj ligjore.

- Takime në kuadër të bashkëpunimit me homologët e vendeve të rajonit dhe më gjerë

AMA përgjatë vitit 2025, ka vijuar më tej bashkëpunimin me rregullatorët e vendeve të rajonit dhe jo vetëm, duke zgjeruar dhe forcuar kështu bashkëpunimin mes tyre. Mes AMA-s dhe homologëve të saj në rajon janë zhvilluar takime, ku fokusi kryesor ka qënë bashkëpunimi mes rregullatorëve, apo edhe trajnime të stafit për sa i përket çështjeve të rëndësishme të fushës së medias audio dhe/ose audiovizive, me të cilat ato përballen apo që mund të përballen në të ardhmen. Thelbi i këtyre takimeve ka qënë shkëmbimi i eksperiencave mes rregullatorëve për çështje si metodat e monitorimit të programeve, platformat e shpërndarjes së videove, mbrojtja e të drejtave të minoriteteve në transmetimet audiovizive, hartimi i akteve nënligjore në zbatim të përafrimit të legjislacioneve të brendshme me acquis e BE-së, etj.

Në kuadër të këtyre tematikave, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka pritur delegacione të homologëve nga Serbia, REM, apo përfaqësues të Ministrisë së Kulturës dhe të shoqatës së Minoriteteve në Estoni, Komisioni i Pavarur për Media i Kosovës, etj.

Në takimin AMA-REM u shkëmbyen eksperiencat e të dyja autoriteteve, me prezantime dhe diskutime përkatëse, sa i përket çështjeve me të cilat hasen çdo ditë në funksionimin e tyre të dy autoritetet. Ndër to përmenden monitorimi dhe analiza e përmbajtjeve, planifikimi i frekuencave apo mbikëqyrja dhe inspektimet ndaj ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive.

Në takimin me përfaqësues të Ministrisë së Kulturës dhe të shoqatës së Minoriteteve në Estoni u diskutua mbi rolin e AMA-s në monitorimin e transmetimeve audiovizive në Shqipëri, në kuadër të respektimit të të drejtave të pakicave kombëtare, si dhe në sigurimin e një qasje pa dallim race apo përkatësie etnike, apo mbrojtjen e tyre nga diskriminimi në transmetimet aduio dhe audiovizive në Shqipëri.

Bashkëpunimi mes AMA-s dhe KPM-s, në Kosovë ka vijuar edhe përgjatë vitit 2025. Të dy rregullatorët kanë shkëmbyer eksperiencat e tyre për çështje të rëndësishme, ku rolin kryesor vazhdojnë ta kenë diskutimet mbi procesin e harmonizimit të legjislacionit me acquis të BE-së, si dhe rëndësia për bashkëpunim të vazhdueshëm mes dy rregullatorëve.

Bashkëpunimi ka vijuar përgjatë 2025 edhe mes AMA-s dhe AEM, autoriteti rregullator i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Konferencën Ndërkombëtare Rregullatore, IRC 2025. Në agjendë të kësaj Konference janë përpjekjet për të përcaktuar rregullat dhe standardet e nevojshme për të siguruar që spektri i frekuencave të përdoret në mënyrë efikase dhe të drejtë.

- Takime me partnerët ndërkombëtarë

AMA ka kryer një sërë takimesh periodike me partnerë të ndryshëm ndërkombëtar, si OSBE/ODIHR, KiE, etj. Në qendër të këtyre takimeve kanë qënë tema që kanë të bëjnë kryesisht me monitorimin e mediave përgjatë procesit zgjedhor, Dezinformimi, Liria e Shprehjes dhe E drejta për Informim, Edukimi Mediatik, etj.

- Bashkëpunim AMA - OSBE/ODIHR

AMA ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë me partnerin ndërkombëtar OSBE/ODIHR edhe gjatë vitit raportues, duke marrë pjesë në konferenca dhe tryeza të organizuara nga ky partner i rëndësishëm, por edhe duke pritur në mjediset e Autoritetit grupe përfaqësuesish të nivelit të lartë të OSBE/ODIHR. Fokus i këtyre takimeve kanë qënë çështje me të cilat AMA është angazhuar, si procesi i Matjes së Shikueshmërisë, ndryshimet ligjore në ligjin organik të AMA-s, përshtatja me Direktivat e BE-së, zhvillimi i teknologjisë, nevoja e rregullimit të Platformave të Shpërndarjes së Videove, ndikimi i Inteligjencës Artificiale, Transparenca e Pronësisë së Medias etj. Gjithashtu gjatë këtyre takimeve janë diskutuar dhe përgatitjet e AMA-s për procesin e monitorimit të mbulimit të fushatës elektorale nga OSHMA-të, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025, si dhe bashkëpunimi i AMA-s me KQZ-në për trajnimin e monitoruesve të pëfshirë në proces, për njoftimet kujtesë që adresohen tek OSHMA-të për nevojën e respektimit të standardeve dhe kërkesave të Kodit Zgjedhor etj.
Në këtë kuadër, më 29 tetor 2025, Kryetarja e Autoriteti i Mediave Audiovizive, mori pjesë në Forumin e 11-të të Zhvillimit të Medias (MDF), organizuar nga OSBE Prezenca në Shqipëri, ku prezantoi nismat e AMA-s për rritjen e transparencës së pronësisë së medias dhe identifikimin e pronarëve përfitues. Në këtë kuadër, u theksua krijimi i databazës publike mbi strukturën pronësore të operatorëve audiovizivë, si dhe bashkëpunimi me QKB-në për analizimin e veprimtarive të tjera ekonomike të pronarëve, në funksion të forcimit të pluralizmit dhe integritetit mediatik.

- Bashkëpunim mes AMA dhe Këshillit të Europës

AMA ka vijuar gjithashtu bashkëpunimin e ngushtë me Këshillin e Europës edhe përgjatë vitit 2025, përmes takimeve dhe tryezave të zhvilluara në mjediset e AMA-s, por edhe jashtë Autoritetit. Fokusi i këtyre takimeve kanë qenë angazhimet e AMA-s në procese të ndryshme, si transparenca e pronësisë së medias audiovizive - një proces tashmë i përfunduar - liria e medias, edukimi mediatik dhe funksionimi i sektorëve kryesorë të AMA-s, monitorimi i Ofruesve të Shërbimeve Mediatik Audiovizivë gjatë periudhës së fushatave zgjedhore, në respektim të Kodit Zgjedhor dhe metodologjisë së miratuar nga KQZ për monitorimin e medias audio dhe audiovizive.
Po ashtu, në qendër të bashkëpunimeve me Këshillin e Europës një angazhim i rëndësishëm i AMA-s ka qenë pjesëmarrja aktive në tryezat e organizuara në kuadër të Projektit të përbashkët BE/KE, "Promovimi i Lirisë së Shprehjes në Shqipëri nëpërmjet Dialogut të Hapur", në koordinim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës. Gjatë këtyre tryezave, me pjesëmarrje të gjerë të shoqërisë civile, gazetarëve, përfaqësues të institucioneve, akademikëve etj., AMA ka kontribuar në punimet e Platformës, me referenca për detyrimet ligjore që burojnë nga procesi i integrimit dhe hapat institucionalë dhe ligjorë të ndjekur në këtë drejtim për realizimin e tyre, në kuadër të procesit të integrimit dhe harmonizimit të legjislacionit.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka luajtur një rol të rëndësishëm si mbajtës i sekretariatit të Aleancës Kundër Gjuhës së Urrejtjes, duke kontribuar në përpjekjet për të luftuar këtë fenomen dhe për të promovuar një mjedis mediatik të përgjegjshëm dhe të respektueshëm. Në fillim të vitit 2025 u shënua edhe takimi përmbyllës i kësaj Aleance. Ky angazhim ka qenë pjesë e një bashkëpunimi të ngushtë me Zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë dhe përfaqësinë e Delegacionit të Bashkimit Europian, të cilët kanë mbështetur këtë iniciativë me qëllim përmirësimin e klimës mediatike në vend. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, AMA ka organizuar tryeza diskutimi me aktorë të ndryshëm të medias, Fakultetin e

Gazetarisë, shoqërinë civile, Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Përmes këtyre tryezave janë diskutuar tema të rëndësishme si përmirësimi i standardeve profesionale të gazetarëve dhe roli i mediave në reklamimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike, ku çdo individ mund të shprehet pa pasur frikë nga diskriminimi ose fyerja. Po ashtu është nënvizuar rëndësia e një bashkëpunimi të fortë ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile për të garantuar një mjedis të drejtë dhe të barabartë për të gjithë. Ky angazhim, në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën e Këshillit të Europës, ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik për pasojat e gjuhës së urrejtjes dhe ka mbështetur zhvillimin e një debati konstruktiv dhe të respektueshëm në media. Kjo ka shërbyer si një mundësi për të forcuar kulturën e dialogut dhe mirëkuptimit, si dhe për të siguruar që media të jetë një mjet që promovon vlerat e demokracisë, diversitetit dhe barazisë.

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Këshillin e Europës, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) zhvilloi një tryezë pune dyditore me fokus, transpozimin e Aktit Europian për Lirinë e Medias (EMFA) dhe Aktit për Shërbimet Digjitale (DSA) në legjislacionin shqiptar. Aktiviteti u organizua në kuadër të programit të përbashkët BE – Këshilli i Europës, "Facility Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë III", me pjesëmarrjen e ekspertit të Këshillit të Europës, z. Francesco Sciacchitano (AGCOM). Diskutimet u përqendruan në rolin e AMA-s në mbrojtjen e lirisë së medias, garantimin e pluralizmit, pavarësisë editoriale, transparencës së pronësisë mediatike dhe mbikëqyrjen e tregut online, në përputhje me standardet europiane. Ky aktivitet përbën një hap konkret në forcimin e kapaciteteve institucionale të AMA-s dhe në procesin e harmonizimit të kuadrit rregullator shqiptar me acquis të Bashkimit Europian në fushën e medias dhe shërbimeve digjitale.

Zyra e Këshillit të Europës në Shqipëri ka qenë gjithmonë një partner i rëndësishëm për AMA-n, duke e asistuar dhe mbështetur Autoritetin në aspekte shumë të rëndësishme, me qëllim arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian.

**Takime mes AMA-s dhe autoriteteve rregullatore të vendeve anëtare të BE-së**

Ashtu si në vitet e tjera, edhe gjatë vitit raportues, kryetarja e AMA-s ka kryer takime konsultuese dhe shkëmbim eksperiencash me përfaqësues të autoriteteve rregullatore nga disa vende anëtare të BE-së.

Ajo ka marrë pjesë në Asambletë të Plenare të Bordit Europian të Medias (EU Media Board), ku pjësëmarrësit, të cilët ishin drejtuesit e nivelit të lartë të organeve kombëtare rregullatore të pavarura në fushën e shërbimeve audiovizive, kishin në fokus rikonsiderimin e të gjithë kuadrit ligjor, në përshtatje me dinamikat e zhvillimit të tregut mediatik. Në këto takime, Kryetarja e AMA-s ka theksuar se institucioni ka gjithë vullnetin dhe kapacitetet për të përdorur të njëjtët instrumente që aplikojnë rregullatorët e 27 vendeve anëtare të BE-së.

Gjithashtu në të gjitha takimet me përfaqësues të lartë të autoriteteve europiane rregullatore, tematikat e diskutimit kanë qenë praktikat më të mira europiane mbi transparencën në fushën e medias audiovizive dhe mundësitë e përafrimit me legjislacionin e brendshëm shqiptar, të cilat do të shërbejnë si shembull për hartimin e akteve përkatës nënligjore.

- **Përfaqësimi i AMA-s në platformat ndërkombëtare të fushës së mediave audiovizive**

Gjatë vitit 2025 Autoriteti i Mediave Audiovizive ka zhvilluar një sërë takimesh dhe konferencash jashtë vendit, me institucione të BE-së dhe autoritete rregullatore homologe në rajon, Europë dhe përtej kontinentit europian. Takimet e ndjekura nga AMA kanë qënë të një rëndësie të veçantë, si në kuadër të integrimit të BE-së dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së, ashtu edhe në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave më të mira mes autoriteteve rregullatore për çështje delikate, me të cilat përballet mjedisi mediatik. Ndër to, mund të përmenden takimet me rëndësi të veçantë, si më poshtë vijon:

1- **EU Media Board:** Bordi Europian i Medias, është një strukturë koordinuese, e cila mbledh së bashku përfaqësues të nivelit të lartë të organeve kombëtare rregullatore të pavarura në fushën e shërbimeve audiovizive, të vendeve anëtare të BE-së. Vendet kandiate si Shqipëria, marrin pjesë si vende me rol vëzhgues. Përgjatë vitit 2025, AMA ka ndjekur 6 takime të zhvilluara nga EU Media Board, ndër të cilat përmendim tre takimet Plenare vjetore, në të cilat fokusi kryesor kanë qënë çështje si mbrojtja e fëmijëve

nga ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme audiovizive, gjuha e urrejtjes, politikat mbi Aktin Europian për Lirinë e Medias (EMFA), Direktiva Europiane për Shërbimet Mediatike Audiovizive (AVMSD), Akti për Shërbimet Digjitale (DSA), etj. Takime të tjera janë realizuar edhe në formën e rrjetit të kontakteve.

2. EPRA: Platforma Europiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA) është rrjeti më i vjetër dhe më i madh i rregullatorëve të transmetimit dhe është një mjedis ideal për shkëmbimin e informacionit, rasteve dhe praktikave më të mira ndërmjet rregullatorëve të transmetimit në Europë. Përgjatë vitit 2025, AMA ka ndjekur 3 takime të zhvilluara nga EPRA, ndër të cilat përmendim 2 Asambletë Plenare, të mbajtura përkatësisht në Kishinau dhe në Jerevan, ku janë trajtuar tematika të rëndësishme për realitetin mediatik audioviziv, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave më të mira ndërmjet anëtarëve të EPRA-s, ndër të cilët është edhe AMA.

3. Observatori Europian Audioviziv: Observatori, ku AMA aderon me të drejta të plota, është një organizatë nën varësinë e Këshillit të Europës. Rrjeti ofron një pasqyrë krahasuese europiane të industrisë audiovizive në të gjitha vende anëtare të KiE-së, si dhe analiza të hollësishme të industrive kombëtare dhe rajonale audiovizive. Gjatë vitit 2025 përfaqësues të drejtorisë së Integrimit dhe Legjislacionit Ndërkombëtar në AMA kanë marrë pjesë në 2 takime të kësaj organizate.

4. WorldDAB: WorldDAB është një tjetër platformë që shërben si një forum global i industrisë për radion digjitale DAB+, ku AMA prej vitit 2023 është pjesë e saj si anëtare. Gjatë vitit 2025 AMA ka qënë e përfaqësuar nga ekipe të drejtorive Ligjore, të Planifikimit të Frekuencave dhe TIK, Integrimit dhe Legjislacionit Ndërkombëtar. Në 7 takime të WorldDAB të organizuara në vende të ndryshme, fokusi i të cilave ka qënë shkëmbimi i përvojave dhe njohurive mbi mundësitë e zhvillimit të rrjeteve të DAB+, rolin e teknologjive të reja si dhe të teknikave të inteligjencës artificiale në zhvillimin e tyre, etj.

5. MNRA: Në vitin 2025 AMA ka ndjekur takimet e Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore, duke nisur me takimin e Grupit Teknik ku diskutohen dhe vendoset ndërmjet anëtarëve mbi aspektet përgatitore në lidhje me mbajtjen e Asamblesë Plenare të kësaj platforme. Kjo e fundit, Asambleja Plenare e 24 - të, u mbajt në Prishtinë, Kosovë. Kreu i autoriteti rregullator të Kosovës, KMP mbante postin e Zv. Presidentit të MNRA - së. Në këtë Asamble, AMA përfaqësohej nga Kryetarja znj. Armela Krasniqi dhe përfaqësues të drejtorisë së Integrimit dhe Legjislacionit Ndërkombëtar. Autoritetet pjesëmarrëse, përgjatë punimeve të Asamblesë, shkëmbyen eksperiencat e tyre dhe studime të kryera në vendet respektive për çështje të rëndësishme të fushës së mediave audiovizive siç janë Edukimi Mediatik, administrimi i platformave digjitale në kuadër të nxitjes së lirisë së shprehjes, të drejtat e njeriut, raportet gjinore në media, etj.

6. UNESCO: Në vitin 2025 AMA ka marrë pjesë në një nga aktivitetet më të rëndësishme të organizuara nga UNESCO, siç ishte Takimi i Rrjetit Global të Autoriteteve Mbikëqyrëse për inteligjencën Artificiale. Gjatë zhvillimit të punimeve të këtij takimi, janë diskutuar fenomene aktuale me të cilat hasen shoqëritë demokratike, si mbikëqyrja e Inteligjencës Artificiale, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe forcimin e kapaciteteve të autoriteteve rregullatore. Theksi u vendos mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe harmonizimin e praktikave rregullatore, me qëllim përballimin e sfidave teknologjike dhe garantimin e një qasjeje etike në përdorimin e Inteligjencës Artificiale. Pjesëmarrja e AMA-s në këtë aktivitet kishte një rëndësi të veçantë edhe në sjelljen e përvojës institucionale shqiptare në përballjen me zhvillimet më të fundit në fushën e mbikëqyrjes së Inteligjencës Artificiale.

7- BRAF: BRAF është gjithashtu një nga platformat e rregullatorëve të fushës së mediave audiovizive në takimet dhe tryezat e të cilit AMA merr pjesë vazhdimisht. Ky është Forumi i Autoriteteve Rregullatore të Transmetimeve të Detit të Zi, ku anëtarët mblidhen dhe diskutojnë mbi problematikat që hasin dhe shkëmbimin e eksperiencave në zgjidhjen e tyre. Përgjatë vitit 2025, përveçse AMA ka qenë vendi pritës dhe organizator i Takimit të 12-të Plenar të BRAF, ka marrë pjesë gjithashtu edhe në Takimin e 11-të me temë

mbrojtjen e fëmijëve në shërbimet mediatike, të organizuar në Baku, ku AMA përfaqësohej nga Kryetarja, znj. Armela Krasniqi.

8. ITU: Në vitin 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive, përfaqësuar kryesisht nga drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK, por edhe nga Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikqyrjes, kanë ndjekur 3 takime të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit. Agjendë e takimeve të ITU janë kryesisht temat që kanë të bëjnë me standardizimin dhe harmonizimin e teknologjive për shpërndarjen e përmbajtjes audiovizive, roli i rrjeteve kabllore dhe IP për ofrimin e shërbimeve të integruara, etj.

9. OSCE/ODIHR: Përgjatë vitit 2025, Kryetarja e AMA-s dhe përfaqësues të Drejtorisë Ligjore të Autoritetit të Mediave Audiovizive kanë ndjekur 2 takime të OSCE/ODIHR, ku fokusi ka qenë forcimi i integritetit zgjedhor në vendet e Ballkanit Perëndimor. Duke patur parasysh që viti 2025 ishte një vit elektoral për Shqipërinë, ndjekja e këtyre takimeve ka patur një rëndësi tepër të veçantë për AMA-n, si autoritetit i ngarkuar me monitorimin transmetimeve audiovizive përgjatë periudhës së fushatave zgjedhore, sipas metodologjisë së përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

10. REFRAM: Bashkëpunimi mes AMA-s dhe REFRAM ka vijuar edhe më tej në vitin 2025. REFRAM është rrjeti që bën bashkë autoritetet rregullatore mediatike audiovizive frankofone. AMA mori pjesë në Konferencën e 8-të Presidentëve të Rrjetit Frankofon të Rregullatorëve Mediatikë, i mbajtur në Dakar.

11. Gjatë vitit 2025, përfaqësues të njesive të ndryshme në AMA kanë marrë pjesë edhe në në aktivitete të tjera jashtë vendit, në platforma të tjera, gjithashtu edhe në ato të organizuara nga homologët e AMA-s, të cilat trajtojnë zhvillimet e fundit teknologjike të transmetimit, sfidat e menaxhimit dhe administrimit të platformave digjitale në kuadër të mbrojtjes së publikut nga përmbajtjet e dëmshme, denigruese, të dhunshme, dezinformimit, etj. Secili prej këtyre aktiviteteve kanë patur rëndësinë e vet, duke pasur parasysh që në këto arena diskutimesh mes rregullatorësh diskutohen çështjet dhe sfidat më delikate, me të cilat përballen ata, të cilat janë thuajse të njëjta për të gjithë. Të gjitha kanë luajtur rolin dhe kanë patur rëndësinë e tyre në prezencën e AMA-s në arenën ndërkombëtare të rregullatorëve të mediave audiovizive evropiane dhe jo vetëm.

- **Vijim i bashkëpunimit me autoritetet e tjera rregullatore**

1. RTUK: Bashkëpunimi me autoritetin rregullator turk, RTUK, ka vijuar gjatë 2025 edhe në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet AMA-s dhe RTUK. Përfaqësuesit e AMA-s kanë marrë pjesë në dy takime të zhvilluara në Ankara, me tema si përfaqësimi i grave në media dhe impakti që kanë përmbajtjet mediatike negative në sjelljen shoqërore dhe propozimi i alternativave për zgjidhjen e tyre.

2. ERC: Përfaqësues të AMA-s kanë marrë pjesë në Konferencën e 20-vjetorit të autoritetit rregullator portugez, ERC. Në këtë Konferencë u bënë bashkë autoritetet rregullatore të mediave të vendeve të Bashkimit Europian, me diskutime rreth rolit të këtyre rregullatorëve në epokën digjitale, standardet në lirinë e medias, etj.

3. KRRiT: Përfaqësuesit e AMA-s kanë marrë pjesë në një takim zyrtar të mbajtur në Varshavë, me ftesë të autoritetit rregullator polak, KRRiT. Në kuadër edhe të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar mes dy autoriteteve, pjesë e agjendës së këtij takimi ishin sfidat me të cilat po përballen sot rregullatorët në kontekstin e transformimit digjital, nevojën e mbrojtjes së konsumatorëve dhe të miturve, shkëmbimi i eksperiancave të dy rregullatorëve në zgjidhjen e këtyre problematikave, etj.

4. HACA: Në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit dhe nevojës për të shkëmbyer eksperiencat dhe praktikat më të mira në zgjidhjen e sfidave që hasen në fushën e mediave audiovizive, Autoriteti i Mediave Audiovizive i është përgjigjur ftesës së autoritetit rregullator maroken, HACA, për zhvillimin e një vizite zyrtare të mbajtur në Rabat. Kjo vizitë shërbeu për të patur një vizion më shumë në zgjidhjen e çështjeve si mbrojtja e të drejtave të përdoruesve të mediave, garantimi i pluralizmit dhe lirisë së shprehjes, rregullimi i tregut mediatik, etj, duke marrë eksperienca edhe nga vende përtej vendeve të Bashkimit Europian.

**Takime në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian**

- **Dialogu dhe Bashkëpunimi Institucional**

Një ndër arritjet më të rëndësishme të AMA-s në procesin e integrimit evropian ka qenë krijimi i një kulture të re dialogu dhe bashkëpunimi institucional, e cila shkon përtej detyrimeve të ngushta ligjore dhe merr dimensionin e një platforme gjithëpërfshirëse, ku aktorë të ndryshëm të shoqërisë kontribuojnë në ndërtimin e politikave publike në fushën e medias. Ky orientim përfaqëson një ndryshim cilësor në mënyrën se si AMA e ushtron misionin e saj: jo më si një organ i mbyllur brenda vetes, por si një institucion i hapur, transparent dhe i gatshëm për të dëgjuar, diskutuar dhe reflektuar mbi sfidat dhe zgjidhjet që lidhen me sektorin audioviziv.
Përmes tryezave të rrumbullakëta, konsultimeve publike dhe mbledhjeve të hapura, AMA ka mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve mediatikë, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe komunitetit akademik në procesin e hartimit të akteve nënligjore dhe rregulloreve të reja. Ky mekanizëm jo vetëm që rrit legjitimitetin e vendimmarrjes, por gjithashtu krijon një mjedis bashkëpunues, ku problematikat dhe shqetësimet e sektorit adresohen në mënyrë institucionale dhe të strukturuar. Në këtë mënyrë, AMA ka treguar se është e ndërgjegjshme se integrimi evropian nuk është thjesht një proces teknik, por një reformë shoqërore e thellë, ku çdo aktor ka rolin dhe përgjegjësinë e vet.
Një shembull domethënës i këtij orientimi është nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Ky akt, i miratuar pas një procesi konsultimesh të gjera, synon jo vetëm monitorimin e kushteve të punës në sektorin mediatik dhe mbrojtjen e punëmarrësve, por edhe forcimin e kontratave të punës dhe respektimin e të drejtave themelore të gazetarëve dhe profesionistëve të medias. Në këtë rast, AMA ka treguar se e kupton rolin e saj si një garant jo vetëm i standardeve ligjore, por edhe i dinjitetit profesional dhe i mirëqenies së atyre që mbajnë mbi shpatulla barrën e informimit publik.
Në planin ndërkombëtar, AMA ka fituar peshë dhe besueshmëri përmes një angazhimi aktiv në rrjetet e rregullatorëve europianë dhe rajonalë. Pjesëmarrja në organizata si EPRA, ERGA, MNRA, EMIL dhe TAIEX i ka mundësuar AMA-s jo vetëm të marrë përvojat më të mira të vendeve të tjera, por edhe të japë kontributin e saj të drejtpërdrejtë mbi temat që prekin median dhe shërbimet digjitale. Përmes pyetësorëve, raporteve dhe prezantimeve të ndryshme, AMA është bërë një zë i dëgjuar në tryezat ku diskutohet e ardhmja e qeverisjes së platformave online, mbrojtja e fëmijëve në mjedisin digjital dhe garantimi i lirisë së shprehjes.
Një moment i këtij angazhimi ndërkombëtar ishte workshop-i i organizuar në Tiranë, në qershor 2025, me temë "Transpozimi i Kuadrit Ligjor të BE-së mbi Mediat dhe Shërbimet Digjitale: Përgatitja e Shqipërisë për Integrim". Ky aktivitet, i zhvilluar nën kujdesin e Këshillit të Europës dhe homologut italian, solli në kryeqytetin shqiptar ekspertë të nivelit më të lartë nga institucionet europiane. Në këtë forum, AMA prezantoi draftin paraprak të ndryshimeve ligjore, të ndërtuara mbi tri shtylla themelore: integritetin e informacionit, garantimin e pluralizmit dhe mbrojtjen e fëmijëve në platformat digjitale. Ky moment përbën një dëshmi të qartë se Shqipëria, përmes AMA-s, nuk është thjesht ndjekëse e politikave të BE-së, por një kontribuese aktive në ndërtimin e tyre.

- **Raportime dhe Monitorime Ndërkombëtare**

Në procesin e integrimit europian, raportimi dhe monitorimi përbëjnë një dimension të domosdoshëm, sepse përmes tyre matet jo vetëm përparimi teknik i një vendi, por edhe aftësia institucionale për të mbajtur një standard të qëndrueshëm e të besueshëm. Për këtë arsye, AMA ka ndërtuar një praktikë të konsoliduar raportimesh dhe kontributesh të rregullta, duke u kthyer në një prej institucioneve shqiptare që ofron informacion të strukturuar, të detajuar dhe të verifikueshëm për partnerët ndërkombëtarë.
Raportet e përgatitura nga AMA kanë mbuluar një gamë të gjerë temash që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë themelore. Për Agjencinë e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore (FRA), AMA ka dorëzuar raporte të detajuara mbi incidentet antisemitike dhe diskriminimin, duke kontribuar në hartimin e një tabloje sa më të plotë të situatës në vend. Për Komitetin e Ekspertëve të Këshillit të Europës

kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), AMA ka raportuar mbi zbatimin e Konventës kundër Trafikimit, me fokus në mbrojtjen e viktimave dhe në rolin e medias për rritjen e ndërgjegjësimit publik. Ndërkohë për Komisionin Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), AMA ka raportuar mbi fenomenin e gjuhës së urrejtjes në media, duke ofruar statistika, raste konkrete dhe masa të ndërmarra për parandalimin dhe adresimin e këtij fenomeni shqetësues.

Veç këtyre, AMA ka kontribuar edhe në procese të tjera të rëndësishme ndërkombëtare, si raportet për UNESCO dhe International IDEA, ku është kërkuar informacion mbi rolin e medias dhe rregullatorit në periudhat zgjedhore, mbi qeverisjen e platformave digjitale dhe mbi garantimin e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Këto raporte nuk kanë qenë thjesht formale, ato janë produkte të një pune të thellë analitike, që reflektojnë realitetin e tregut audioviziv shqiptar, duke vënë në dukje arritjet, por edhe sfidat. Pikërisht kjo transparencë e ka bërë AMA-n një partner të besueshëm në sytë e institucioneve ndërkombëtare, sepse integrimi nuk kërkon vetëm arritje, por edhe ndershmëri për të pranuar boshllëqet dhe për të punuar për mbushjen e tyre.

**Raportime periodike në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare dhe ndërinstitucionale**

- **Takime me Ministritë në kuadër të përafrimit të legjislacionit me acquis e BE - së**

Përgjatë gjithë vitit kalendarik 2025, AMA ka marrë pjesë në disa takime me Ministri të ndryshme, në kuadër të bashkëpunimit për përafrimin e legjislacionit të brendshëm për disa kapituj përafrimi, në të cilët AMA ka kontribut konkret. Konkretisht, janë zhvilluar takime me Ministrinë e Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Informacionit, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në lidhje me kapituj si: Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe liritë themelore", Kapitulli 28 "Mbrojtja e Konsumatorit", Kapitulli 7 "Pronësia Intelektuale", Kapitulli 10 "Transferimi digjital dhe media", etj.
Po ashtu Sektori i Legjislacionit Ndërkombëtar dhe Integrimit kryen raportime periodike 3-mujore dhe 6-mujore në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare sa i përket monitorimit dhe realizimit të masave institucionale të nevojshme për përmbushjen e objektivave dhe detyrave të lëna nga Komisioni Euroian në kuadër të procesit të integrimit, por dhe për çdo detyrim në fushën e mediave audiovizive. Si më poshtë listojmë kontributet periodike dhe të vazhdueshme:

- Shqyrtimi dhe hartimi i kontributit të Autoritetit të Mediave Audiovizive në kuadër të Kapitullit 23 "Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore", në gjuhën shqipe dhe angleze, sipas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë.
- Dërgimi i kontributit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën Janar – Dhjetor 2024 në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave 2024-2030, Planit të saj të Veprimit dhe Pasaportës së Indikatorëve, me shkresë zyrtare dhe elektronikisht.
- Kontribut në lidhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025 në kuadër të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda.
- Kontribut i Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën Janar – Dhjetor 2024 në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave 2024-2030, Planit të saj të Veprimit dhe Pasaportës së Indikatorëve.
- Shqyrtimi, hartimi dhe përditësimi i pozicionit Negociues për Cluster 3, Kapitulli 10 "Transferimi digjital dhe media".
- Kontribut i Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën Janar – Dhjetor 2024 në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021 – 2025.
- Kontribut i Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën Janar – Dhjetor 2024 në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI 2021 – 2027.
- Shqyrtimi, hartimi dhe përditësimi i pozicionit Negociues për Cluster 3, Kapitulli 10 "Transferimi digjital dhe media", në draftin e Pozicionit Negociues të Grupkapitullit 3.
- Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025 për periudhën korrik - dhjetor 2024, sipas kërkesës së dërguar nga Ministria e Brendshme.
- Shqyrtimi i Paketës finale PKIE 2025-2027 dhe Paketës Finale të Planit Menaxherial (Semestral) IE për

Forcimin e Kapaciteteve - PSIE 2025 për Kapitullin 31 "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes", sipas kërkesës së dërguar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

- Shqyrtimi dhe azhornimi i listës së Acquis-ve (jo-relevante) për t'u hequr nga platforma dhe listës së Aquis (relevante) që duhen shtuar në platformën e Integrimit Evropian në kuadër të Kapitullit 10 "Transferimi digjital dhe media".
- Kontribut në lidhje me pyetjet shtesë të dërguara nga Komisioni në lidhje me Media Pluralism në kuadër të Kapitullit 23 "Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore", sipas kërkesës së dërguar nga Ministria e Drejtësisë.
- Kontribut në lidhje me projekt-vendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin në parim të Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për inteligjencën artificiale, të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës".
- Kontribut i Autoritetit të Mediave Audiovizive për hartimin e raportit të veçantë të Avokatit të Popullit për gjendjen e të drejtave të pakicave kombëtare në Shqipëri gjatë periudhës 2020 – 2024.
- Kontribut i AMA-s në kuadër të raportimit për tremujorin e parë të vleresimit të kapaciteteve dhe pasaportës së indekseve PSIE janar-dhjetor 2025, për kapitullin 28 " Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik ".
- Kontribut i AMA-s në kuadër të raportimit për tremujorin e parë të vleresimit të kapaciteteve dhe pasaportës së indekseve PSIE janar-dhjetor 2025, për kapitullin 3 " E drejta e vendosjes dhe Liria për të ofruar shërbime ".
- Kontribut i AMA-s në kuadër të raportimit për Paketën Semestrale të Integrimit Evropian Janar – Mars 2025 referuar Kapitullit 7 "Pronësia Intelektuale".
- Kontribut i AMA-s në kuadër të raportimit për Paketën Semestrale të Integrimit Evropian Janar – Mars 2025 referuar masave të udhërrëfyesit FDI.
- Kontribut i AMA-s mbi masat e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike
- Kontributi i parë i AMA-s në kuadër të hartimit të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025, sipas pyetjeve përkatëse për Kapitullin 7 "E Drejta e Pronësisë Intelektuale" për periudhën 1 Shtator 2024 – 31 Mars 2025.
- Kontribut i AMA-s në kuadër të hartimit të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025, sipas pyetjeve përkatëse për Kapitullin 28 "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit" për periudhën 1 Shtator 2024 – 31 Mars 2025.
- Përgatitja e kontributit të parë të AMA-s në kuadër të hartimit të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025, sipas pyetjeve përkatëse për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" dhe masave të Udhërrëfyesit për "Funksionimin e Institucioneve Demokratike" për periudhën 1 Shtator 2024 – 31 Mars 2025.
- Rishikimi i kontributit të parë të AMA-s në kuadër të hartimit të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025, sipas pyetjeve përkatëse për Kapitullin 10 "Transformimi Digjital dhe Media" për periudhën 1 Shtator 2024 – 31 Mars 2025..
- Përgatitja e materialit përmbledhës në lidhje me ndryshimet e ndodhura në ligjin për median apo propozime për ndryshime të tjera për përafrimin me aktet e BE, Direktivën AVMSD të ndryshuar dhe EMFA.
- Kontribut mbi draft raportin e monitorimit për periudhën janar- dhjetor 2024, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024-2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 13.12.2023 "Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024-2030, Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve".
- Përgatitja e materialit përmbledhës lidhur me impaktin e politikave dhe legjislacionit të BE-së në përafrimin e kuadrit të brenshëm rregullator në fushën e medias në vendet e Ballkanit Perëndimor.
- Kontribut mbi draftin e Rules of Procedure për ERGA SG2, me fokus të veçantë në disa nene specifike të Aktit Evropian për Lirinë e Medias (EMFA).
- Kontribut në kuadër të hartimit të raportit të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026, për periudhën janar–dhjetor 2024.
- Pjesëmarrja në takimin e Nënkomitetit "Drejtësi, Liri dhe Siguri".
- Pjesëmarrja në takimin e 16-të të EMIL mbi mbrojtjen e fëmijëve në hapësirën digjitale.

- Përgatitja e dokumentit të raportimit për tremujorin e parë të vitit 2025, me fokus Kapitullin 10, "Transferimi digjital dhe media".
- Përgatitja e dokumenteve mbi lirinë editoriale, pavarësinë e autoritetit, pluralizmin mediatik, reklamën institucionale dhe strukturën pronësore, duke u bazuar në parashikimet e EMFA-s dhe AVMSD-së.
- Pjesëmarrja në takimin e GFN-UNESCO mbi "AI Companion Document" dhe planin e punës së MIL.
- Kontribut institucional i AMA-s për Guiding Questions me fokus Kapitullin 10, "Transferimi digjital dhe media".

- **Periudha Prill – Qershor 2025**

- Përgatitja e hartëzimit (mapping tool) të kërkuar nga Agjencia Europiane e të drejtave themelore (FRA) sa i përket AMA-s në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave themelore në Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet me statusin e vëzhguesit.
- Hartimi i kontributit të parë të progres raportit për të drejtat e njeriut për periudhën Prill 2024 – Mars 2025, sipas kërkesës së dërguar nga Ministria e Drejtësisë.
- Shqyrtimi i Planit Kombëtar të Veprimit për tre shtyllat "Mirëqeverisje, Antikorrupsion dhe Sundimit i ligjit" të hartuar në kuadër të Komisionit të Posaçëm "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian".
- Kontribut i veprimtarisë institucionale të AMA-s për Guiding Questions referuar lirisë së shprehjes për periudhën Shtator 2024 – Mars 2025.
- Shqyrtimi i draft Raportit të Monitorimit për periudhën Janar – Dhjetor 2024, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, duke bërë edhe sugjerimet përkatëse.
- Dhënia e përgjigjeve sa i përket veprimtarisë institucionale të AMA-s në lidhje me sesionin e EPRA "VSP & Social Media, Protecting Children Online".
- Shqyrtimi i komenteve përfundimtare të raportit të GRETA-s për Shqipërinë, të hartuar në zbatim të nenit 38, paragrafi 6 i Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Rregullores së Procedurës së GRETA-s për vlerësimin e zbatimit të Konventës dhe bërja e komenteve përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë.
- Kontribut për projekt ligjin për Barazinë Gjinore të dërguar për mendim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe bërja e komenteve përkatëse.
- Kontribut për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit sa i përket masave të parashikuara për t'u përfshirë në PKABE për Kapitullin 3.
- Përgatitja e materialit për ndryshime/shtesa në ligjin nr. 97/2013, i ndryshuar në kuadër të përafrimit me legjislacionin e BE sa i përket forcimit të pavarësisë editoriale në media, pavarësisë së rregullatorit, transparencës në alokimin e fondeve publike dhe reklama institucionale, transparencës së pronësisë së medias dhe matjes së audiencës.
- Përgatitja e kontributit të AMA-s referuar PSIE për periudhën Prill – Qershor 2025 sa i përket Kapitullit 7 "Pronësia Intelektuale", sipas kërkesës së dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale.
- Shqyrtimi dhe bërja e komenteve përkatëse lidhur me draft rregulloren e brendshme të AMA-s.
- Përgatitja e komenteve lidhur me Dokumentin Informues për Grupet e Punës së projektit të përbashkët BE/KE mbi "Promovimin e Lirisë së Shprehjes në Shqipëri përmes Dialogut të Hapur".
- Përgatitja e kontributit të AMA-s mbi adresimin e piketave mbyllëse lidhur me kapitullin 10 "Transformimi Digjital dhe Media" në vijim të Qëndrimit të përbashkët të Komisionit Evropian lidhur me Grupkapitullin 3 "Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse", si dhe përgatitja e Planit të Punës për adresimin e piketave mbyllëse të paraqitura në këtë dokument.
- Përgatitja e kontributit të AMA-s në kuadër të "Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025", për vitin 2025, për të proceduar më tej me mbledhjen e radhës së grupit të punës.
- Përgatitja e raportimit periodik për periudhën Prill–Qershor 2025 për monitorimin dhe vlerësimin e

ecurisë së zbatimit të masave të udhërrëfyesit FDI në kuadër të Paketës Semestrale për Integrimin Evropian (PSIE).

- Përgatitja e kontributit të AMA-s në lidhje me përditësimin e masave të udhërrëfyesit Rule of Laë, i cili është përcjellë pranë Komisionit në raportimin e fundit sipas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë.
- Pjesëmarrja në takimin tematik të zhvilluar pranë Ministrisë për Punët e Jashtme në kuadër të vizitës monitoruese të ECRI, si dhe përgatitja e informacionit përkatës për Kryetaren.
- Kontribut lidhur me përgatitjen e përmbledhjes së Udhëzuesit për administrimin e platformave digjitale të përgatitur nga UNESCO me fokus bashkërregullimin.
- Kontribut për periudhën Prill–Qershor 2025, në kuadër të vlerësimit të kapaciteteve dhe pasaportës së indekseve për Kapitullin 10 "Transformimi Digjital dhe Media".
- Inputi për raportin vjetor të FRA mbi incidentet antisemitike për periudhën 2023–2024, bazuar në monitorime dhe bashkëpunime institucionale.
- Kontribut për masat rregullatore kundër trafikimit të fëmijëve, barazinë gjinore dhe sigurinë e fëmijëve në hapësirën digjitale, mbi agjenden e dates 9 prill 2025.
- Kontribut mbi rregullimin e platformave online, përfshirë masat për transparencë dhe mbrojtje ndaj përmbajtjeve të dëmshme.
- Përgatitja e kontributit të AMA-s në kuadër të hartimit të PSIE për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" për periudhën Prill – Qershor 2025.
- Përgatitja e raportit të progresit lidhur me të drejtat e njeriut duke u fokusuar në veprimtarinë e AMA-s.
- Përgatitja e dokumentit mbi "Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025", me fokus masat e ndërmarra nga AMA.
- Vlerësimi i draft-raportit të monitorimit për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit, për periudhën korrik–dhjetor 2024.
- Përgatitja e planit të punës për adresimin e piketave mbyllëse të Grupkapitullit të II-të.
- Hartimi i kornizës së DSA-së bazuar në praktikat dhe eksperiencat e AGCOM.
- Pjesëmarrja në takimin online të grupit të MNRA-së mbi temën "Gjinia dhe Media".
- Pjesëmarrja në workshopin për përgatitjen e planit të punës mbi adresimin e piketave mbyllëse të Kapitullit 28, "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik".
- Pjesëmarrja në takimin e 16-të të EMIL mbi temat specifike të përfshira në programin e punës 2025 të EPRA-s.
- Përgatitja e një materiali të detajuar mbi prezantimin e Country Report për AMA-n.
- Përgatitja e komenteve mbi dokumentin informues për Promovimin e Lirisë së Shprehjes në Shqipëri, përmes Dialogut të Hapur
- Vlerësimi i draftit të planit të punës për adresimin e piketave mbyllëse të Kapitullit 3.
- Vlerësimi i kapaciteteve dhe përgatitja e pasaportës së indekseve PSIE për periudhën prill–qershor 2025, në lidhje me Kapitullin 28, "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik".
- Pjesëmarrja në workshopin për përgatitjen e planit të punës mbi adresimin e kritereve mbyllëse, Kapitulli 7 "Pronësia Intelektuale".
- Raportimi mbi hartimin dhe dërgimin e Planit të Punës për përkthimin e acquis.
- Përgatitja e ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, duke përfshirë ndryshimet e propozuara dhe komentet nga eksperti, në gjuhën shqipe.
- Përgatitja e materialit mbi përafrimet mes DSA-së dhe ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar.
- Hartimi i tabelës së përputhshmërisë midis DSA-së dhe ligjit nr. 97/2013, duke përfshirë draft-propozimet për ndryshimet në ligj.
- Kontribut për Kapitullin 3, "E drejta e vendosjes dhe Liria për të ofruar shërbime", me fokus bashkërendimin e nismave të bashkëpunimit ndërkombëtar të natyrës Peer-to-Peer, përmes programeve të shkëmbimit dhe mekanizmave të TAIEX dhe Tëinning/binjakëzimeve institucionale.

- **Periudha Korrik - Shtator 2025**

- Përgatitja e raportimit për ndërveprimet ekzistuese apo të planifikuara me homologët përkatës në shtetet anëtare të BE-së, referuar kërkesës së përcjellë nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator për bashkërendimin e bashkëpunimeve ndërinstitucionale me vendet anëtare të Bashkimit Evropian në kuadër të integrimit të përshpejtuar, sa i përket Kapitullit 10, Kapitullit 28, Kapitullit 7, Kapitullit 23 dhe FDI.
- Përditësimi i listës së OSHMA-ve ku janë pasqyruar të dhënat e subjekteve juridikë, lloji, struktura pronësore, kuotat përkatëse të ortakëve apo aksionarëve, si dhe pronarët përfitues, përfshirë llojin e pronësisë dhe përqindjet përkatëse sipas të dhënave të deklaruara nga vetë subjektet tregtare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Ndjekja e workshop dyditor trajnues në kuadër të projektit "Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias në Shqipëri (PRO-FREX)", pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Faciliteti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë" (Horizontal Facility III), workshop i organizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), i cili synon të rrisë kapacitetet e AMA-s për të përmbushur funksionin e saj si rregullator i medias, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga statusi i Shqipërisë si vend kandidat për në Bashkimin Evropian, veçanërisht për transpozimin e Aktit Europian për Lirinë e Medias (EMFA) dhe Aktit për Shërbimet Digjitale (DSA) në kuadrin ligjor kombëtar.
- Kontributi i Autoritetit të Mediave Audiovizive për raportim në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave 2024 – 2027.
- Shqyrtimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 dhe masat e parashikuara për AMA, në kuadër të raportimit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, për periudhën deri më 30 qershor 2025 për Kapitullin 10 "Transformimi digjital dhe media".
- Kontribut në mbyllje të takimeve tematike të zhvilluara me Delegacionin e ECRI sa i përket bashkëpunimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me AMA me qëllim parandalimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe dhunës në median online.
- Përgatitja e informacionit lidhur me ecurinë e procesit për hartimin e projekt - ligjit të ri "Për barazinë gjinore", ku Autoriteti i Mediave Audivizive ka dhënë kontributin e tij si pjesë e grupit ndërinstitucional të punës.
- Dhënia e kontributit të AMA-s në kuadër të hartimit të raportit të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, për periudhën Janar-Qershor 2025, në përputhje me Planin e Veprimit.
- Përgatitja e kontributit të dytë të AMA-s për periudhën Prill - Shtator 2025 në kuadër të Progres Raportit për Shqipërinë për Kapitullin 7 "Pronësia intelektuale".
- Përgatitja e kontributit të dytë të AMA-s për periudhën Prill - Shtator 2025 në kuadër të Progres Raportit për Shqipërinë për Kapitullin 10 "Transformimi digjital dhe media".
- Përgatitja e kontributit të dytë të AMA-s për periudhën Prill - Shtator 2025 në kuadër të Progres Raportit për Shqipërinë për FDI.
- Rishikimi i Planit të Veprimit për Kapitullin 7 "Pronësia Intelektuale" dhe përditësimi i aktiviteteve të parashikuara nga AMA.
- Dhënia e kontributit lidhur me informacionin për prezantim në BRAF për sa i përket citimit në raportet e BE apo raporte të tjera përmbledhëse në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe respektimin e të drejtës për informim.
- Përgatitja e kontributit të AMA-s lidhur me plotësimin e raportimit për 3 mujorin Korrik – Shtator 2025 për PSIE 2025 në kuadër të Kapitullit 10 "Transformimi digjital dhe media"
- Përditësimi i aktiviteteve të AMA-s në planin e punës për Kapitullin 10 "Transformimi digjital dhe media", sipas kalendarit/afateve të përcaktuara deri në Shtator 2025.
- Rishikimi dhe kontribut lidhur me projekt ligjin "Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", për të cilin AMA është në grup pune.
- Përgatitja e materialit në kuadër të hartimit të kontributit të Raportit për Kuvendin e Shqipërisë lidhur me procesin e integrimit evropian dhe negociatave për 3MIII 2025 lidhur me Kapitullin 28.

- Përgatitja e kontributit të AMA lidhur me monitorimin e zbatimit të masave politiko-ligjore të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 për Kapitullin 10.
- Plani i Veprimit për mbrojtjen e të miturve

U përgatit, u plotësua dhe u përditësua raportimi mbi zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për të Drejtat e Fëmijës (SNDM), për periudhën janar–qershor 2025, me fokus në mbrojtjen e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme në mjedisin audioviziv.

- Kontribut për "Annex–Guiding Questions, Chapter 10–rev. 2025", duke reflektuar progresin në fushën e medias dhe lirisë së shprehjes.
- Kontributi për Clusterin 1–The Fundamentals of the Acession Process

AMA kontribuoi në përgatitjen e materialeve lidhur me funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformën e administratës publike, si pjesë e raportimit kombëtar për procesin e anëtarësimit në BE

- Guiding Questions–Chapter 3: Right of Establishment and Freedom to Provide Services
  U përgatitën dhe u dorëzuan materialet dhe komentet për pyetjet udhëzuese në kuadër të Kapitullit 3, duke reflektuar situatën aktuale dhe praktikat rregullatore në fushën e shërbimeve audiovizive, me theks tek liria e ofrimit të shërbimeve.
- Guiding Questions–Chapter 7: Intellectual Property Law

U plotësua me informacion dhe analiza mbi mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale në fushën e medias audiovizive, duke theksuar masat e marra kundër piraterisë televizive dhe përmirësimet e fundit në rregullore

- Cluster 1: The Fundamentals of the Açession Process–Functioning of Democratic Institutions and Public Administration Reform

U përgatit dhe u përcoll raportimi për Clusterin 1, me fokus tek roli i AMA-s në forcimin e funksionimit të institucioneve demokratike, respektimin e lirisë së shprehjes dhe transparencës, si dhe përpjekjet për modernizimin e administratës dhe rritjen e llogaridhënies institucionale.

- Pjesëmarrja në High-Level Seminar, Side Event i Tirana Connectivity Forum 2025

Pjesëmarrja në nivel institucional në seminarin e nivelit të lartë "Implementation, Monitoring and Evaluation Experience in the context of the Recovery and Resilience Facility and the Reform and Groëth Facility". Kontributi i AMA-s lidhej me shkëmbimin e përvojës institucionale mbi monitorimin dhe raportimin e politikave publike dhe reformat strukturore.

- Tryeza e Informimit dhe Konsultimit për Kapitullin 28 / Platforma e Partneritetit të Integrimit Europian

Pjesëmarrja në Takimin Konsultues #3 me temë "Reforma legjislative në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve". Kontributi i Autoritetit u fokusua në mbrojtjen e konsumatorëve të medias audiovizive, sidomos në drejtim të transparencës së shërbimeve dhe respektimit të të drejtave të audiencës.

- PSIE – Planifikimi i FDI 2025

Kontributi në procesin e planifikimit strategjik të FDI, duke evidentuar prioritetet që lidhen me fushën e medias audiovizive, me theks tek rritja e transparencës, mbrojtja e të drejtave të audiencës dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për zbatimin e standardeve të BE-së.

- PSIE – Kapitulli 23

Në kuadër të Kapitullit 23, u përgatitën materiale për progresin e arritur në garantimin e lirisë së shprehjes dhe mbrojtjen e të drejtave themelore. Raportimi theksoi masat e ndërmarra për përmirësimin e transparencës në fushën e pronësisë së mediave, forcimin e mekanizmave kundër gjuhës së urrejtjes dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare mbi pluralizmin mediatik

- PSIE – Kapitulli 7

U përditësuan masat kundër piraterisë dhe forcimin e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale. U theksuan amendimet e fundit në rregulloren "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve", të cilat konsolidojnë kuadrin ligjor për mbrojtjen e të drejtave të autorit në tregun audioviziv.

- Baza ligjore për luftën kundër gjuhës së urrejtjes

Ky kontribut konsiston me një analizë të dispozitave ligjore dhe rregullatore që adresojnë gjuhën e urrejtjes në transmetimet audiovizive, duke iu referuar Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në

Republikën e Shqipërisë", Kodit të Transmetimit, si dhe instrumenteve ndërkombëtare për të cilat Shqipëria është palë. Ky kontribut synon forcimin e kuadrit të mbrojtjes së të drejtave të audiencës dhe respektimin e dinjitetit njerëzor.

- Kap. 23 – PSIE

Raportimi insitucional për këtë kapitull theksoi rolin e institucionit në garantimin e standardeve demokratike nëpërmjet mbikëqyrjes së shërbimeve audiovizive, me fokus tek liria e medias, transparenca dhe mbrojtja e grupeve të cenueshme, përfshirë të miturit.

- Ndjekja e ëorkshop-it dyditor mbi "Transpozimin e EMFA-s dhe DSA-së në Ligjin Mediatik Shqiptar: Sfidat, Mundësitë dhe Rruga drejt Standardeve Evropiane", më 2-3 korrik, organizuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA).
- Kontribut në takimin e organizuar nga GFN – UNESCO mbi "Reinvigorating Efforts for Rights-Respecting Platform Governance in Practice", më datë 26.06.2025.
- Përgatitja e kontributit të AMA-s lidhur me plotësimin e raportimit 6-mujor (janar-qershor 2025) të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024-2025.
- Përgatitja e kontributit të AMA-s lidhur me hartimin e kontributit të dytë të qeverisë shqiptare për raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2025, Kapitulli 28 "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit publik".
- Përgatitja e kontributit të AMA-s lidhur me hartimin e kontributit të dytë të qeverisë shqiptare për raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2025, Kapitulli 3.
- Përgatitja e kontributit të AMA-s lidhur me hartimin e kontributit të dytë të Progres Raportit 2025, Kapitulli 10 "Transformimi digjital dhe media".
- Pergatitja e kontributit të dytë prill – shtator 2025, për Kapitullin 7 "Pronësia Intelektuale".
- Pergatitja e kontributit të dytë prill – shtator 2025, për Kapitullin 10 "Transformimi digjital dhe media".
- Përgatitja e kontributit të AMA-s mbi raportimin periodik në kuadër të PSIE, korrik-shtator 2025, për FDI-në.
- Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga EMIL mbi temën "Edukimi Mediatik & Influencerat".
- Pjesëmarrja në takimin e Komitetit të Monitorimit të RGF-së për vitin 2025.
- Përgatitja e përmbledhjes ligjore bazuar në Ligjin nr. 97/2013, "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodin e Transmetimit, mbi mbrojtjen e të miturve online.

**Periudha Tetor - Dhjetor 2025**

- Kontribut në lidhje me implementimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI 2021 – 2027.
- Rishikimi i Planit të Veprimit për Kapitullin 10 në kuadër të takimit të datës 6 Nëntor me shërbimet e Komisionit BE.
- Kontribut në "Monitoring Albania's Reform Agenda: First RGF Monitoring Report",
- Kontribut i Autoritetit të Mediave Audiovizive në kuadër të hartimit të raportit të gjashtë periodik mbi zbatimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.
- Monitorimi i zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, në kuadër të Kapitullit 10 "Transformimi digjital dhe media", sipas fushës së përgjegjësisë së AMA-s.

· Shqyrtimi i përmbajtjes së neneve të projektligjit të riformatuar "Për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", në vijim të komenteve dhe sugjerimeve të mëparshme të dhëna nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, si dhe parashtrimi i komenteve të mëtejshme për reflektim.

· Kontribut në lidhje me projektligjin "Për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje".

- Rishikimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, në kuadër të Kapitullit 10 "Transformimi digjital dhe media", sipas fushës së përgjegjësisë së AMA-s, lidhur me aktet e planifikuara për miratim nga institucioni.
- Përgatitja e komenteve në lidhje me pikat e evidentuara në raportin e Komisionit Evropian 2025 që lidhen drejtpërdrejt me sferën e veprimtarisë së AMA-s.

- Përditësimi dhe plotësimi i tabelës së masave të parashikuara për AMA-n në Interim Benchmarks të kërkuar nga Komisioni Evropian.
- Pjesëmarrja në takimet periodike online të organizuara nga GFN-UNESCO .
- Hartimi i përgjigjeve të detajuara për pyetjet e dërguara nga rregullatori spanjoll CNMC, që lidhen me masat dhe metodat e zbatuara në fushën e edukimit mediatik.
- Përgatitja e tabelave të detajuara të përputhshmërisë për ndryshimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të hartuara në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Pjesëmarrja në takimin online të organizuar nga Medienrat mbi "Media regulators in the digital society: between content and network regulation – Concepts, poëers, legal status and resources, roles and tasks, cooperation".
- Përgatitja e një vlerësimi analitik mbi zgjerimin e Aneksit II, Skeduli i Angazhimeve Specifike të Tregtisë së Shërbimeve, duke shqyrtuar implikimet për përfshirjen e sektorit të shërbimeve audiovizive, i dërguar nga sekretariati i CEFTA.
- Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga CDI mbi "Monitoring Albania's Reform Agenda: First RGF Monitoring Report", më datë 20 tetor 2025.
- Pjesëmarrja në mbledhjen e grupit të punës për Programin e Vetëvrasjeve 2025-2030, për shqyrtimin dhe diskutimin e masave dhe aktivitetetve të parashikuara në bashkëpunim me AMA-n.
- Plotësimi i raportimit mbi procesin e monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, duke u fokusuar në realizimin e masave të parashikuara për AMA-n.
- Vlerësimi i factsheet të dërguar nga Observatori mbi AMA-n, për një studim që do të kryejë Observatori Audioviziv Evropian, në përputhje me kërkesën e Komisionit Evropian.
- Vlerësimi i planit të masave të parashikuara për AMA-n mbi ndryshimet ligjore ose aktet nënligjore për Kapitullin 10 "Shoqëria e Informacionit dhe Media".
- Përgatitja e kontributit të AMA për Raportin drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për tremujorin e katërt të vitit 2025, në kuadër të Kapitullit 10, në lidhje me zhvillimet/arritjet për miratimin e akteve ligjore që synojnë përafrimin, si dhe aktivitetet në kuadër të forcimit të kapaciteteve për tremujorin e katërt të vitit 2025.
- Rishikimi i kontributit të AMA-s për periudhën tetor-dhjetor 2025 në kundër të Kapitullit 31 "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes".
- Rishikimi i draft ligjit për ndryshimet ligjore dhe përpunimi i mëtejshëm, në vijim të rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe sugjerimeve të ekspertit të BE, për t'u dërguar sërish pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Dhënia e kontributit në lidhje me Planin e Veprimit për Kapitullin 10 "Transformimi digjital dhe media", referuar masave të parashikuara ligjore.
- Plotësimi i listës së programeve të bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional "Peer-to-Peer" të AMA për Kapitullin 10 "Transformimi Digjital dhe Media".
-

Në vijim të detyrave funksionale, Drejtoria e Legjislacionit Europian dhe Marrëdhenive me Jashtë ka vijuar të mbajë e të konsolidojë marrëdhënie bashkëpunimi me rrjetet dhe organizatat ndërkombëtare të rëndësishme në fushën e medias dhe komunikimeve, si Platforma Europianë e Rrjeteve Rregullatore (EPRA), Bordi Europian i Shërbimeve Mediatike (EMSB), Këshilli i Europës (CoE), si dhe me rregullatorët homologë të vendeve anëtare të BE-së dhe rajonit. Ky bashkëpunim është konkretizuar përmes pjesëmarrjeve periodike në takime plenare, grupe pune dhe konsultime teknike, dhënies së kontributeve analitike në kuadër të nismave të përbashkëta europiane, si dhe kthimit të menjëhershëm të çdo kërkese apo kontakti zyrtar nga partnerët ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, janë përgatitur materiale, analiza dhe propozime që mbështesin procesin e përafrimit të kuadrit ligjor kombëtar me aktet e BE-së, përfshirë hartimin e draft-rregulloreve të reja dhe akteve nënligjore, të cilat synojnë të forcojnë zbatimin praktik të EMFA, DSA dhe Direktivës së përditësuar AVMSD në Shqipëri.
Në mënyrë të vazhdueshme, sektori ka kontribuar në:

- Përditësimi dhe plotësimi i tabelës së masave të parashikuara për AMA-n në Interim Benchmarks të kërkuar nga Komisioni Evropian.
- Pjesëmarrja në takimet periodike online të organizuara nga GFN-UNESCO .
- Hartimi i përgjigjeve të detajuara për pyetjet e dërguara nga rregullatori spanjoll CNMC, që lidhen me masat dhe metodat e zbatuara në fushën e edukimit mediatik.
- Përgatitja e tabelave të detajuara të përputhshmërisë për ndryshimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të hartuara në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Pjesëmarrja në takimin online të organizuar nga Medienrat mbi "Media regulators in the digital society: between content and network regulation – Concepts, poëers, legal status and resources, roles and tasks, cooperation".
- Përgatitja e një vlerësimi analitik mbi zgjerimin e Aneksit II, Skeduli i Angazhimeve Specifike të Tregtisë së Shërbimeve, duke shqyrtuar implikimet për përfshirjen e sektorit të shërbimeve audiovizive, i dërguar nga sekretariati i CEFTA.
- Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga CDI mbi "Monitoring Albania's Reform Agenda: First RGF Monitoring Report", më datë 20 tetor 2025.
- Pjesëmarrja në mbledhjen e grupit të punës për Programin e Vetëvrasjeve 2025-2030, për shqyrtimin dhe diskutimin e masave dhe aktivitetetve të parashikuara në bashkëpunim me AMA-n.
- Plotësimi i raportimit mbi procesin e monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, duke u fokusuar në realizimin e masave të parashikuara për AMA-n.
- Vlerësimi i factsheet të dërguar nga Observatori mbi AMA-n, për një studim që do të kryejë Observatori Audioviziv Evropian, në përputhje me kërkesën e Komisionit Evropian.
- Vlerësimi i planit të masave të parashikuara për AMA-n mbi ndryshimet ligjore ose aktet nënligjore për Kapitullin 10 "Shoqëria e Informacionit dhe Media".
- Përgatitja e kontributit të AMA për Raportin drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për tremujorin e katërt të vitit 2025, në kuadër të Kapitullit 10, në lidhje me zhvillimet/arritjet për miratimin e akteve ligjore që synojnë përafrimin, si dhe aktivitetet në kuadër të forcimit të kapaciteteve për tremujorin e katërt të vitit 2025.
- Rishikimi i kontributit të AMA-s për periudhën tetor-dhjetor 2025 në kundër të Kapitullit 31 "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes".
- Rishikimi i draft ligjit për ndryshimet ligjore dhe përpunimi i mëtejshëm, në vijim të rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe sugjerimeve të ekspertit të BE, për t'u dërguar sërish pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Dhënia e kontributit në lidhje me Planin e Veprimit për Kapitullin 10 "Transformimi digjital dhe media", referuar masave të parashikuara ligjore.
- Plotësimi i listës së programeve të bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional "Peer-to-Peer" të AMA për Kapitullin 10 "Transformimi Digjital dhe Media".
-

Në vijim të detyrave funksionale, Drejtoria e Legjislacionit Europian dhe Marrëdhenive me Jashtë ka vijuar të mbajë e të konsolidojë marrëdhënie bashkëpunimi me rrjetet dhe organizatat ndërkombëtare të rëndësishme në fushën e medias dhe komunikimeve, si Platforma Europianë e Rrjeteve Rregullatore (EPRA), Bordi Europian i Shërbimeve Mediatike (EMSB), Këshilli i Europës (CoE), si dhe me rregullatorët homologë të vendeve anëtare të BE-së dhe rajonit. Ky bashkëpunim është konkretizuar përmes pjesëmarrjeve periodike në takime plenare, grupe pune dhe konsultime teknike, dhënies së kontributeve analitike në kuadër të nismave të përbashkëta europiane, si dhe kthimit të menjëhershëm të çdo kërkese apo kontakti zyrtar nga partnerët ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, janë përgatitur materiale, analiza dhe propozime që mbështesin procesin e përafrimit të kuadrit ligjor kombëtar me aktet e BE-së, përfshirë hartimin e draft-rregulloreve të reja dhe akteve nënligjore, të cilat synojnë të forcojnë zbatimin praktik të EMFA, DSA dhe Direktivës së përditësuar AVMSD në Shqipëri.
Në mënyrë të vazhdueshme, sektori ka kontribuar në:

- koordinimin e përgjigjeve institucionale ndaj çdo kërkese të Komisionit Europian, Këshillit të Europës, UNESCO-s apo organizatave partnere;
- përgatitjen e materialeve të ekspertizës që mbështesin AMA-n në procesin e vendimmarrjes dhe në hartimin e politikave të reja rregullatore;
- ngritjen e urave të qëndrueshme të bashkëpunimit me rregullatorët homologë përmes marrëveshjeve dypalëshe, shkëmbimeve profesionale dhe pjesëmarrjes në rrjetet evropiane të rregullatorëve.

**AMA-BE, takime dypalëshe screening me shërbimet e Komisionit Europian (DG NEAR dhe DG CONNECT)**

- Në periudhën janar–dhjetor 2025, përfaqësues të AMA-s kanë raportuar në takimet dypalëshe screening me shërbimet e Komisionit Europian (DG NEAR dhe DG CONNECT) mbi progresin e arritur nga ana e institucionit në aspekte të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me acquis e BE-së dhe zbatueshmërinë e masave të vendosura, për disa kapituj përafrimi, në të cilët AMA ka kontribut konkret (Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe liritë themelore", Kapitulli 10 "Shoqëria e Informacionit dhe Media", Kapitulli 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria", Kapitulli 7 "Pronësia Intelektuale", Kapitulli 28 "Mbrojtja e Konsumatorit", Kapitulli 31 "Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes" etj.).
- Në qendër të këtyre takimeve ka qenë ecuria e zbatimit të standardeve të lirisë së shprehjes dhe medias, edukimi mediatik, transparenca e pronësisë së medias, matja e shikueshmërisë në kuptim të transparencës së tregut mediatik, monitorimi i medias gjatë proceseve zgjedhore, shoqëria e informacionit, funksionimi i institucioneve demokratike, etj. Përgjatë këtij procesi, që ende vazhdon, AMA është vlerësuar maksimalisht nga Institucionet e Bashkimit Europian për rolin dhe ndikimin në përparimin në këto drejtime, të cilat janë me rëndësi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë.

- **Sesioni plenar i Konventës Kombëtare për Integrimin Europian**

Gjatë vitit raportues 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive mori pjesë në Sesionin Plenar të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian, në kuadër të mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional për procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Ky sesion shërbeu si forum diskutimi mbi ecurinë e reformave dhe prioritetet sektoriale që lidhen me përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Europian. Në këtë kontekst, u trajtuan edhe çështje që lidhen me sektorin audioviziv, përfshirë zhvillimet në kuadrin ligjor dhe rregullator, funksionimin e tregut audioviziv dhe rolin e autoriteteve rregullatore në zbatimin e standardeve europiane. Kontributi i AMA-s në këto diskutime u fokusua në nevojën për harmonizim gradual të kuadrit institucional, forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe përputhshmërinë e politikave sektoriale me objektivat e procesit të integrimit europian.

Prej vitit 2015 Autoriteti vijon bashkëpunimin me institucione dhe organizata, të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias, duke zhvilluar projekte për përmirësimin e infrastrukturës mediatike, promovimin e standardeve të larta etike në fushën e mediave me fokus aspekte të ndryshme të tregut audio dhe audioviziv, hulumtime, studime dhe analiza të fenomeneve dhe zhvillimeve të kohës, publikime në shqip të literaturës së huaj mbi median etj.

**11.4 AMA në bashkëpunim me partnerët**

Projektet e realizuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në bashkëpunim me subjektet që kryejnë veprimtari në fushën e medias kanë si qëllim realizimin e studimeve dhe kërkimeve sasiore dhe cilësore, aktiviteteve kualifikuese dhe trajnuese, fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese, botimeve dhe përkthimeve në fushën e medias.

Gjatë vitit 2025 u finalizuan shtatë projekte me kontrata të lidhura në vitin 2024 në drejtimet e mëposhtme:

**a) "Transmetimet Audiovizive dhe Inteligjenca Artificiale"**

U realizua studimi "Inteligjenca Artificiale në Mediat Audiovizive Shqiptare, Sprovat e Para", studim i cili nxori në pah dijen në lidhje me Inteligjencën Artificiale (IA) dhe përfshirjen e saj në media e konkretisht në

- ecurisë së zbatimit të masave të udhërrëfyesit FDI në kuadër të Paketës Semestrale për Integrimin Evropian (PSIE).
- Përgatitja e kontributit të AMA-s në lidhje me përditësimin e masave të udhërrëfyesit Rule of Laë, i cili është përcjellë pranë Komisionit në raportimin e fundit sipas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë.
- Pjesëmarrja në takimin tematik të zhvilluar pranë Ministrisë për Punët e Jashtme në kuadër të vizitës monitoruese të ECRI, si dhe përgatitja e informacionit përkatës për Kryetaren.
- Kontribut lidhur me përgatitjen e përmbledhjes së Udhëzuesit për administrimin e platformave digjitale të përgatitur nga UNESCO me fokus bashkërregullimin.
- Kontribut për periudhën Prill–Qershor 2025, në kuadër të vlerësimit të kapaciteteve dhe pasaportës së indekseve për Kapitullin 10 "Transformimi Digjital dhe Media".
- Inputi për raportin vjetor të FRA mbi incidentet antisemitike për periudhën 2023–2024, bazuar në monitorime dhe bashkëpunime institucionale.
- Kontribut për masat rregullatore kundër trafikimit të fëmijëve, barazinë gjinore dhe sigurinë e fëmijëve në hapësirën digjitale, mbi agjenden e dates 9 prill 2025.
- Kontribut mbi rregullimin e platformave online, përfshirë masat për transparencë dhe mbrojtje ndaj përmbajtjeve të dëmshme.
- Përgatitja e kontributit të AMA-s në kuadër të hartimit të PSIE për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" për periudhën Prill – Qershor 2025.
- Përgatitja e raportit të progresit lidhur me të drejtat e njeriut duke u fokusuar në veprimtarinë e AMA-s.
- Përgatitja e dokumentit mbi "Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025", me fokus masat e ndërmarra nga AMA.
- Vlerësimi i draft-raportit të monitorimit për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit, për periudhën korrik–dhjetor 2024.
- Përgatitja e planit të punës për adresimin e piketave mbyllëse të Grupkapitullit të II-të.
- Hartimi i kornizës së DSA-së bazuar në praktikat dhe eksperiencat e AGCOM.
- Pjesëmarrja në takimin online të grupit të MNRA-së mbi temën "Gjinia dhe Media".
- Pjesëmarrja në workshopin për përgatitjen e planit të punës mbi adresimin e piketave mbyllëse të Kapitullit 28, "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik".
- Pjesëmarrja në takimin e 16-të të EMIL mbi temat specifike të përfshira në programin e punës 2025 të EPRA-s.
- Përgatitja e një materiali të detajuar mbi prezantimin e Country Report për AMA-n.
- Përgatitja e komenteve mbi dokumentin informues për Promovimin e Lirisë së Shprehjes në Shqipëri, përmes Dialogut të Hapur
- Vlerësimi i draftit të planit të punës për adresimin e piketave mbyllëse të Kapitullit 3.
- Vlerësimi i kapaciteteve dhe përgatitja e pasaportës së indekseve PSIE për periudhën prill–qershor 2025, në lidhje me Kapitullin 28, "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik".
- Pjesëmarrja në workshopin për përgatitjen e planit të punës mbi adresimin e kritereve mbyllëse, Kapitulli 7 "Pronësia Intelektuale".
- Raportimi mbi hartimin dhe dërgimin e Planit të Punës për përkthimin e acquis.
- Përgatitja e ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, duke përfshirë ndryshimet e propozuara dhe komentet nga eksperti, në gjuhën shqipe.
- Përgatitja e materialit mbi përafrimet mes DSA-së dhe ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar.
- Hartimi i tabelës së përputhshmërisë midis DSA-së dhe ligjit nr. 97/2013, duke përfshirë draft-propozimet për ndryshimet në ligj.
- Kontribut për Kapitullin 3, "E drejta e vendosjes dhe Liria për të ofruar shërbime", me fokus bashkërendimin e nismave të bashkëpunimit ndërkombëtar të natyrës Peer-to-Peer, përmes programeve të shkëmbimit dhe mekanizmave të TAIEX dhe Tëinning/binjakëzimeve institucionale.

edhe multimediale. Nevoja për një përdorim më efikas të brezit të frekuencave dhe transmetimin e një volum më të madh të dhënash, nga njëra anë shpreh një domosdoshmëri, ndërsa nga ana tjetër tregon limitet dhe kufizimet e teknologjisë së konsoliduar FM.

Në këtë kontekst, avancimi i teknologjisë ka sjellë reduktimin gradual të radiove analoge dhe futjen e transmetimeve radiofonike dixhitale DAB/DAB+. Kjo teknologji ofron cilësi më të lartë audio, më shumë kanale të disponueshme dhe efikasitet më të mirë në përdorimin e spektrit radiofonik. Shqipëria, duke ndjekur zhvillimet më të fundit teknologjike në nivel europian, ka interes të adoptojë dhe implementojë këtë sistem të ri transmetimi. Kjo shkon sinkron edhe me rekomandimet e përsëritura të ITU-së dhe EBU-së, si dhe me zhvillimet teknologjike në vendet anëtare të BE-së si dhe me vendet e rajonit. Për të paraprirë këtë proces dhe për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm dhe efektiv të frekuencave, lindi nevoja për hartimin e një projekti teknik për realizimin e një rrjeti monitorimi radio dixhital DAB+. Qëllimi i këtij projekti ishte organizimi i konferencave dhe workshopeve përkatëse për diskutimin, sensibilizimin, sugjerimin e vendim-marrjeve të nevojshme për mirë-menaxhimin e rrjetit DAB+ dhe realizohet në bashkëpunim me Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës.

**b) "Redaksia e Re Digjitale" - Laborator i Inovacionit në Media për Gazetarë të Rinj**

Redaksia e Re Digjitale synon të jetë një hapësirë dinamike ku gazetarët e rinj jo vetëm të informojnë, por edhe frymëzojnë. Ky laborator inovacioni në media do t'i pajisë pjesëmarrësit me aftësi praktike për gazetarinë digjitale, që nga krijimi i përmbajtjes edukative e deri te përdorimi i mjeteve multimediale moderne për të ndërtuar histori me ndikim. Gjatë zbatimit të programit, të rinjtë do të angazhohen në trajnime ndërvepruese me lektor profesionistë të fushës dhe shpalosjen e punëve praktike në prodhimin e artikujve, videove dhe përmbajtjes për rrjete sociale.

**c) "Gazetaria cilësore dhe gazetaria klikimeve"- Çfarë po ndodh në tregun mediatik.**

Në një kohë kur lajmet qarkullojnë me ritëm të shpejtë dhe platformat online mbizotërojnë mënyrën se si publiku informohet, dallimi mes gazetarisë cilësore dhe asaj të bazuar në klikime po bëhet gjithnjë e më i dukshëm. Ky modul synon të shqyrtojë tendencat që po krijon tregu mediatik sot. Qëllimi ishte të stimulojë të menduarit kritik, analizojë dilemat reale që përballen gazetarët dhe redaksitë, si dhe të kuptojë ndikimin e tregut mbi përmbajtjen mediatike. Ky studim synon të nxisë përgjegjësinë gazetareske në një mjedis ku vlera shpesh matet me "klikime", gjithashtu do të nxirren përfundime mbi mënyrat se si gazetaria cilësore mund të përshtatet e të mbijetojë në një treg të dominuar nga algoritmet.

**d) Rritja e standarteve të gazetarisë në rajon.**

Ky projekt synon të rrisë cilësinë dhe standartet profesionale të gazetarëve në Shqipëri dhe shkëmbimit të eksperiencave me gazetarë të rajonit, të cilat do të realizohen përmes trajnimeve praktike dhe mbështetjes për gazetari të pavarur e hulumtuese. Qëllimi i këtij projekti ishte të kontribuojë në rritjen e profesionalizmit dhe integritetit të gazetarisë në rajon, si bazë për një shoqëri demokratike dhe të informuar. Gazetaria po kalon sfida të mëdha me rritjen e dezinformimit në të gjithë rajonin. Një nga objektivat me rëndësi është rritja e standarteve profesionale në gazetari si dhe përafrimi me direktivat e BE-së, përmes paneleve të diskutimit me gazetarë, redaktorë e studentë të gazetarisë.

**e) Autocensura në median shqiptare – kufiri i padukshëm i fjalës së lirë.**

Në kushtet e një tregu mediatik me konkurrencë të lartë, presione ekonomike dhe ndikime politike, shumë gazetarë përballen me dilema editoriale që i çojnë drejt vetëpërmbajtjes, shmangies së temave të ndjeshme ose moderimit të toneve. Qëllimi i këtij studimi është të mbledhë dëshmi dhe analiza për shkaqet e autocensurës (presionet e jashtme dhe të brendshme, kontratat e punës, pasiguria ekonomike, etj.), pasojat për lirinë e medias dhe ndikimin tek audienca. Do të përfshihen intervista private me gazetarë dhe redaktorë, mbi arsyet e autocensurës dhe dëmin që mund të ketë sjellë. Qëllimi përfundimtar i studimit është të ofrojë një pasqyrë të balancuar dhe të dokumentuar të fenomenit, së bashku me rekomandime praktike për nxitjen e integritetit editorial dhe përmirësimin e mjedisit të punës në median audiovizive shqiptare. Ky projekt synon të analizojë fenomenin e autocensurës në median audiovizive shqiptare, si një nga faktorët më pak të dukshëm por më ndikues në cilësinë e informacionit publik.

**f) Normalizimi i dhunës në mediat audiovizive dhe nevoja për ndërhyrje urgjente.**

Dhuna në mediat audiovizive është kthyer në një dukuri të zakonshme, ku raportimi i skenave tronditëse deri vrasjeve, si dhe sjelljeve agresive trajtohet shpesh si pjesë normale e përmbajtjes mediatike. Nga ana

tjetër përmes transmetimit të përsëritur të pamjeve të rënda pa filtrat etikë të nevojshëm, media jo vetëm që humbet funksionin informues, por kontribuon në krijimin e një realiteti ku dhuna perceptohet si e pranueshme. Ky projekt synon të analizojë mënyrat e normalizimit të dhunës në media dhe të argumentojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes urgjente përmes edukimit mediatik, rregullimit institucional dhe njohjes së ofruesve të shërbimeve mediatike për sanksionet që do të ndërmerren ndaj tyre në raste të shfaqjes së pamjeve të dhunshme. Në qendër të ndërhyrjes është edukimi etik i aktorëve mediatikë dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë për pasojat afatgjata që sjell dhuna e shfaqur në ekran.

### 11.5 Marrëveshjet e Bashkëpunimit

Përgjatë 2025, AMA ka nënshkruar dy Marrëveshje Bashkëpunimi:
a) me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut
b) me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Marrëveshja me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në vijim edhe të zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që lidhen me forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, synoi të sigurojë, parandalojë dhe ndalojë shkeljen e të drejtave të transmetimit dhe të ndihmojë në ndërgjegjësimin për respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura me të, në transmetimet audio dhe audiovizive. Objekti i marrëveshjes përqendrohet në përcaktimin e fushave dhe formave të bashkëpunimit për mbështetjen e ndërsjelltë institucionale gjatë ushtrimit të detyrave ligjore respektive, në funksion të:

- garantimit të të drejtave të transmetimit nga ofruesit e shërbimeve mediatike,
- parandalimit dhe ndalimit të shkeljeve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të,
- rritjes së ndërgjegjësimit mbi respektimin e këtyre të drejtave në përmbajtjet audio dhe audiovizive.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është rritja e shkallës së bashkëveprimit ndërinstitucional në fushat me interes të përbashkët dhe përmirësimi i veprimtarisë së institucioneve për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nga ana tjetër, Marrëveshja e lidhur me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore synoi forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve, për marrjen e masave, me qëllim rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit në sektorin e mediave audiovizive, në funksion të zbatimit të dispozitave ligjore që lidhen me kushtet e punës, mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, pagat, sigurimet dhe mirëqenien në punë.
Objekti i marrëveshjes përqendrohet në përcaktimin e fushave dhe formave të bashkëpunimit për mbështetjen e ndërsjelltë institucionale gjatë ushtrimit të detyrave ligjore respektive, në funksion të:

- institucionalizimit të marrëdhënieve mes dy palëve për sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit;
- bashkëpunimit në kuadër të marrjes së masave për kushte të denja pune në sektorin e mediave audiovizive.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është rritja e ndërveprimit mes palëve në fushat me interes të përbashkët për një funksionim sa më efektiv dhe përmirësimin e veprimtarisë së institucioneve për garantimin e zbatimit të dispozitave ligjore për kushtet e punës, mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, pagat, sigurimin dhe mirëqenien në sektorin e mediave audiovizive, si dhe forcimin e monitorimit të marrëdhënieve të punës në këtë sektor.

### 11.6 Bashkëpunime me OSHMA-të për propozime për Aktet Nënligjore

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) është angazhuar në një proces të strukturuar për rishikimin dhe përditësimin e disa prej rregulloreve të tij, me synim përshtatjen e tyre me zhvillimet e tregut audioviziv dhe me standardet evropiane të rregullimit. Në përputhje me parimet e transparencës,

gjithëpërfshirjes dhe konsultimit publik, të cilat udhëheqin procesin rregullator të AMA-s, përpara ndërmarrjes së çdo ndryshimi janë organizuar një sërë tryezash konsultimi publik me aktorët kryesorë të tregut.

· Në këtë kuadër, AMA zhvilloi takime konsultuese me përfaqësues të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive në 12 qarqet e vendit, si dhe tryeza të dedikuara në mjediset e institucionit. Këto takime synuan krijimin e një hapësire të hapur dialogu ndërmjet rregullatorit dhe operatorëve të tregut, duke mundësuar prezantimin e propozimeve rregullatore nga ana e institucionit dhe njëkohësisht mbledhjen e komenteve, sugjerimeve dhe shqetësimeve të ngritura nga përfaqësuesit e sektorit. Në secilën prej këtyre tryezave, pjesëmarrësit kanë shprehur opinionet e tyre mbi propozimet për ndryshime rregullatore, duke kontribuar në përmirësimin dhe përshtatjen e mëtejshme të kuadrit rregullator. Organizimi i këtyre takimeve konsultuese ka forcuar më tej qasjen e AMA-s drejt një rregullimi të bazuar në dialog dhe bashkëpunim me industrinë. Përmes këtij procesi, institucioni ka synuar të jetë gjithnjë e më pranë ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive, duke i ftuar ata të marrin pjesë aktive në proceset e hartimit dhe përmirësimit të rregulloreve, si dhe duke garantuar që vendimmarrja rregullatore të reflektojë në mënyrë të balancuar interesin publik dhe realitetin e funksionimit të tregut.

· Në vijim të këtij angazhimi konsultues, AMA ka organizuar gjithashtu një takim të posaçëm me përfaqësues të operatorëve të sektorit audioviziv në kuadër të procesit të hartimit të projektiligjit "Për lirimin e frekuencave të Digital Dividend 2". Në këtë takim morën pjesë drejtues dhe përfaqësues të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive dhe operatorëve të transmetimit që preken drejtpërdrejt nga procesi i lirimit të brezit të frekuencave 700 MHz. Ky proces është pjesë e një reforme më të gjerë për harmonizimin e përdorimit të spektrit të frekuencave në Republikën e Shqipërisë me praktikat dhe standardet e Bashkimit Evropian, si dhe me rekomandimet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve (ITU). Lirimi i brezit 700 MHz synon të mundësojë përdorimin më efikas të spektrit radiofrekuencor, duke krijuar hapësira për zhvillimin e shërbimeve të avancuara të komunikimeve elektronike dhe duke kontribuar në zhvillimin e infrastrukturës digjitale në vend.Përmes këtij procesi konsultues, AMA ka synuar të sigurojë që tranzicioni drejt përdorimeve të reja të spektrit të realizohet në mënyrë të koordinuar me operatorët e tregut, duke marrë në konsideratë ndikimin teknik dhe ekonomik të këtij procesi mbi ofruesit e shërbimeve audiovizive dhe duke garantuar një proces transparent, të parashikueshëm dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

**11.7 Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s**

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka vijuar në mënyrë të strukturuar procesin e mbledhjes, administrimit dhe përpunimit të të dhënave mbi tregun audioviziv në Republikën e Shqipërisë, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive", i ndryshuar, si dhe nga aktet nënligjore përkatëse.

Në këtë kuadër, një nga objektivat kryesore të vitit 2025 ka qenë përgatitja e Edicionit të 11-të të Buletinit Periodik të AMA-s, instrumenti kryesor i raportimit vjetor mbi zhvillimet ekonomike, teknologjike, pronësore, përmbajtjes dhe burimet njerëzore në sektorin audioviziv. Buletini vijon të përfaqësojë një mjet themelor transparence dhe informimi publik, duke ofruar një panoramë të detajuar të dinamikave të tregut, sfidave strukturore dhe tendencave të reja në industri.

Buletini Periodik përmban një bazë të gjerë të dhënash statistikore, ekonomike dhe strukturore, të cilat mblidhen dhe përpunohen nga burime të ndryshme institucionale dhe nga vetë subjektet e licencuara. Në kuadër të këtij procesi, gjatë vitit janë administruar të dhëna mbi renditjen e OSHMA-ve bazuar në nivelin e të ardhurave totale, ecurinë ekonomike, bilancet financiare dhe asetet fizike në pronësi. Këto të dhëna kanë shërbyer për ndërtimin e një panorame të përgjithshme mbi strukturën ekonomike të tregut audioviziv dhe për identifikimin e tendencave të zhvillimit të sektorit.

Gjatë vitit është realizuar gjithashtu analizimi i strukturës së stafit të subjekteve të licencuara, duke u fokusuar në tregues të tillë si niveli arsimor, grupmoshat, përvoja në punë, profilet profesionale dhe përfaqësimi gjinor në përmbajtjet e transmetuara. Këto të dhëna kanë shërbyer për vlerësimin e kapaciteteve njerëzore të sektorit dhe për evidentimin e tendencave në lidhje me punësimin dhe barazinë gjinore në median audiovizive.

Një tjetër fushë e rëndësishme e përfshirë në Buletinin Periodik ka qenë administrimi i të dhënave mbi fondin e pagave bruto, shpërndarjen e tij sipas grupeve profesionale dhe përqendrimin e stafit sipas niveleve të pagës.
Një risi e rëndësishme e këtij edicioni të Buletinit Periodik lidhet me përfshirjen dhe trajtimin e zgjeruar të të dhënave mbi transparencën e strukturës së pronësisë së OSHMA-ve, në kuadër të procesit të mëtejshëm të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian. Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar për Integrimin Europian 2024–2026 dhe në vijim të miratimit me vendim nr. 40, datë 26.04.2024, të rregullores "Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënave të lidhura me pronësinë e OSHMA-ve", ky edicion i Buletinit pasqyron për herë të parë në mënyrë të strukturuar të dhëna të detajuara mbi përbërjen e strukturës së pronësisë si dhe pronarin përfitues.
Paralelisht, këto të dhëna janë publikuar edhe në faqen zyrtare të Autoritetit, i ndërtuar sipas modelit të rregullatorit portugez.

Pjesë të tjera të publikuara, gjithashtu, janë edhe:
- monitorimin e çështjeve teknike si lirimi i dividendit digjital dy (DD2), rialokimi i brezit III VHF, lista e programeve "free" në 12 qarqe, aksesueshmëria e faqeve të internetit për personat me aftësi të kufizuara etj;
- të dhëna mbi digjitalizimin e arkivës së AMA-s;
- të dhënat e monitorimit të edicioneve informative, reklamat institucionale dhe komunikimet tregtare.

**Zhvillimi dhe implementimi i programit elektronik për "Regjistrin e Monitorimit dhe Analizimit të të Dhënave"**

Gjatë vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të proceseve të mbledhjes, administrimit dhe analizimit të të dhënave mbi tregun audioviziv, përmes zhvillimit dhe vënies në funksion të një programi elektronik të dedikuar për Regjistrin e Monitorimit dhe Analizimit të të Dhënave. Ky program është konceptuar si një platformë e integruar që synon automatizimin e procesit të raportimit vjetor nga OSHMA-të.

Për këtë arsye, AMA ka organizuar një seri aktivitetesh informuese dhe trajnuese me OSHMA-të si dhe me stafin e brendshëm, për përdorimin e këtij sistemi.
Programi elektronik është ndërtuar në mënyrë që të garantojë ruajtjen e sigurt të të dhënave, mbrojtjen e anonimatit të subjekteve raportuese dhe publikimin e informacionit vetëm në formë të përpunuar statistikore, pa identifikim individual. Të dhënat e mbledhura përmes sistemit përdoren ekskluzivisht për qëllime analitike, raportuese dhe përgatitjen e Buletinit Periodik, në funksion të transparencës institucionale dhe informimit publik.

Në aspektin afatgjatë, sistemi elektronik për Regjistrin e Monitorimit dhe Analizimit të të Dhënave përbën bazën për ndërtimin e një infrastrukture moderne të informacionit në AMA, duke mundësuar zgjerimin e funksionaliteteve të monitorit të tregut audioviziv
Mungesa e një sistemi elektronik të integruar pengonte analizimin e shpejtë të volumit të madh të informacionit dhe rritej varësia nga burimet njerëzore. Në këtë kontekst, ngritja e një platforme elektronike u konsiderua e domosdoshme për të modernizuar proceset e raportimit, për të rritur eficiencën institucionale, për saktësinë, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e të dhënave, si dhe për të përmirësuar kapacitetin analitik të AMA-s në funksion të transparencës dhe informimit publik.

**Reklama institucionale**
Nga monitorimi për OSHMA-të me shtrirje kombëtare, volumi i reklamave publike për vitin 2025, jepet sipas tabelave mujore të mëposhtme:

**Janar**
**Nuk transmetohen reklama institucionale**

**Shkurt**
**01.02.2025-28.02.2025**

| Subjekti | Top Channel | Klan Tv | Vizion Plus | RTSH 1 |
|---|---|---|---|---|
| Totali i reklamave institucionale (sekonda) | 18550 | 11965 | 6357 | 763 |
| Totali i reklamave (sekonda) | 292914 | 298966 | 169564 | 22086 |
| **Përqindje** | ***6.33%*** | ***4.00%*** | ***3.75%*** | ***3.45%*** |

**Mars**
**01.03.2025-31.03.2025**

| Subjekti | Top Channel | Klan Tv | Vizion Plus | RTSH 1 |
|---|---|---|---|---|
| Totali i reklamave institucionale (sekonda) | 21841 | 8251 | 22630 | 1344 |
| Totali i reklamave (sekonda) | 381595 | 370894 | 205999 | 15183 |
| **Përqindje** | ***5.72%*** | ***2.22%*** | ***10.99%*** | ***8.85%*** |

**Prill**
**01.04.2025-10.04.2025**
**Më datë 11 prill 2025 filloi fushata për zgjedhjet parlamentare*

| Subjekti | Top Channel | Klan Tv | Vizion Plus | RTSH 1 |
|---|---|---|---|---|
| Totali i reklamave institucionale (sekonda) | 7470 | 1647 | 7467 | 1764 |
| Totali i reklamave (sekonda) | 381595 | 120126 | 205999 | 15183 |
| **Përqindje** | ***1.96%*** | ***1.37%*** | ***3.62%*** | ***11.62%*** |

**Maj**
**Nuk transmetohen reklama institucionale**

**Qershor**
**Nuk transmetohen reklama institucionale**

**Korrik**
**01.07.2025-31.07.2025**

| Subjekti | Top Channel | Klan Tv | Vizion Plus | RTSH 1 |
|---|---|---|---|---|
| Totali i reklamave institucionale (sekonda) | 1934 | 2024 | 0 | 1411 |
| Totali i reklamave (sekonda) | 308960 | 295359 | 189125 | 9529 |
| **Përqindje** | ***0.62%*** | ***0.68%*** | ***0.00%*** | ***14.80%*** |

**Gusht**
**01.08.2025-31.08.2025**

| Subjekti | Top Channel | Klan Tv | Vizion Plus | RTSH 1 |
|---|---|---|---|---|
| Totali i reklamave institucionale (sekonda) | 1977 | 1665 | 0 | 747 |
| Totali i reklamave (sekonda) | 270317 | 216832 | 199160 | 7046 |
| **Përqindje** | ***0.73%*** | ***0.77%*** | ***0.00%*** | ***10.60%*** |

**Shtator**
**01.09.2025-30.09.2025**

| Subjekti | Top Channel | Klan Tv | Vizion Plus | RTSH 1 |
|---|---|---|---|---|
| Totali i reklamave institucionale (sekonda) | 1630 | 592 | 0 | 1295 |
| Totali i reklamave (sekonda) | 285260 | 296510 | 210196 | 6622 |
| **Përqindje** | ***0.57%*** | ***0.20%*** | ***0.00%*** | ***19.56%*** |

**Tetor**
**01.10.2025-31.10.2025**

| Subjekti | Top Channel | Klan Tv | Vizion Plus | RTSH 1 |
|---|---|---|---|---|
| Totali i reklamave institucionale (sekonda) | 0 | 3940 | 0 | 0 |
| Totali i reklamave (sekonda) | 307003 | 336469 | 208662 | 8347 |
| **Përqindje** | ***0.00%*** | ***1.17%*** | ***0.00%*** | ***0.00%*** |

**Nëntor**
**01.11.2025-30.11.2025**

| Subjekti | Top Channel | Klan Tv | Vizion Plus | RTSH 1 |
|---|---|---|---|---|
| Totali i reklamave institucionale (sekonda) | 90 | 50 | 0 | 170 |
| Totali i reklamave (sekonda) | 240498 | 254172 | 148090 | 9657 |
| **Përqindje** | ***0.04%*** | ***0.02%*** | ***0.00%*** | ***1.76%*** |

**Monitorimi fillon në datën 10.11.2025, pasi në datat 01.11.2025-09.11.2025 u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme vendore për 5 bashki.*

**Dhjetor**
**01.12.2025-31.12.2025**

| Subjekti | Top Channel | Klan Tv | Vizion Plus | RTSH 1 |
|---|---|---|---|---|
| Totali i reklamave institucionale (sekonda) | 128 | 188 | 0 | 0 |
| Totali i reklamave (sekonda) | 240498 | 254172 | 148090 | 9657 |
| **Përqindje** | ***0.05%*** | ***0.07%*** | ***0.00%*** | ***0.00%*** |

### 11.8 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivë-Protokoll ka zhvilluar dhe zbatuar një sistem të strukturuar të menaxhimit të performancës, i cili përbën një komponent kyç të administrimit të stafit dhe të funksionimit efektiv të institucionit. Ky sistem është projektuar për të garantuar që çdo punonjës të kontribuojë në mënyrë optimale në realizimin e objektivave strategjikë dhe operativë, si dhe për të siguruar zhvillimin profesional dhe motivimin e vazhdueshëm të stafit.
Sistemi i menaxhimit të performancës është bazuar në disa përbërës kryesorë duke përfshirë caktimin e objektivave individuale dhe të njësive, të cilat lidhen ngushtë me strategjitë dhe prioritetet institucionale. Objektivat përcaktohen në fillim të vitit, duke u fokusuar në rezultatet dhe ndikimin e punës së secilit punonjës. Kjo qasje ka siguruar që të gjithë të kenë një kuptim të qartë të pritshmërive dhe përgjegjësive të tyre.

Si pjesë e menaxhimit është edhe vlerësimi i performancës. Nëpërmjet procesit të vlerësimit, si një mjet strategjik, është krijuar aftësia për të identifikuar mundësitë për përmirësim, për të stimuluar inovacionin dhe për të adresuar nevojat e zhvillimit të stafit. Përveç vlerësimit, sistemi i menaxhimit të performancës përfshin bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen profesionale, duke krijuar një kulturë të mësimit të vazhdueshëm dhe të përmirësimit, duke e bërë çdo punonjës pjesë aktive të procesit të zhvillimit profesional dhe të suksesit të institucionit.

Menaxhimi i burimeve njerëzore është orientuar drejt meritokracisë si një prej parimeve kryesore të shërbimit civil, ku performanca dhe kontributi i punonjësve lidhen me mundësi avancimi profesional, trajnime të specializuara dhe njohje institucionale. Kjo qasje ka favorizuar angazhimin, ka rritur motivimin dhe ka krijuar një mjedis pune pozitiv dhe efikas. Në këtë kontekst, monitorimi i performancës ka shërbyer edhe si një mjet strategjik për adminitrimin e burimeve njerëzore, duke identifikuar nevojat për forcimin e kapaciteteve, optimizimin e stafit dhe përmirësimin e proceseve të punës. Edhe këtë vit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivë-Protokoll, në kuadër të planifikimit të zhvillimit profesional të punonjësve, ka hartuar kalendarin e nevojave për trajnim. Nëpërmjet trajnimeve të rregullta, seminareve dhe programeve të specializuara, punonjësit kanë forcuar aftësitë e tyre teknike dhe menaxheriale, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të përgjithshme të institucionit. Ky model ka krijuar një mjedis profesional të orientuar drejt rezultateve dhe risive, duke garantuar që institucioni të jetë gjithmonë në nivelin më të lartë të dhe realizimit të paraqitjes dhe realizimit të funksioneve të veta.

Një rol të veçantë kanë luajtur gjithashtu trajnimet e vazhdueshme për punonjësit e rinj të rekrutuar, të cilat kanë kontribuar në njohjen e politikave institucionale dhe forcimin e aftësive profesionale. Këto trajnime janë realizuar në përputhje me kalendarin vjetor të nevojave për trajnime, i cili mbështetet në analizën e kërkesave specifike të çdo njësie organizative. Ky plan i detajuar i trajnimeve ka garantuar një qasje të sistematizuar dhe të përshtatur me nevojat reale të institucionit.

Roli informues dhe koordinues i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me strukturat e tjera

në AMA, ka mundësuar përmbushjen e objektivave institucionale dhe zhvillimin e aftësive profesionale të punonjësve, me qëllim thellimin e njohurive dhe përmirësimin e performancës së çdo nëpunësi. Bashkëpunimi i ngushtë me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ka vijuar edhe gjatë vitit raportues. Në muajin korrik, ASPA përcolli kalendarin me trajnimet e ofruara prej saj, me fokus zhvillimin profesional dhe institucional për pjesëmarrësit. Përveç këtyre trajnimeve, punonjësit e AMA-s janë angazhuar në ëorkshop-e, trajnime të strukturuara dhe forma të tjera të zhvillimit të kapaciteteve profesionale.

Në total, përgjatë vitit 2025, nëpunës civilë të kategorive të ndryshme kanë marrë pjesë në 36 trajnime për zhvillim profesional.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivë-Protokoll, në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha njësitë administrative të institucionit, e ka trajtuar menaxhimin e performancës së burimeve njerëzore jo vetëm si një mekanizëm administrativ, por edhe si një instrument strategjik në funksion të zhvillimit dhe konsolidimit institucional. Përmes këtij procesi, është synuar angazhimi i punonjësve, informimi i duhur dhe pjesëmarrja aktive në realizimin e objektivave institucionale, duke kultivuar një mjedis pune të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm, meritokracisë dhe profesionalizmit.

Gjatë vitit 2025, mbledhjet e anëtarëve të AMA-s kanë vijuar normalisht. Në total, gjatë këtij viti raportues janë zhvilluar 36 mbledhje.




# 12. TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

## 12.1 Menaxhimi i burimeve financiare

Administrimi i burimeve financiare është një aspekt kyç i veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), i cili funksionon si një institucion me vetëfinancim. Në aspektin financiar, AMA synon të sigurojë burime të mjaftueshme për të mbështetur realizimin efikas të detyrave dhe funksioneve të saj. Në këtë kontekst, përmirësimi i treguesve financiarë është një prioritet i rëndësishëm për AMA - n dhe është zbatuar në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të tij për periudhën 3 - vjeçare 2024 - 2026.

Ligji nr. 97/2013, në nenin 24, specifikon burimet kryesore të financimit të AMA - s si vijon:

a. Të ardhurat nga licencat dhe/ose autorizimet: Përfshijnë pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve. Ky burim financimi siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave për AMA-n;
b. Të ardhurat vjetore nga licencat dhe/ose autorizimet: Kjo përfshin pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve të subjekteve të mediave, që kontribuojnë në mbajtjen e burimeve financiare të AMA – s dhe zë pjesën më të madhe të të ardhurave;
c. Të ardhurat nga përpunimi administrativ i aplikimeve: Përfshin të ardhurat nga pagesat për përpunimin administrativ të kërkesave për aplikime për licenca dhe/ose autorizime të ndryshme;
d. Tarifat për shërbimet e transmetimeve: Përfshin tarifat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, ku AMA ka rolin e agjentit tatimor, duke siguruar një burim shtesë të të ardhurave.

## 12.2 Realizimi i burimeve të financimit në vitin 2025

**Ecuria e arkëtueshmërisë së burimeve të vetëfinancimit për "Të ardhurat korente të periudhës" dhe "Të ardhura nga debitorët e vitit të kaluar", Tabela nr.2**

*Tabela nr.2* *000 lekë*

| Nr. | Emërtimi | Parashikimi i të ardhurave për vitin 2025 | Detyrimeve financiare të lindura OSHMA-ve të licencuara/autorizuara në vitin 2025. Faturime gjatë vitit 2025) | Totali i të ardhurave të realizuara viti 2025 |
|---|---|---|---|---|
| | | *1* | *2* | |
| **A** | **Të ardhurat korrente të periudhës (1+2+3+4+5+6)** | **336,023** | **289,692** | **222,787** |
| **1** | Të ardhura nga licenca/autorizim + pagesat për rinovimet | **220,767** | **227,083** | **166,470** |
| | *a) Realizimi i pagesave nga subjektet televizivë privat vendorë* | *17,470* | *18,993* | *10,658* |
| | *b) Realizimi i pagesave nga rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale* | *56,592* | *54,861* | *26,660* |
| | *c) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA për OTT, IPTV, Internet TV* | *61,900* | *64,685* | *52,783* |
| | *d) Realizimi i pagesave nga subjektet radiofonikë privat vendorë analog* | *19,780* | *20,278* | *15,799* |
| | *e) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA (kabllorë)* | *65,025* | *68,265* | *60,570* |
| **2** | Të ardhura si agjent tatimor | **660** | **645** | **645** |
| | *- Nga subjektet e licencuar/autorizuar* | 660 | 645 | 645 |
| | *- Nga subjektet hequr licenca/autorizimi* | | | |
| **3** | Të ardhura nga përpunimi administrativ | **2,180** | **4,889** | **4,889** |
| **4** | Të ardhura nga interesat bankare | **300** | **3,399** | **1,431** |
| **5** | Të ardhura të tjera (lëshim DVD, fotokopje materialesh) | **50** | **83** | **30** |
| **6** | Të ardhura të tjera: | **112,066** | **53,593** | **49,322** |


INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL

*Në funksion të administrimit dhe menaxhimit më efikas të burimeve financiare, janë krijuar depozita bankare, të cilat kanë gjeneruar interesa bankare.

Sipas tabelës së të ardhurave 2025, "Të ardhurat korrente të periudhës (A)" janë planifikuar 336,023 mijë lekë. Gjatë vitit janë faturuar 289,692 mijë lekë, dhe janë realizuar/arkëtuar 222,787.
Zëri kryesor "Të ardhura nga licenca/autorizim + pagesat për rinovimet" është planifikuar 220,767 mijë lekë, ndërsa faturimet rezultojnë 227,083 mijë lekë dhe arkëtimet 166,470 mijë lekë
Pavarësisht diferencës ndërmjet faturimeve dhe arkëtimeve gjatë vitit 2025, performanca financiare vlerësohet në përgjithësi pozitive dhe e qëndrueshme. Pjesa më e madhe e detyrimeve janë objekt i marrëveshjeve për pagesë me këste me subjektet përkatëse, çka pritet të kontribuojë në përmirësimin gradual të nivelit të arkëtimeve dhe në realizimin e të ardhurave në periudhat pasuese.
Burimi kryesor i vetëfinancimit të AMA - s janë "Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim". AMA, gjatë vitit 2025, ka ndjekur arkëtueshmërinë e burimeve të saj të financimit, ku zëri "Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim", për periudhën 2018-2025 paraqitet si më poshtë vijon: Tabela nr.3

*Tabela nr. 3* *000 lekë*

| Vitet | Të ardhura vjetore të pritshme (Plani) | Të ardhura vjetore të realizuara (faturimet) | Realizimi në % |
|---|---|---|---|
| 2018 | 190,052 | 177,352 | 93% |
| 2019 | 188,192 | 183,229 | 95% |
| 2020 | 201,973 | 190,573 | 94% |
| 2021 | 216,717 | 202,107 | 94% |
| 2022 | 217,756 | 181,936 | 84% |
| 2023 | 225,321 | 208,624 | 92% |
| 2024 | 229,550 | 231,659 | 101% |
| 2025 | 220,767 | 227,083 | 103% |



### 12. 3 Detyrimet financiare të OSHMA-ve

Analiza e Detyrimeve Financiare për subjektet audiovizive me licencë/autorizim aktive (në fuqi) në 2025.Tabela nr.4
Tabela e të dhënave tregon detyrimet financiare të subjekteve sipas kategorive të ndryshme të medias audiovizive për vitet 2024 dhe 2025 (Televizione, Rrjete dhe kategorisë së detyrimeve (gjoba, kamata, taksa). Këto detyrime përfshijnë borxhet e mbetura nga viti 2025, detyrimet e reja të faturuara gjatë vitit 2025, borxhet e papaguara përgjatë vitit, si dhe ristrukturimet e mundshme që kanë ndodhur për të lehtësuar barrën financiare. Në fund të analizës, shihet një përqindje e rritjes ose uljes së detyrimeve për secilën kategori.

*Tabela nr.4* *000 lek*

| Kategorizimi i subjekteve | Detyrime të trashëguara licencë/autorizime 2024 | Detyrime për licencë/autorizime të faturuara 2025 | Detyrim e të paguara/autorizime nga 2024 | Detyrime të paguara/autorizime nga 2025 | Detyrimet ne fund te periudhës 2025 |
|---|---|---|---|---|---|
| Televizione analoge | 11,291 | 18,993 | 5,359 | 10,969 | 13,956 |
| Rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale | 31,631 | 54,861 | 31,631 | 27,428 | 27,433 |
| Ofrues programi/ripërsëritës programi mbështetur në internet (IPTV/OTT) | 8,729 | 64,685 | 6,542 | 54,304 | 12,568 |
| Radio analoge | 1,850 | 20,278 | 1,362 | 17,249 | 3,517 |
| Ripërsëritës programi mbështetur në rrjet kabllor | 6,104 | 68,265 | 2,155 | 62,315 | 9,899 |
| Gjoba | | 12,640 | | 2,660 | 9,980 |
| Taksa RTV | 636 | 12,857 | 600 | 12,669 | 224 |
| **Shuma totale** | **60,241** | **252,580** | **47,649** | **187,594** | **77,578** |

1. **Televizione analoge**
   - Në fillim të vitit 2025, këto subjekte trashëgonin detyrime ndaj AMA-s prej 11,291;
   - Gjatë vitit 2025 u faturuan detyrime të reja në vlerën 18,993;
   - U arkëtuan 5,359 nga detyrime të prapambetura (të trashëguara) dhe 10,969 nga faturimet e vitit 2025;
   - Në fund të vitit 2025, detyrimi i mbetur rezulton 13,956;

Megjithatë, duke qenë se një pjesë e subjekteve kanë lidhur marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste, pritet që këto detyrime të arkëtohen gradualisht në periudhat në vijim, duke kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të arkëtimeve.

2. Rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale
- Trashëgimia në fillim të 2025 ishte 31.631;
- U faturuan gjatë 2025 54.861 detyrime të reja;
- U arkëtuan 31.631 nga detyrime të trashëguara dhe 27.428 nga faturimet e vitit;
- Detyrimi i mbetur në fund të 2025 është 27.433;

Duke qenë se kjo kategori përbën një burim të rëndësishëm të të ardhurave për institucionin, duhet theksuar se subjektet përkatëse kanë lidhur marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste dhe po i respektojnë ato në mënyrë të rregullt, çka garanton vijimësinë e arkëtimeve dhe stabilitetin e të ardhurave në periudhat pasuese.

3. Ofrues programi / ripërsëritës programi mbështetur në internet (IPTV/OTT)
- Detyrime të trashëguara: 8,729;
- Detyrime të faturuara në 2025: 64,685;
- U arkëtuan 6,542 nga detyrime të trashëguara dhe 54,304 nga faturimet e vitit;
- Detyrimi në fund të 2025: 12,568;
- Arkëtimi total është rreth 83% (60,846 nga 73,414), ndërsa arkëtimi mbi faturimet 2025 rreth 84%.

Kjo kategori paraqet performancë të mirë arkëtimi dhe sjellje relativisht të rregullt pagese.

4. Radio analoge
- Detyrime të trashëguara: 1,850;
- Detyrime të reja të faturuara: 20,278;
- U arkëtuan 1,362 nga detyrimet e trashëguara dhe 17,249 nga faturimet e vitit;
- Detyrimi i mbetur në fund të 2025: 3,517;
- Arkëtimi total rreth 84% (18,611 nga 22,128).

Radiot analoge shfaqin qëndrueshmëri të mirë në pagesa, me nivel të lartë arkëtimi dhe stok të moderuar detyrimi në fund të vitit.

5. Ripërsëritës programi mbështetur në rrjet kabllor
- Detyrime të trashëguara: 6,104;
- Detyrime të faturuara në 2025: 68,265;
- U arkëtuan 2,155 nga detyrimet e trashëguara dhe 62,315 nga faturimet e vitit;
- Detyrimi i mbetur në fund të 2025: 9,899;
- Arkëtimi total rreth 86.7% (64,470 nga 74,369), dhe arkëtimi mbi faturimet 2025 rreth 91.3%.

Në përfundim, ripërsëritësit e programit mbështetur në rrjet kabllor paraqesin një performancë të lartë në arkëtim, kjo tregon disiplinë të fortë pagese nga subjekte, menaxhim efektiv të burimeve financiare dhe kontribuon ndjeshëm në qëndrueshmërinë e të ardhurave të institucionit.

6. Gjoba
- U faturuan gjatë 2025: 12,640;
- U arkëtuan gjatë 2025: 2,660;
- Detyrimi i mbetur në fund të 2025: 9,980;

Sa i përket sanksioneve në formë gjobe për shumat reale, duhet theksuar se, pas dërgimit për ekzekutim, statusi i detyrimit ndryshon pasi hyn në procesin gjyqësor. Ky proces mund të zgjasë përtej një periudhe vjetore dhe është jashtë kompetencës së institucionit, duke kufizuar mundësinë e arkëtimit të menjëhershëm të këtyre detyrimeve.

7. Taksa RTV
- Detyrime të trashëguara: 636;
- Detyrime të faturuara në 2025: 12,857;
- U arkëtuan 600 nga detyrimet e trashëguara dhe 12,669 nga faturimet e vitit;
- Detyrimi i mbetur në fund të 2025: vetëm 224;
- Arkëtimi total rreth 98.3% (13,269 nga 13,493).

Ky zë paraqet performancën më të mirë, me arkëtim pothuajse të plotë dhe detyrim minimal të mbetur në fund të vitit.

**Përmbledhje e përgjithshme (Shuma totale – sipas tabelës)**

Analiza e arkëtimeve për vitin 2025 tregon se disa kategori të subjekteve kanë shfaqur performancë të lartë dhe disiplinë të mirë pagese. Këto rezultate dëshmojnë se praktikat e menaxhimit financiar dhe ndjekjes së detyrimeve kanë dhënë efekt pozitiv, duke garantuar stabilitetin e të ardhurave dhe një arkëtim të qëndrueshëm për institucionin. Në zbatim të Vendimit të AMA-së Nr. 77, datë 22/09/2025, subjektet në vështirësi financiare kanë lidhur marrëveshje gjashtë dhe nëntë mujore për shlyerjen e detyrimeve me këste. Kjo pritet të sigurojë arkëtimin gradual të detyrimeve të papaguara, të përmirësojë likuiditetin e institucionit dhe të ruajë vazhdimësinë e të ardhurave në periudhat e ardhshme, duke minimizuar rrezikun e stokut të detyrimeve të prapambetura.

**12.4 Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2025**

Gjatë vitit raportues, AMA ka menaxhuar burimet financiare bazuar në projekt - buxhetin për vitin 2025, si dhe në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike.

Gjatë vitit raportues, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka menaxhuar burimet financiare në përputhje me projekt-buxhetin e vitit 2025, si dhe me Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike, duke orientuar shpenzimet drejt mbulimit të nevojave bazë të institucionit dhe vijimit të projekteve në proces.

**12.4.1 Shpenzimet dhe investimet në vitin 2025**

Analiza e Shpenzimeve dhe Investimeve për Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) për vitin 2025. Tabela nr.5:

*Tabela nr.5* *000/leke*

| Nr. | Shpenzime/Investime | Plani | Shtesa/pakësime gjatë vitit 2025 | Fakti |
|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 |
| I | **Shpenzime korente (a+b)** | **276,957** | - | **212,035** |
| | *a) Paga, kontribute për sig. shoq. dhe shend., shpërblime* | 174,737 | 1,500 | 165,580 |
| | *b) Shpenzime për mallra dhe shërbime* | 102,220 | (3,660) | 46,455 |
| | **Shpenzime për investime (a+b+c)** | **168,769** | - | **32,035** |
| | ***a) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara*** | ***13,000*** | - | ***8,843*** |
| | *- Studime dhe kërkime (2025)* | 13,000 | - | 8,843 |
| | *- Studime, kërkime, anketime (të filluara në vitin 2023, për tu përfunduar në vitin 2025)* | - | - | - |
| | *-Programe/aplikacione* | - | - | - |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| II | ***b) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara*** | ***147,769*** | ***3,840*** | ***23,192*** |
| | *- Instalime, mjete dhe paisje të tjera, teknike* | *126,461* | - | |
| | *Instalime dhe sisteme të filluara në vitin 2025* | *21,286* | - | *22,988* |
| | *- Mobilje dhe paisje të tjera zyre* | *22* | - | *22* |
| | *Paisje kompjuterike elektronike* | - | - | *182* |
| | *Paisje të tjera mbështetëse teknike* | - | - | - |
| | *Paisje të tjera të filluara në vitin 2024* | - | - | |
| | *Mobilje zyre* | - | - | |
| | *- Mjete transporti* | - | - | |
| | ***c) Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme*** | ***8,000*** | - | - |

1. Shpenzime korrente

Shpenzimet korrente për vitin 2025 ishin planifikuar në vlerën 276.957 mijë lekë, ndërsa shpenzimet faktike arritën 212.035 mijë lekë, me një realizim 77%.

- Paga, kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shpërblime: u planifikuan 174.737 mijë lekë, me një shtesë gjatë vitit prej 1.500 mijë lekë; realizimi faktik ishte 165.580 mijë lekë, me realizim 93%, që dëshmon një nivel të lartë përmbushjeje të detyrimeve kryesore ndaj burimeve njerëzore.
- Mallra dhe shërbime: Nga vlera e planifikuar prej 102.220 mijë lekësh, gjatë vitit 2025 u bë një pakësim prej 3.660 mijë lekësh, ndërsa shpenzimet faktike arritën në 46.455 mijë lekë. Ky realizim i shpenzimeve operative lidhet kryesisht me riorganizimin e shpenzimeve gjatë vitit për shkak të ndryshimit të prioriteteve, dhe riplanifikimit të nevojave operative. Ky fleksibilitet ka mundësuar menaxhimin më efikas të buxhetit dhe përshtatjen me nevojat reale të institucionit, ndërkohë që burimet do të përdoren në periudhat në vazhdim.

2. Shpenzime për investime

Për vitin 2025, shpenzimet për investime ishin planifikuar në vlerën 168.769 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik arriti 32.035 mijë lekë. Ky nivel i realizimit reflekton një ecuri më të ngadaltë të investimeve krahasuar me pritshmëritë e planifikuara. Gjatë vitit janë krijuar rezerva dhe është bërë rivlerësim i prioriteteve, duke riorientuar burimet në projekte më urgjente. Buxheti i papërdorur do të përdoret në periudhat e ardhshme sipas nevojave për realizimin e objektivave të Institucionit.

**12.4.2 Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara**

Për aktive të patrupëzuara u planifikuan 13.000 mijë lekë, ndërsa u realizuan 8.843 mijë lekë. Realizimi tregon se një pjesë e shpenzimeve për studime/kërkime është kryer, ndërkohë që pjesa tjetër e projekteve vazhdon të jetë në proces dhe pritet të realizohet gjatë vitit 2026.

**12.4.3 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara**

Për aktive të trupëzuara u planifikuan 147.769 mijë lekë, me shtesë gjatë vitit 3.840 mijë lekë, ndërsa realizimi faktik ishte 23.192 mijë lekë.

Nga të dhënat e vitit 2025 vërehen disa tendenca kryesore:
- Shpenzimet për paga dhe kontribute kanë nivel të lartë realizimi (93%), duke treguar stabilitet dhe administrim të rregullt të detyrimeve ndaj personelit;
- Mallrat dhe shërbimet kanë realizim më të ulët (47%), duke sinjalizuar kursime, dhe riplanifikim të shpenzimeve operative gjatë vitit;
- Investimet në tërësi paraqiten me realizim më të ulët (19%), kjo për shkak të riorganizimit të prioriteteve, krijimit të rezervave për përdorim të mëvonshëm sipas nevojave që do të ketë institucioni për përmbushjen e objektitvave të tij.

## 12.5 Pasqyrat financiare

Në fund të vitit 2025, Autoriteti i Mediave Audiovizive realizoi një fitim prej 28,408,245.4 lekë.
Ndërkohë që gjendja e likuiditetit është 212,889,107.99 lekë në fund të vitit 2025.

**Pasqyra e aktiveve dhe pasiveve për vitet 2024 - 2025**

**NË / LEKË**

| Nr. Reshti | Referenca e Logarive | EMËRTIMI | Ushtrimi I Mbyllur | Ushtrimi Paraardhes |
|---|---|---|---|---|
| 1 | A | **AKTIVET** | **993,709,210.39** | **985,753,177.99** |
| 2 | | **I.Aktivet Afat shkurtra** | **790,345,097.50** | **785,524,032.58** |
| 3 | | **1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre** | **212,889,107.99** | **225,022,153.40** |
| 4 | 531 | Mjete monetare në Arkë | 70.3 | 67.3 |
| 5 | 512,56 | Mjete monetare në Bankë | 212,888,500.7 | 225,021,549.1 |
| 6 | 520 | Disponibilitete në Thesar | 537.0 | 537.0 |
| 7 | 50 | Letra me vlerë | | |
| 8 | 532 | Vlera të tjera | | |
| 9 | 54 | Akreditiva dhe paradhënie | | |
| 10 | 59 | Provigjone zhvlersimi letra me vlerë (-) | | |
| 11 | | **2.Gjendje Inventari qarkullues** | **4,741,025.0** | **4,402,983.1** |
| 12 | 31 | Materiale | 4,741,025.0 | 4,402,983.1 |
| 13 | 32 | Inventar i imët | | |
| 14 | 33 | Prodhim në proces | | |
| 15 | 34 | Produkte | | |
| 16 | 35 | Mallra | | |
| 17 | 36 | Kafshë në rritje e majmëri | | |
| 18 | 37 | Gjendje të pa mbritura,ose pranë të tretëve | | |
| 19 | 38 | Diferenca nga cmimet e magazinimit | | |
| 20 | 39 | Provigjone për zhvlersimin e inventarit (-) | | |
| 21 | | **3.Llogari te Arketushme** | **570,041,951.5** | **553,425,883.1** |
| 22 | 411 | Klientë e llogari të ngjashme | 449,822,070.3 | 451,256,646.1 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 23 | 423,429 | Personeli, paradhënie, deficite, gjoba | 100,000.0 | 97,200.0 |
| 24 | 431 | Tatim e Taksa | | |
| 25 | 432 | Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal | | |
| 26 | 433 | Fatkeqsi natyrore që mbulohen nga shteti | | |
| 27 | 435 | Sigurime Shoqërore | | |
| 28 | 436 | Sigurime Shëndetsore | | |
| 29 | 437,438, | Organizma të tjera shtetërore | 0.0 | 6,283.0 |
| 30 | 44 | Institucione të tjera publike | | |
| 31 | 465 | Efekte për tu arkëtuar nga interesa depozite të maturuara | 1,967,671.2 | |
| 32 | 468 | Debitore të ndryshëm | 118,152,210.0 | 102,065,754.0 |
| 33 | 4342 | Operacione me shtetin(Të drejta) | | |
| 34 | 45 | Mardhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike | | |
| 35 | 49 | Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-) | | |
| 36 | | **4.Te tjera aktive afatshkurtra** | **2,673,013.0** | **2,673,013.0** |
| 37 | 409 | Parapagime | 2,673,013.0 | 2,673,013.0 |
| 38 | 473 | Llogari e pritjes të mardhënieve me thesarin | | |
| 39 | 477 | Diferenca konvertimi aktive | | |
| 40 | 481 | Shpenzime për t'u shpermdarë në disa ushtrime | | |
| 41 | 486 | Shpenzime të periudhave të ardhshme | | |
| 42 | | **II.Aktivet Afat gjata** | **203,364,112.9** | **200,229,145.4** |
| 43 | **20** | **1.Aktive Afatgjata jo materiale** | **30,578,937.1** | **38,632,014.0** |
| 44 | 201 | Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave | | |
| 45 | 202 | Studime dhe kërkime | 30,578,937.1 | 38,632,014.0 |
| 46 | 203 | Koncesione,Patenta,Licenca e të ngjashme | | |
| 47 | **21** | **2.Aktive Afatgjata materiale** | **172,785,175.8** | **161,597,131.4** |
| 48 | 210 | Toka, T,roje, Terene | 10,260,000.0 | |
| 49 | 211 | Pyje, Plantacione | | |
| 50 | 212 | Ndërtesa e Konstruksione | 75,858,338.8 | 71,578,290.7 |
| 51 | 213 | Rrugë, rrjete, vepra ujore | | |
| 52 | 214 | Instalime teknike, makineri e pajisje | 76,719,172.0 | 78,965,636.0 |
| 53 | 215 | Mjete Transporti | 6,685,944.0 | 8,776,450.0 |
| 54 | 216 | Rezerva Shtetërore | | |
| 55 | 217 | Kafshë pune e prodhimi | | |
| 56 | 218 | Inventar ekonomik | 3,261,721.0 | 2,276,754.8 |
| 57 | 24 | Aktive afatgjata të dëmtuara | | |
| 58 | 28 | Caktime të Aktiveve Afatgjata | | |
| 59 | 25-26 | **3.Aktive Afatgjata Financiare** | **0.0** | **0.0** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 60 | 25 | Huadhënie e Nënhuadhenie | | |
| 61 | 26 | Pjesëmarrje në kapitalin e vet | | |
| 62 | | **4.Investime** | **0.0** | **0.0** |
| 63 | 230 | Për Aktive Afatgjata jo materiale | | |
| 64 | 231 | Për Aktive Afatgjata materiale | | |
| **65** | **B** | **PASIVET(DETYRIMET)** | **412,076,171.5** | **396,137,749.3** |
| 66 | | **I.Pasivet Afat shkurtra** | **412,076,171.5** | **396,137,749.3** |
| 67 | | **1. Llogari të Pagueshme** | **412,076,171.5** | **396,137,749.3** |
| 68 | 401-408 | Furnitorë e llogari të lidhura me to | 2,744,771.3 | 204,312.2 |
| 69 | 42 | Detyrime ndaj personelit | | 0.0 |
| 70 | 16,17,18 | Hua Afat shkurtra | | |
| 71 | 460 | Huadhënës | | |
| 72 | 431 | Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa TAP | 2,434,455.6 | 2,155,696.6 |
| 73 | 432 | Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal | | |
| 74 | 433 | Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore | | |
| 75 | 435 | Sigurime Shoqërore | 1,238,350.0 | 585,323.0 |
| 76 | 436 | Sigurime Shëndetsore | 218,625.9 | 170,636.9 |
| 77 | 437,438, | Organizma të tjerë shtetërore | 0.0 | |
| 78 | 44 | Institucione të tjera publike | | |
| 79 | 45 | Marëdhenie midis institucioneve apo njësive ekonomike | | |
| 80 | 464 | Det.per tu paguar per bl.letrave me vlerë | | |
| 81 | 466 | Kreditorë për mjete në ruajtje | 54,265,588.4 | 51,765,588.4 |
| 82 | 467 | Kreditorë të ndryshëm | 0.0 | 0.0 |
| 83 | 4341 | Operacione me shtetin (detyrime) | 351,174,380.3 | 341,256,192.3 |
| 84 | 49 | Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-) | | |
| 85 | | **2.Te tjera pasive afatshkurtra** | **0.0** | **0.0** |
| 86 | 419 | Kreditorë, Parapagime | | |
| 87 | 475 | Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse | | |
| 88 | 478 | Diferenca konvertimi pasive | | |
| 89 | 480 | Të ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar | | |
| 90 | 487 | Të ardhura të arketuara para nxjerrjes së ttitullit | | |
| 91 | | **II.Pasivet Afat Gjata** | **0.0** | **0.0** |
| 92 | Klase 4 | Llogari të pagushme | | |
| 93 | 16.17,18 | Huatë Afat gjata | | |
| 94 | | Provigjonet afatgjata | | |
| 95 | Klasa 4 | Të tjera | | |
| 96 | **C** | **AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)** | **581,633,038.9** | **589,615,428.7** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 97 | D | **FONDI I KONSOLIDUAR :** | **581,633,038.9** | **589,615,428.7** |
| 98 | 101 | Teprica (Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar | 448,224,793.5 | 426,276,923.4 |
| 99 | 12 | Rezultatet e mbartura | | |
| 100 | 85 | Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore | 28,408,245.4 | 58,338,505.4 |
| 101 | 111 | Rezerva | | |
| 102 | 115 | Nga Fondet e veta te investimeve | | |
| | 15 | Shuma të parashikuiara për rreziqe e Zhvlerësime | | |
| 103 | 105 | Teprica e Granteve kapitale të Brendshmne | 105,000,000.0 | 105,000,000.0 |
| 104 | 106 | Teprica e Granteve kapitale te Huaja | | |
| 105 | 107 | Vlera e mjeteve të caktuara në perdorim | | |
| 106 | 109 | Rezerva nga Rivlersimi i Aktiveve Afatgjata | | |
| 107 | | Të Tjera | | |
| 108 | E | **TOTALI I PASIVEVE(B+C)** | **993,709,210.4** | **985,753,178.0** |
| | | | | |
| **KONTROL LE** | | **Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturën** | **Kuadratura** | **Kuadratura** |
| Kontroll 1. | | Aktivet Neto a janë të barabarta me Fondin e Konsoliduar | **0.0** | **0.0** |
| Kontroll 2. | | Totali i Aktiveve a është i barabartë me = Totalin e Pasiveve | **0.0** | **0.0** |

**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 2024- 2025**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **NJËSIA PUBLIKE** | | **AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE** | | Formati nr.2 |
| | | **PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE** | **Viti 2025** | |
| | | **(Klasifikimi, sipas Natyrës ekonomike)** | | |
| | | | NË / LEKE | |
| **Nr.** | **Nr.** | | VITI | VITI |
| **rresh** | **Llogarije** | **PËRSHKRIMI I OPERACIONEVE** | USHTRIMOR | I MËPARSHËM |
| **ti** | | | | |
| **a** | **b** | **c** | 1.00 | 2.00 |
| **1** | **A** | **TË ARDHURAT** | **240,443,604.90** | **259,062,187.67** |
| **2** | ***70*** | ***I.TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET*** | **2,031,451.00** | **31,739,128.25** |
| **3** | **700** | **1.Tatimi mbi te Ardhurat** | **0.00** | **0.00** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **4** | 7000 | Tatim mbi të ardhurat personale | | |
| **5** | 7001 | Tatim mbi Fitimin | | |
| **6** | 7002 | Tatim mbi Biznesin e vogël | | |
| **7** | *7009* | *Te tjera Tatime mbi të ardhurat* | | |
| **8** | **702** | **2.Tatimi mbi Pasurinë** | **0.00** | **0.00** |
| **9** | 7020 | Tatim mbi Pasurinë e palujtshme | | |
| **10** | 7021 | Tatim mbi shitjen e pasurisë së palujtshe | | |
| **11** | 7029 | Te tjera tatime mbi Pasurinë | | |
| **12** | **703** | **3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit** | **645,126.00** | **660,598.25** |
| **13** | 7030 | Tatim mbi vlerën e shtuar(TVSH) | | |
| **14** | 7031 | Akciza | | |
| **15** | 7032 | Taksë mbi sherbimet specifike | | |
| **16** | 7033 | Taksë mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie (Taksa RTV 5%) | 645,126.00 | 660,598.25 |
| **17** | 7035 | Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie | | |
| **18** | **704** | **4.Taksë mbi tregtine dhe transaksionet ndërkombtare** | **0.00** | **0.00** |
| **19** | 7040 | Taksë doganore për mallrat e importit | | |
| **20** | 7041 | Taksë doganore për mallrat e eksportit | | |
| **21** | 7042 | Tarifë shërbimi doganor e kaliposte | | |
| **22** | 7049 | Te tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombtare | | |
| **23** | **705** | **5.Taksë e rrugës** | | |
| **24** | **708** | **6.Të tjera Tatime e Taksa kombëtare** | | |
| **25** | **709** | **7.Gjoba e Kamat vonesa** | **1,386,325.00** | **31,078,530.00** |
| **26** | ***75*** | ***II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQËRORE E SHËNDETËSORE*** | **0.00** | **0.00** |
| **27** | 750 | NGA TE PUNËSUARIT | | |
| **28** | 751 | NGA PUNËDHËNËSI | | |
| **29** | 752 | NGA TË VETPUNËSUARIT | | |
| **30** | 753 | NGA FERMERËT | | |
| **31** | 754 | NGA SIGURIMET VULLNETARE | | |
| **32** | 755 | KONTRIBUTE NGA BUXHETI PËR SIGURIME SHOQËRORE | | |
| **33** | 756 | KONTRIBUTE NGA BUXHETI PËR SIGURIME SHËNDETËSORE | | |
| **34** | ***71*** | ***III.TE ARDHURA JO TATIMORE*** | **234,533,939.50** | **226,885,204.00** |
| **35** | **710** | **1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia** | **0.00** | **0.00** |
| **36** | 7100 | Nga Ndërmarrjet publike jo financiare | | |
| **37** | 7101 | Nga Ndërmarrjet publike financiare | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 38 | 7109 | Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronesia | | |
| 39 | **711** | **2.Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare** | **234,500,939.50** | **226,885,204.00** |
| 40 | 7110 | Tarifa administrative dhe rregullatore | 227,083,779.00 | 218,915,154.00 |
| 41 | 7111 | Të ardhura sekondare e pagesa sherbimesh | 4,889,160.50 | 4,394,750.00 |
| 42 | 7112 | Taksë për veprime gjyqsore e noteriale | | |
| 43 | 7113 | Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve | | |
| 44 | 7114 | Të ardhura nga biletat | | |
| 45 | 7115 | Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime(20% ) | 2,528,000.00 | 3,542,000.00 |
| 46 | 7116-18 | Të ardhura nga transferimi pronës, Legalizimi i ndërtimeve pa leje | | 33,300.00 |
| 47 | **719** | **3.Të tjera të ardhura jo tatimore** | **33,000.00** | **0.00** |
| 48 | ***76*** | ***IV.TË ARDHURA FINANCIARE*** | **3,401,945.40** | **437,855.42** |
| 49 | 760 | Nga interesat e huadhënies së brendshme | | |
| 50 | 761 | Nga interesat e huadhënies se Huaj | | |
| 51 | 765 | Nga interesat e depozitave | 3,399,003.82 | 378,739.03 |
| 52 | 766-779 | Nga këmbimet valutore | 2,941.58 | 59,116.39 |
| 53 | ***72*** | ***V.GRANTE KORENTE*** | **0.00** | **0.00** |
| 54 | **720** | **1.Grant korent I Brendshëm** | **0.00** | **0.00** |
| 55 | 7200 | Nga Buxheti për NJQP(Qendrore) | | |
| 56 | 7201 | Nga Buxheti për NJQP(Vendore) | | |
| 57 | 7202 | Nga Buxheti për pagesa të posacme të ISSH | | |
| 58 | 7203 | Nga Buxheti për mbulim deficiti(ISSH E ISKSH) | | |
| 59 | 7204 | Pjesmarrje e institucioneve në tatime nacionale | | |
| 60 | 7205 | Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit | | |
| 61 | 7206 | Financim i pritshëm nga buxheti | | |
| 62 | 7207 | Sponsorizime të brendshme( nga të tretë) | | |
| 63 | 7209 | Të tjera grante korente të brendshme | | |
| 64 | **721** | **2.Grant korent I Huaj** | **0.00** | **0.00** |
| 65 | | Nga Qeveri të Huaja | | |
| 66 | | Nga Organizata Ndërkombetare | | |
| 67 | | ***VI.TË ARDHURA TË TJERA*** | **476,269.00** | 0.00 |
| 68 | 781 | Të ardhura nga investimet në ekonomi | | |
| 69 | 782 | Rimarrje Shumash të parashikuara për aktive afatshkurtra | 476,269.00 | |


INFO@AMA.GOV.AL RRUGA PAPA GJON PALI II 15, TIRANA WWW.AMA.GOV.AL

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 70 | 783 | Rimarrje Shumash të parashikuara për aktive afatgjata | | |
| 71 | 784 | Rimarrje Shumash për shpenzime të viteve të ardhshme | | |
| 72 | 787 | Tërheqje nga seksioni i investimeve | | |
| 73 | *73* | ***VII.NDRYSHIMI I GJËNDJES SË INVENTARIT TË PRODUKTEVE*** | | |
| **74** | **B** | **SHPENZIMET** | **212,035,359.52** | **200,723,682.32** |
| **75** | **600** | **I.PAGAT DHE PËRFITIMET E PUNONJËSVE** | **147,178,369.84** | **119,282,222.58** |
| 76 | 6001 | Paga, personel i përhershëm | 134,225,951.84 | 106,223,890.58 |
| 77 | 6002 | Paga personel i Përkohshëm | 0.00 | 0.00 |
| 78 | 6003 | Shpërblime | 12,952,418.00 | 13,058,332.00 |
| 79 | 6009 | Shpenzime të tjera për personelin | | |
| **80** | **601** | **II.KONTRIBUTE TË SIGURIMEVE** | **18,401,888.00** | **16,587,201.00** |
| 81 | 6010 | Kontributi I Sigurimeve Shoqërore | 16,435,717.00 | 14,820,180.00 |
| 82 | 6011 | Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore | 1,966,171.00 | 1,767,021.00 |
| **83** | **602** | **III.BLERJE MALLRA E SHERBIME** | **46,130,720.07** | **62,571,163.04** |
| 84 | 602 | Mallra dhe shërbime të tjera | | |
| 85 | 6020 | Materiale zyre e të përgjithshme | 1,024,084.32 | 1,331,150.40 |
| 86 | 6021 | Materiale dhe shërbime speciale | 726,240.00 | 1,489,552.78 |
| 87 | 6022 | Sherbimë nga të tretë | 8,863,270.64 | 13,643,768.35 |
| 88 | 6023 | Shpenzime transporti | 3,519,458.48 | 4,043,501.02 |
| 89 | 6024 | Shpenzime udhëtimi | 12,148,841.14 | 14,573,844.06 |
| 90 | 6025 | Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme | 1,320,925.20 | 1,532,252.00 |
| 91 | 6026 | Shpenzime për qeramarrje | 1,317,600.00 | 1,317,600.00 |
| 92 | 6027 | Shpenzime për detyrime për kompesime legale | 0.00 | 9,322,187.00 |
| 93 | 6028 | Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua | | |
| 94 | 6029 | Shpenzime të tjera operative | 17,210,300.29 | 15,317,307.43 |
| **95** | **603** | **IV.SUBVECIONE** | **0.00** | **0.00** |
| 96 | 6030 | Subvecione për diferencë cmimi | | |
| 97 | 6031 | Subvecione për të nxitur punësimin | | |
| 98 | 6032 | Subvecione për të mbuluar humbjet | | |
| 99 | 6033 | Subvecione për sipërmarrjet individuale | | |
| 100 | 6039 | Subvecione të tjera | | |
| **101** | | **V.TRANSFERIME KORENTE** | **30,000.00** | **0.00** |
| **102** | **604** | **1.Transferime korente te brendshme** | **0.00** | **0.00** |
| 103 | 6040 | Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë | 0.00 | 0.00 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **104** | 6041 | Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme | | |
| **105** | 6042 | Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetsore | | |
| **106** | 6044 | Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse | | |
| **107** | **605** | **2.Transferime korente me jashte** | **0.00** | **0.00** |
| **108** | 6051 | Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare | | |
| **109** | 6052 | Transferime Për Qeveritë e Huaja | | |
| **110** | 6053 | Transferime Për institucionet jo fitimprurëse të huaja | | |
| **111** | 6059 | Transferime Të tjera korrente me jashtë shtetit | | |
| **112** | **606** | **3.Transferime për Buxhetet familjare e Individe** | **30,000.00** | **0.00** |
| **113** | 6060 | Transferta Të paguara nga ISSH, ISKSH e Shoq Sig. | 30,000.00 | |
| **114** | 6061 | Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor | | 0.00 |
| **115** | | **VI.SHPENZIME FINANCIARE** | **632,423.53** | **2,292,412.86** |
| **116** | **65** | **1.Shpenzime Financiare te brendshme** | **632,423.53** | **2,292,412.86** |
| **117** | 650 | Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte | | |
| **118** | 651 | Interesa për huamarrje te tj. Brendshme | | |
| **119** | 652 | Interesa Letra tjera vlerë Qeverisë | | |
| **120** | 656 | Shpenz.nga këmbimet valutore | 632,423.53 | 2,292,412.86 |
| **121** | **66** | **2.Shpenzime Financiare të jashtme** | **0.00** | **0.00** |
| **122** | 660 | Interesa për huamarrje nga Qeveri.të Huaja | | |
| **123** | 661 | Interesa për financime nga Institucionet.ndërkomb | | |
| **124** | 662-672-678 | Interesa për huamarrje të tjera jashtme | 0.00 | 0.00 |
| **125** | | **VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA** | **0.00** | **0.00** |
| **126** | 681 | Kuotat e amortizimit te AAGJ, të shfrytëzimit | | |
| **127** | 682 | Vlera e mbetur e AAGJ, të nxjerra jashtë përdorimit e të shitura | | |
| **128** | 683 | Shuma të parashikuara ë shfrytëzimit | | |
| **129** | 686 | Shuma të parashikuara për aktivet financiare | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 130 | *63* | ***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SË INVENTARIT*** | **-338,041.92** | **-9,317.16** |
| 131 | | ***IX.SHPENZIME TE TJERA*** | **0.00** | |
| 132 | ***85*** | **TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES** | **28,408,245.38** | **58,338,505.35** |
| | | ***(Rezultati I Veprimtarisë së vititUshtrimor)*** | | |
| | | | | |
| **K O N T R O L L E** | | **Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen** | **Kuadratura** | **Kuadratura** |
| Kontroll 1. | | Të Ardhurat a janë të barabarta me Shpenzimet + Rezultatin e vitit Ushtrimor | **0.00** | **0.00** |
| Kontroll 2. | | Llogarja 85 e Pasqyres F2 a është e barabarte me Llog. 85 në Pasqyrën F1 | **0.00** | **0.00** |
| Kontroll 3. | | Llogarja 63 në Pasqyrën F2 a është e barabartë me Ndryshimin e Gjendjeve | **0.00** | |
| | | të Klasës 3 ne Pasqyrën F1 | | |

**Llogaria 89 shpenzime udhëtimi është realizuar si më poshtë:

- Shpenzime për bileta udhëtimesh: 3,807,817
- Dieta për shërbime inspektimesh dhe dieta të tjera të brendshme gjatë vitit 2025: 3,724,500
- Dieta dhe shepnzime për rezervime hotelesh për shërbime jashtë vendit: 4,616,524

**ANEKS 1**

## ÇËSHTJET GJYQËSORE KU ËSHTË PALË AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

| ÇESHTJE GJYQËSORE NË GJYKIM NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | Paditës/I paditur | **Objekti** | **Faza gjyqësore në të cilën ndodhet procesi** | **Fituar/ Humbur në fazën aktuale** |
| 1 | Paditës: "TIBO" sh.p.k I paditur: AMA | Shfuqizimin e vendimit nr. 106, dt 30.09.2022, të AMA-s, që ka lënë në fuqi sanksionin me gjobë nr. 7, datë 24.08.2022; Sigurimi i padisë; Dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm | Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë | Në proces |
| 2 | Paditës: "TIBO" sh.p.k | Shfuqizimin e vendimit nr. 115, datë 12.10.2022, të AMA-s, që ka lënë në fuqi | Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë | Në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | I paditur:<br>AMA | vendimin për dënimin me gjobë nr. 9, datë 02.09.2022, të DM | | |
| 3 | Paditës:<br>Kushtrim Gjakova<br>Palë e paditur:<br>"Intermed" sh.p.k.<br>"Anima Pictures" sh.p.k<br>Palë e tretë:<br>AMA | "Shkaktim dëmi" | Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë | Në proces |
| 4 | Paditës:<br>Astrit Basha<br>I paditur:<br>AMA | Shfuqizimin e aktit administrativ, vendim për dënimin me gjobë, nr. 1, datë 09.04.2024, lënë në fuqi me vendimin nr. 43, datë 07.05.2024, të AMA-s | Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë | Në proces |
| 5 | Paditës:<br>AMA<br>I Paditur:<br>"AVIA Center" | Detyrime Financiare | Përfunduar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë | Fituar |
| 6 | Paditës:<br>AMA<br>I Paditur:<br>Channel 7 | Detyrimin e palës së paditur për të paguar detyrimet financiare kundrejt AMA-s në shumën prej 135,651 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e gjatëqind e pesëdhjetë e një) lekë. | Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë | Në proces |
| 7 | Paditës:<br>Sevada Guço<br>I Paditur:<br>AMA | Zgjidhja e mosmarrëveshjes së punës në lidhje me njohjen e të drejtës së pushimeve vjetore të pagueshme të pakryera të viteve 2021, 2022 dhe 2024 | Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë | Në proces |
| 8 | Paditës:<br>TIBO<br>I paditur:<br>AMA | Shfuqizimi i vendimit nr. 109, datë 06.12.2023, "Për shqyrtimin e ankimit | Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë | Në proces |

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
